

NË KËTË NUMËR LEXONI



4 Numër rekord studentësh



6 Intervistë me Dr. Hamit Boriçin



16 Mitrovica-arenë e problemeve



22 Mbi veprën e Muhammedit a.s.



27 Të mos e "bdarim" gjuhën...

Lajme	2
Milazim Krasniqi: Kush e "Putinizoi" Gruevskin	3
Gëzim Qerimi: Numër rekord studentësh	4
Sead Ujkani: Nevoja për zhvillimin e sektorit privat	5
Intervistë me Prof. Dr. Hamit Boriçin.....	6-9
Sabri Halili: Pse gjeniu shqiptar Rifat Gjota ka mbetur në harresën e kohës?	10-11
Avni Avdiu: Mes pajtimit dhe nënshtrimit.....	12-13
Burim Xhemajli: Mobilizim i gjithëmbarshtëm kundër zjarreve.....	13-14
Bujar Sejdiu: Vallëzimi i bletëve.....	14-15
Florije Ademi: Mitrovica – arenë e problemeve ndëretnike.....	16
Mirsad Kuteli: Roli i familjes në shoqëri dhe sfidat e saj	17
Demir Reshiti: Rikonfigurimi.....	18-19
Osman D. Gashi: Fotoreportazhi.....	20-21
Muhamed Jusufi – Kajolli: Mbi veprën e Muhammedit s.a.v.s.....	22-23
Batjar Halili: Vonesa mendore	24-25
Ajni & Mimoza Sinani: Optimizmi për 'pavdekësinë e njeriut'	25-28
Besim R. Cengu: Të mos e "bdarim" gjuhën shqipe..	28-30
Flamur Maloku: Pikëvështrimi shënjues i tekstit...	31-32
Jehona Gashi: Kthimi i këngës epike.....	33
Muhamed Çitaku: Diskursi kur'anor në letërsinë shqipe (II).....	33
Poezi	34
Ag Apolloni: Elegji për Arbërinë.....	34-35
Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli: Dehidrimi..	36-37
Liridon Ibërdemaj: Shkëlqimi dhe rënia e Luan Krasniqit	38-39
Fjalëkryqi	40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti III / Nr. 20-21
19 korrik - 19 shtator 2008
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Anëtarët e redaksisë:
Arber ZEKA
Gëzim QERIMI
Lulzim AHMETI
Mergim LUSHTAKU
Sead UJKANI
Shkelzen NUZA

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@yahoo.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Bruksel

11 korrik 2008

1.2 miliardë euro për Kosovën në Konferencën e Donatorëve në Bruksel

Bashkësia ndërkombëtare është zotuar se do t'i japë Kosovës 1.2 miliardë euro për zhvillim socio-ekonomik.

Donatori më i madh është Bashkimi Evropian i cili ka premtuar 500 milionë euro, ndërsa së bashku me ofertat individuale të shteteve evropiane, asistenca e palës evropiane për Kosovën e tejkalon shumë prej 800 milionë euro. Në këtë kuadër shteti evropian që ka dhënë shumë më të madhe të ndihmave është Gjermania, me ofertën prej 100 milionë euro.

Donacionet janë kryesisht të dedikuara për infrastrukturë, edukim dhe decentralizim dhe çështje të tjera teknike.

Në Konferencën e Donatorëve morën pjesë 37 shtete dhe 16 organizata ndërkombëtare.

Vendet e Bashkimit Evropian që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, nuk kanë ofruar asistencë financiare dhe kanë pohuar se në konferencë marrin pjesë vetëm si vëzhgues. Sidoqoftë, Komisioni Evropian pret që në një të ardhme të afërt edhe këto shtete të ofrojnë mjete për zhvillimin e Kosovës.



Vjenë

29 qershor 2008



Spanja kampione e re e Evropës

Spanja është kampione e re e Evropës, pasi në ndeshjen finale në Euro 2008 mposhti Gjermaninë me rezultat 1:0. Golin e vetëm në këtë ndeshje e shënoi sulmuesi i Liverpoolit, Fernando Torres, në minutën e 33-të. Kësisoj titulli i kampionit të Evropës rikthehet sërish te spanjollët, pas vitit 1964, me plot meritë. Gjatë tërë Kampionatit të 13-të evropian djelmoshat e Luis Aragonosit kanë treguar lojëra të nivelit të lartë.

Prishtinë

15 qershor 2008

Hyri në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Me 15 qershor ka hyrë në fuqi zyrtarisht Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Me dokumentin më të lartë juridik, Republika e Kosovës përcaktohet si shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera, e cila qeveriset në mënyrë demokratike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka 14 kapituj dhe 150 nene dhe si e tillë avancohet rolin e Presidentit të Kosovës, i cili do të jetë komandant suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila pritet të themelohet deri në fund të vitit.



Londër

24 qershor 2008



Gylen, kryeson intelektualët

Dijetari islam, Fethullah Gylen, është renditur i pari në listën e "100 intelektualëve më të mëdhenj që jetojnë". Sipas një anketimi të bërë nga revista 'Amerikan Foreign Policy', dijetari i njohur botërisht, Fethullah Gylen, është përzgjedhur i pari në listën e 100 intelektualëve më të mëdhenj në botë që jetojnë aktualisht.

Rezultatet e sondazhit u bënë të ditura nga revista angleze 'Prospect' e cila organizoi anketën në bashkëpunim me 'Amerikan Foreign Policy'. Sipas deklaratës së revistave prestigjioze, në anketim kanë marrë pjesë mbi 500 mijë persona.

Kush e "Putinizoi" Gruevskin



Milazim KRASNIQI

Fitorja spektakulare e koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE e Nikolla Gruevskit në zgjedhjet e parakohshme në Maqedoni, ka ardhur si rezultat i forcimit të saj në sytë e elektoratit maqedonas, meqë arriti të dobësonte ndikimin e shqiptarëve në vitet 2006-2008, kur qeverisi në koalicion me PDSH-në e Arbën Xhaferit. Po të mos ishte dominues në elektoratin maqedonas ky besim për Nikolla Gruervskin, ai do të pësonte debakël në zgjedhje, pas kthimit me turp nga Samiti i Bukureshtit, ku Maqedonia nuk mori ftesë për anëtarësim në NATO. Elektorati maqedonas nuk do ta shpërblente për atë disfatë të rëndë politike, po të mos besonte se Gruevski është ilaçi i duhur kundër fuqizimit të shqiptarëve në shtet. Pra, shikuar realisht, rritja e rejtingut të tij, ka ardhur për shkak të hapësirës manovruese që ka fituar në dy vjet qeverisjeje në koalicion me PDSH-në. Nëse ka fituar një prirje putiniane, atë e ka fituar deri sa ka qenë partner i partisë së Arbën Xhaferit në qeverisje.

Në fakt, para vitit 2006, as që mund të bëhet fjalë për prirje putiniane, as të Gruevskit e as të paradržësit të tij. Paradržësi i tij, Lupço Georgievski, manifestoi madje prirje millosheviqiane, por në konfliktin e vitit 2001, guerilja shqiptare e drejtuar nga Ali Ahmeti, e bëri Georgievskin të dukej si një pulë e lagur. Për pasojë të asaj disfate faktike, ai e humbi drejtimin e partisë e të qeverisë dhe praktikisht shkoi në pension të parakohshëm politik. Edhe ai ishte partner i Arbën Xhaferit në qeverisje dhe sa për Xhaferin do të bëhej Putin. Por, Gerogievski nuk ia arriti ta përballonte "Çeçeninë" e vet, sepse e humbi luftën. E vërteta është se ngritja e Putinit dhe formulimi i putinizmit si doktrinë e re arrogante rusomadhe, filloi bash me masakrat kundër çeçenëve. Fitorja kundër rebelëve çeçenë e bëri Putinin lider të Rusisë. Georgievski e Gruevski nuk e patën atë shans, për arsye që dihen e nuk ka pse të numërohen

këtu. Bile, po të mos ndodhte përçarja e faktorit politik shqiptar në Maqedoni dhe veçmas ulja e pazarit për të hyrë në qeveri në vitin 2006 nga PDSH-ja, do të shkonte kohë e gjatë dhe liderëve nacionalistë të VMRO-së nuk do t'u shkonte mendja t'i provokonin e lëre më të tallshin me shqiptarët, ashtu si u tallën në zgjedhjet e korrikut 2008. "Putinizmi" i Gruevskit as që do të kishte shans të lëshonte ndonjë sinjal. Evokimi i të kaluarës nacionaliste bullgarofile do të zbehej përballë evokimit të disfatës në konfliktin me shqiptarët në vitin 2001. Por, hyrja e PDSH-së në qeveri me një numër më të vogël deputetësh e pa kërkesa të qarta, u shndërrua në oksigjen për nacionalizmin vmroist. Mjafton të kujtohen emrat e disa ministrave dhe deputetëve të PDSH-së në qeverinë Gruevski dhe në Sobranja, për ta pasur të qartë se PDSH-ja, nuk i ka shfrytëzuar as kapacitetet e veta për të pasur një përfaqësim më konkurrues e më dinjitoz. Me ministra e deputet të atillë, pa peshë intelektuale e politike, Gruevski është motivuar që të "putinizohet". Pra, për sa është ai Putin ose i putinizuar, atë e ka peshqesh nga ish partneri i koalicionit nga PDSH-ja dhe posaçërisht nga lideri i saj, Arbën Xhaferi, i cili në një intervistë të lodhtë dhënë gazetës *Expres* (10 korrik 2008) vajton fatin e zi të shqiptarëve, në nxirjen e të cilit ka qenë ideolog vetë.

Në vend se të bënte një analizë kritike të politikave të veta e të partisë që ka drejtuar me vite të tëra nga humbja në humbje, ai thjesht bën një parashikim ogurzi për të ardhmen, e cila nuk varet më prej tij e as prej partisë së tij. Një analizë e tillë do të duhej të përfshinte veçmas raportet e PDSH-së me VMRO-n (të cilës tash ia ka kuptuar rrënjët nacionaliste!) dhe të vetë Xhaferit e Thaçit me Georgievskin dhe Gruevskin. Në atë analizë do të duhej të rivlerësoheshin ato raporte, që nga idetë për ndarjen etnike të Maqedonisë e deri te shpallja e turpshme e fitores së VMRO-së si fitore edhe e PDSH-së, në vitin 2008. Pa një analizë të atillë gjithëpërfshirëse e kritike, Arbën Xhaferi dhe Menduh Thaçi do t'i lënë PDSH-së një trashëgimi të dyshimtë, disfatiste e komplotiste. Ndërsa, ajo trashëgimi do ta brejë ndërgjegjen e anëtarësisë së kësaj partie, siç e bren

krimbi një dru të kalbur nga brenda. Në variantin më të keq, PDSH-ja mund të "ppd-izohet", sa të llogaritet sukses elektoral, nëse e fiton një deputet në parlamentin e ardhshëm.

Meqë nuk është në interes të shqiptarëve në Maqedoni copëzimi i mëtejshëm partiak dhe defaktorizimi i mëtejshëm kombëtar, PDSH-ja do të duhej të reformohej dhe pastaj të merrte një rol të ri në skenën politike të Maqedonisë. Qëndrimi në opozitë mund të ndihmojë në reformimin e saj, nëse ka vullnet në udhëheqjen e saj. Por, ajo udhëheqje, qoftë me Menduh Thaçin qoftë pa të, nuk mund ta bëjë asnjë hap reformues nëse nuk lirohet nga tirania ideologjike e Arbën Xhaferit. Xhaferi e ka bërë PDSH-në leckë, më saktë parti të plastelinës, që merr formë si t'i teket atij. Ai e ka bërë PDSH-në parti aventuriere. PDSH-ja u formua gjoja për të formuluar e realizuar interesat kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni, ndërsa po e njëjta parti, në vitin 2001, rrinte në qeverinë e cila i granatonte vendbanimet shqiptare. Xhaferi herë i ka dhënë kësaj partie ngjyrim ideologjik nacionalist, (duke kërkuar edhe ndarjen etnike), herë ngjyrim pothuajse ekologjik (duke ndenjur sus në qeverinë Gruevski).

Edhe pseudoanalizat e tashme të tij për "putinizmin" e Gruevskit dhe për prospektet e këqija të BDI-së, janë pjesë e fantazisë së tij të bujshme, ku edhe problemet planetare atij i duken si lojë fëmijësh në kompjuter. Metoda jologjike e analogjisë, që është metodë e preferuar e "analizave" të Arbën Xhaferit, jo vetëm Putinin e Grueskin, po edhe macen e elefatin (batutë e Joneskos te drama "Rinoqeronti") i bën të duken të ngjashme.

Nëse do të ketë në të ardhmen një PDSH të reformuar (dhe gjithsesi të çliuar nga fantazitë e Xhaferit) dhe një BDI insistuese në interesat strategjike të shqiptarëve që u formuluan nga UÇK-ja në vitin 2001, Gruevski do të sillej me shumë kujdes, pa asnjë egërsi putiniste, sepse fantazma politike e Lupço Georgievskit do t'i rrinte vazhdimisht në zyrë.

Ajo fantazmë e frikshme e disfatës, të cilën nga ajo zyrë e ndoqi vetë Arbën Xhaferi me partinë e tij në vitet 2006-2008. ■

Me vendim të Ministrisë së Arsimit është rritur dukshëm numri i studentëve të rinj në Universitetin Publik

Numër rekord studentësh

Në universitetit e vetëm publik në Republikën e Kosovës parashihet që me konkursin për vitin akademik 2008-2009 të regjistrohen 10625 studentë vendës, prej të cilëve 8970 të rregullt dhe 1655 me korrespondencë. Universiteti do të regjistrojë edhe 306 studentë të rregullt nga vendet e rajonit, shumica e të cilëve nga Mali i Zi dhe Serbia, si dhe 134 studentë minoritarë



Gëzim QERIMI

Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë ka marrë vendim që universiteti publik të regjistrojë 11010 studentë, pavarësisht prej faktit se Senati i UP-së kishte propozuar që ky numër të ishte jo më i madh se 8055. Kjo ministri nuk ka përfillur as propozimin e shtatëmbëdhjetë njësive akademike të Universitetit të Prishtinës në lidhje me numrin e studentëve të rinj që duhet të regjistrohen në këtë vit akademik.

Në universitetit e vetëm publik në Republikën e Kosovës parashihet që me konkursin për vitin akademik 2008-2009 të regjistrohen 10625 studentë vendës, prej të cilëve 8970 të rregullt dhe 1655 me korrespondencë. Universiteti do të regjistrojë edhe 306 studentë të rregullt nga vendet e rajonit, shumica e të cilëve nga Mali i Zi dhe Serbia, si dhe 134 studentë minoritarë.

Universiteti i Prishtinës është ankuar se nuk mund ta absorbojë këtë numër studentësh, meqë nuk ka mjete financiare për të mbuluar koston që sjell kjo rritje. Me vendimin e mëhershëm të ministrit Hoxhaj për t'i ulur tarifat e studimit dhe për të mos regjistruar sivjet studentë me vetëfinancim, UP-ja ka zvogëluar të hyrat vetjake për rreth 2 milionë euro.

Rektori Enver Hasani ka potencuar disa herë radhazi se pavarësisht nga dëshira e madhe e UP-së që t'i krijojë çdo të riu mundësinë për t'u pajisur me indeks të universitetit publik, kapacitetet humane, fizike dhe ato financiare nuk lejojnë një rritje kaq të madhe. Rektori Hasani ka paralajmëruar se universiteti

mund të bankrotojë në rast se Qeveria nuk do të ofrojë mbështetje financiare të mjaftueshme për të siguruar kuadrin akademik shtesë dhe hapësirën e mjaftueshme fizike ku do të realizoheshin studimet.

Mirëpo ministri Hoxhaj ka vendosur të mos e përfillë propozimin e Senatit dhe me kuotën që do të miratojë do të bëjë që UP-ja të pranojë një numër rekord të të rinjve. Krahas kuotës prej 11010 studentësh për afatin e qershorit, pritet që kuota të rritet në më shumë se 12000 në afatin e shtatorit. Kuota do të rritet në këtë masë meqë Ministria ka propozuar që në afatin e dytë të shpallet konkurs për regjistrimin e studentëve në disa drejtime të reja, të hapura këtë vit në shumicën e fakulteteve.

Më së shumti studentë në Fakultetin Ekonomik dhe Juridik

Sipas konkursit të UP-së, të mbështetur në vendimin e ministrit, pjesa më e madhe e indekseve të rinj që do të shpërndahen janë për Fakultetin Ekonomik dhe atë Juridik. Në të dyja

fakultetet do të regjistrohen 1200 studentë, prej tyre 700 të rregullt dhe 500 me korrespondencë.

Për nga kuotat, pas tyre radhiten: Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore i cili do të pranojë 1000 studentë të rinj, Fakulteti i Edukimit 980, Fakulteti i Filologjisë 945, Fakulteti Filozofik 860, Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike 700, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë 640, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike 600, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë 520, Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë në Mitrovicë 450, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës 350, Fakulteti i Mjekësisë 320, Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Mitrovicë 300, Fakulteti i Arteve 210, Fakulteti i Shkencave Teknike të Aplikuara në Ferizaj 200 dhe Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit 150.

Të drejtë konkurrimi kanë pasur të gjithë kandidatët që e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer, si dhe ata që vijnë nga shtetet e tjera, në bazë të kuotave të përcaktuara nga ana e Ministrisë së Arsimit.

Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme, por që nuk kanë pasur provim të maturës, si dhe për kandidatët që paraqiten për pranim në Universitetin e Prishtinës, por që nuk e kanë kryer shkollën e mesme në Kosovë, vlejnjë të njëjtat kritere. 20 % e pikëve mund të merret nga rezultati i suksesit në shkollën e mesme dhe 80 % nga rezultati i provimit pranues në fakultet.

Vlera e provimit pranues ka rënë për nxënësit që i janë nënshtruar maturës shtetërore. 20 % të pikëve ata kanë arritur t'i marrin nga suksesi i shkollës së mesme, 50 % nga provimi i maturës dhe vetëm 30 % të pikëve nga provimi pranues që organizon fakulteti. ■



Nevoja për zhvillimin e sektorit privat

Nevoja për intensifikimin e përpjekjeve për krijimin e një ambienti të mirëfilltë për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) është më rëndësi parësore, para së gjithash për faktin se ato janë burimi kryesor i punësimit dhe zbutjes së varfërisë si elemente thelbësore drejt stabilitetit ekonomik të një vendi



Sead UJKANI


Periodha dydekadëshe e fundshekullit të kaluar e përshkuar me izolim të tërësishëm si dhe tranzicioni i pasluftës i karakterizuar me ngecje të shumta me gjithë të metat e tyre të padiskutueshme i dhanë një impuls zhvillimit të sektorit privat, përkatësisht krijimit të bizneseve private në vendin tonë.

Dëmet e pësuarra dhe mosshfrytëzimi i kapaciteteve në vitet e nëntëdhjeta të ndërmarrjeve publike si shtyllë e sistemit të kaluar, në njërën anë, si dhe kalimi në ekonominë e hapur të tregut që ka si karakteristik kryesore dominimin e pronës private, nga ana tjetër, paraqesin dy elemente thelbësore të cilat i dhanë hov të madh zhvillimit dhe avancimit të ndërmarrësisë dhe iniciativave vetjake. Në këtë drejtim, dekada e fundit e shekullit të kaluar u karakterizua nga lindja e bizneseve private dhe zhvillimi i sektorit privat në vendin tonë, sektor i cili me gjithë politikën diskriminuese dhe sfidat e tjera të përballura gjatë asaj periudhe arriti të mbijetojë. Ndërsa, periudha e pasluftës rezultoi me një dinamizëm të shpejtë të përparimit të sektorit privat duke i dhënë këtij sektori rolin primar në zhvillimin ekonomik të vendit gjatë këtyre viteve.

Mirëpo me gjithë dinamizmin karakteristik të lindjes dhe zhvillimit të sektorit privat ngecjet ishin evidente dhe si të tilla pamundësuan edhe ndikimin adekuat të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në drejtim të rritjes së disa elementeve kyçe të zhvillimit të tërësishëm ekonomik.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) katalizatorë të zhvillimit të vendit

Mungesa e mekanizmave adekuatë ligjorë, sistemi gjyqësor joefikas dhe i korruptuar, jostabiliteti i tregut të tokës dhe pronës, vështirësitë e shumta për sigurimin e kredive si dhe aplikimi i politikës fiskale jostimuluese janë disa nga faktorët kryesorë që kanë pamundësuar efektin e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) si katalizatorë të zhvillimit të tërësishëm të vendit. Natyrisht, në tërë grumbullin e këtyre problemeve, nuk duhet harruar pa përmendur mungesa e furnizimit të duhur me energji elektrike dhe problemet evidente të sistemit energjetik në vendin



tonë si njëri ndër faktorët kryesorë që i ka kontribuar kësaj gjendje.

Statusi përfundimtar i padefinuar dhe mungesa e qartësisë mbi të ardhmen politike të Kosovës është identifikuar si faktor mjaft i rëndësishëm që ka ndikuar në stabilitetin e përgjithshëm të Kosovës e, në këtë kontekst, edhe në stabilitetin ekonomik të saj, prandaj edhe ka gëzuar rolin prioritar në agjendën e angazhimit të instancave vendore. Mirëpo pavarësimi i Kosovës ka vendosur si detyrë para institucioneve udhëheqëse, ndër të tjera, angazhimin në drejtim të sigurimit të një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik me prosperitet afatgjatë.

Duke marr parasysh faktin se NVM-të konsiderohen si gur themeltar në përgjithësi në ekonominë evropiane,

në të cilën synon të integrohet edhe Republika e Kosovës, nevoja për intensifikimin e përpjekjeve për krijimin e një ambienti të mirëfilltë për zhvillimin e NVM-ve është më rëndësi parësore, para së gjithash për faktin se NVM-të janë burimi kryesor i punësimit dhe zbutjes së varfërisë si elemente thelbësore drejt stabilitetit ekonomik të një vendi.

Zhvillimi i sektorit privat dhe papunësia

Papunësia paraqet njërin ndër problemet kryesore i cili e ka përshkuar ekonominë e Republikës së Kosovës në veçanti dhe shoqërinë e saj në përgjithësi gjatë gjithë këtyre viteve të fundit. Është evidente se papunësia që ka një trend rritjeje dita ditë është një problem serioz në vendin tonë.

Në këtë drejtim, me gjithë problemet e shumta më të cilat është përballur dhe përballet, sektori privat ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm në zbutjen e papunësisë, ngase vlerësohet se nga numri i përgjithshëm i të punësuarve rreth 67 % janë të punësuar në këtë sektor. Një kontribut i tillë i sektorit privat vetëm sa e shton rëndësinë e një promovimi dhe zhvillimi të mëtutjeshëm të tij duke krijuar kështu një ambient miqësor me një sistem efektiv të përkrahjes për të gjithë ndërmarrësit dhe iniciativat private në vendin tonë.

Duke ditur rëndësinë e zhvillimit të sektorit privat për ekonominë e një vendi, e para së gjithash ndikimin e tij në zbutjen e papunësisë, është e nevojshme që të mobilizohen instancat përkatëse për inkurajimin dhe zhvillimin e ndërmarrësisë dhe stimulimin e investimeve për të mbështetur këtë sektor.

Qeveria e Republikës së Kosovës duhet që të sigurojë një ambient të mirëfilltë për zhvillimin e sektorit privat, mbi të gjitha duke hartuar dhe zbatuar një strategji dhe një plan veprues konkret për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si motor të zhvillimit ekonomik. ■

Intervistë me prof. dr. Hamit Boriçin, publicist, pedagog, studiues dhe historik

Nga puna me studentët e gazetarisë

- Krijimin e Degës së Gazetarisë në kuadër të Universitetit të Prishtinës e kam pritur sa me gëzim, aq edhe me interes
- Ka më se një vit që po punohet për ribotimin e Fjalorit “Gazetarë dhe publicistë shqiptarë”
- Tungjatjeta, Kosovë! Gëzuar Pavarësinë!
- Të mohosh standardet e gjuhës shqipe të njësuar, do të thotë të biesh në kundërshtim me realitetin historik e shoqëror të kombit tonë

Intervistoi: Demir Reshiti

Publicisti, pedagogu, studiuesi dhe historiani i gazetarisë prof. dr. Hamit Boriçi është një nga figurat më të shquara të gazetarisë shqiptare. Shkrimi i tij i parë me titull “Shpendi zbrer nga malet...” është botuar në gazetën “Rinia” në qershor të vitit 1950. Ndërsa në hullitë e gazetarit profesionist ka hyrë në vitin 1954 në gazetën “Zëri i rinisë”.

Është njëri nga themeluesit i të së parës Degë-Katedër të Gazetarisë (1964) ku ligjëron për më shumë se 40 vjet.

Në këtë intervistë ekskluzive për revistën “Paqja”, profesor Boriçi flet për zhvillimin e gazetarisë shqiptare ndër vite, lidhjet e tij emocionale me Kosovën, bastardimin e gjuhës nëpër mediat tona, rrezikun nga mohimi i gjuhës standarde shqipe, etj.

PAQJA: Jeni një nga themeluesit i të së parës Degë-Katedër të Gazetarisë ku, për më shumë se 40 vjet, keni qenë ligjërues, titullar i disa lëndëve madje edhe shef i kësaj Dege. A mund të na e përshkruani me pak fjalë punën që është bërë në përgatitjen e kuadrove të reja për profesionin e gazetarisë?

Boriçi: Së pari ju falënderoj për nderin që më bëni, që, përmes revistës që ju drejtoni, të komunikoj me lexuesit tuaj, me kolegët e miqtë e mi të shumtë në Prishtinë dhe mbarë Kosovën e lirë e të pavarur.

Kjo pyetje më sjell në kujtesë pragvjeshtën e vitit 1964, kur bëheshin përgatitjet për themelimin e të parës shkollë gazetarie në Shqipëri e konceptuar, fillimisht si degë e gazetarisë në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike

Dr. Hamit Boriçi është i lindur më 1930 në Shkodër. Ka studiuar për gazetari në Universitetin “Lomonosov” në Moskë. Është diplomuar për gjuhë e letërsi shqipe Në Universitetin e Tiranës (fakultetin Histori-Filologji). Aty ka kryer edhe studimet pasuniversitare i profilizuar për letërsinë publicistike. Në vitin 1981 ka mbrojtur gradën shkencore “Kandidat i shkencave”, ndërsa në vitin 1988 ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor i shkencave”.

Është njëri nga themeluesit i të së parës Degë-Katedër të Gazetarisë (1964). Për më shumë se 40 vjet është ligjërues, titullar i lëndëve: ‘Teoria dhe praktika e gazetarisë’ dhe ‘Mjeshtëria (Format e pasqyrimin publicistik)’, si edhe ligjërues i lëndës ‘Historia e Gazetarisë’ dhe ‘Etika profesionale e gazetarisë’. Aktualisht punon si pedagog i jashtëm në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Tiranës.

Ka qenë

shef i Katedrës së Gazetarisë në UT (1986-1991), anëtar

i Këshillit Shkencor të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave (1980-1985), anëtar i Këshillit Shkencor të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike (gazetari) të Universitetit të Tiranës (1986-1989), anëtar i Këshillit Drejtues të Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës (2001-2003).

Përvoja gazetareske: Korrespondent i gazetës “Zëri i rinisë” për rajonin e Shkodrës (1954-1958). Gazetar, redaktor dhe përgjegjës redaksie në gazetën e përditshme “Bashkimi” në Tiranë (1963-1974). Kryeredaktor gazetës së përditshme “Bashkimi” në Tiranë (1978-1990).

Është autor i disa librave (teksteve) universitare, të publicistikës dhe monografike.



an i gazetarisë

... në Kosovë ruaj kujtimet më të mira

të Universitetit të Tiranës, pastaj Katedër dhe Sektor Shkencor. Bërthama pedagogjike e kësaj dege përbëhej nga gazetarë profesionistë, që kishin studiuar për gazetari në Moskë e Leningrad (në ish-Bashkimin Sovjetik): Fiqri Vogli, Sofokli Lazri, Marash Hajati, Dritëro Agolli, Fatmir Dibra, Ymer Minxhozi. Këtij grupi i përkisja edhe unë. Përveç këtyre për të dhënë mësim, në fillesat e para, u ftuan edhe gazetarë të shquar si Vangjush Gambeta, Niko Nikolla, etj. Mua më ra lotaria që të merrem që në fillim me probleme të organizimit të kësaj Dege, Katedre dhe Sektori Shkencor dhe për disa vjet të jem drejtues, deri në vitin 1990, kur, me propozimin tonë, Katedra kaloi në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit Shtetëror. Në arkivin vetjak unë ruaj dorëshkrimin e projektprogramit mësimor tre dhe katërvjeçar, që me disa ndryshime u miratua në Katedër, në Fakultet dhe në Rektorat. Për të qenë i saktë për kohën e themelimit, shfletova revistën profesionale "Tribuna e gazetarit", ku kam botuar reportazhin e parë "Me gazetarët e ardhshëm" (Viti II, nr. 1, 3 prill 1965, f. 15), çka dëshmon se shkolla e parë universitare e gazetarisë është themeluar në vjeshtën e vitit 1964. Në vitin akademik 1964/65 Dega e Gazetarisë ishte me program profesional dyvjeçar. Studentët vinin nga Degë e Fakultete të Gjuhësisë e Letërsisë, të Ekonomisë e Drejtësisë si dhe nga Instituti i Lartë i Bujqësisë. Si Degë dhe Katedër e rregullt ka filluar në vitin akademik 1967/1968.

Ky institucioni i lartë arsimor për më se një çerekshkulli ka qenë qendra kryesore e përgatitjes dhe e kualifikimit të gazetarëve në Shqipërinë e atyre kohëve. Departamenti i sotëm i gazetarisë, që është në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës, është organizuar në vitin 1993 me koncepte dhe programe të reja. Kësisoj është vazhdim i Degës së Gazetarisë të vitit akademik 1964/1965.

Dega, Katedra dhe Sektori Shkencor ka punuar edhe me programe njëvjeçare universitare dhe pasuniversitare me gazetarë, që ishin diplomuar në profile të ndryshme, duke i kualifikuar. Po ashtu Katedra ka

drejtuar veprimtarinë shkencore në fushën e gazetarisë, duke udhëhequr studiues për tituj e grada: Bashkëpunëtor Shkencor (Docent) dhe Doktor i Shkencave.

Në rrjedhën e 25 vjetëve janë aktivizuar një varg drejtuesish të mediave dhe gazetarë kompetentë për mësimdhënie. Por në historinë e shkollës së gazetarisë kanë hyrë e mbetur edhe pedagogët efektivë Zihni Reso (drejtues i Degës dhe i Katedrës që në fillim), Petro Kita dhe, nga viti 1972 deri më 1992, Luan Zelka).

Krijimin e Degës së Gazetarisë në kuadër të Universitetit të Prishtinës e kam pritur sa me gëzim, aq edhe me interes.

PAQJA: Një kohë keni qenë i angazhuar si ligjërues edhe në Fakultetin e Gazetarisë "Faik Konica" në Prishtinë. Çfarë përshtypjesh keni nga puna në Kosovë?

Boriçi: I ftuar nga prof. dr. Ramiz Kelmendi, themelues e drejtues për më se dhjetë vjet i Fakultetit të Gazetarisë "Faik Konica", kam pasur nderin të ligjëroj për probleme të teorisë dhe të praktikës së gazetarisë, përkrah kolegëve të Prishtinës dhe të pedagogëve të mirënjohur të Tiranës: prof. as. dr. Bashkim Gjergji dhe prof. dr. Gjovalin Shkurtaj.

Nga puna me studentët e gazetarisë në Kosovë ruaj kujtimet më të mira. Mendimi dhe bindja ime është se Fakulteti "Faik Konica" ka dhënë një ndihmesë të vyer në përgatitjen e gazetarëve të rinj, duke qenë për shumë kohë i vetmi institucion arsimor i këtij profili në Prishtinë. Dhe kjo meritë i takon themeluesit dhe drejtuesit të këtij Fakulteti, prof. dr. Ramiz Kelmendi, punëtor i palodhur i gjuhësisë, i gazetarisë, i letrave shqipe dhe i kulturës shqiptare.

PAQJA: Ka tri vjet që në kuadër të Universitetit publik të Kosovës funksionon edhe dega e gazetarisë. A bashkëpunoni me këtë fakultet dhe a mendoni se ka nevojë për zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet dy fakulteteve simotra në Prishtinë dhe Tiranë?

Boriçi: Krijimin e Degës së Gazetarisë në kuadër të Universitetit të Prishtinës e kam pritur sa me gëzim, aq edhe me interes. Kam dëshirë ta njoh si ndihmesë timen për ata studentë të kësaj dege, që kanë marrë, e sadopak, kanë shfrytëzuar disa libra të mi si "Gazetaria 1" (Hyrje në Gazetari), "Gazetaria -2" (Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyimit publicistik), "...Një shekull e gjysmë publicistikë shqiptarë" (1848-1997) etj. Bashkëpunimin me këtë degë e shoh të nevojshëm e të domosdoshëm dhe me dobi të ndërsjellë. Prandaj, nga pozicioni që unë jam, kam hedhur hapin e parë për një bashkëpunim të tillë, duke ftuar drejtuesin e asaj dege, prof. as. Dr. Milazim Krasniqin, për të marrë pjesë aktive në Konferencën Shkencore të UFO University, "Dukuri dhe probleme të zhvillimit të gazetarisë bashkëkohëse shqiptare", mbajtur më 30 maj 2008 në Tiranë. Kumtesa e tij "Përvojat e raportimit të mediave shqipe në Kosovë mbi krimin" dëshmon për një nismë premtuese në udhën e bashkëpunimit tonë.

Ka më se një vit që po punohet për ribotimin e Fjalorit "Gazetarë dhe publicistë shqiptarë".

PAQJA: Jeni autor i disa librave nga fusha e gazetarisë. Vlerësimi i përgjithshëm është se kemi një mungesë të teksteve (veçmas atyre universitare) në këtë



fushë mjaft të rëndësishme. Sa pajtoheni me këtë vlerësim dhe çfarë duhet bërë që të plotësohen nevojat e studentëve për tekste të tilla?

Boriçi: Jam në një mendje me ju. Ende ka mungesë literature shqiptare për shkollat tona të gazetarisë. Ndonëse fondi i literaturës së përkthyer për këtë fushë është shtuar, mendoj se gazetarët, pedagogët dhe studiuesit e Prishtinës dhe të Tiranës duhet të bashkëpunojnë për të shkruar e botuar, sidomos, tekste mësimore për teorinë, praktikën dhe historinë e gazetarisë shqiptare.

PAQJA: *Ju jeni njëri nga nismëtarët dhe më meritoret për idenë e botimit të Fjalorit Enciklopedik "Gazetarë dhe publicistë shqiptarë" dhe keni paralajmëruar një ribotim të plotësuar me emra të tjerë të gazetarisë dhe publicistikës shqiptare. Deri ku kanë arritur punët në këtë drejtim?*

Boriçi: Ideja për Fjalorin "Gazetarë dhe publicistë shqiptarë" më ka lindur që kur punoja në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave (1974-1978) dhe skedat e para

u takojnë atyre viteve. Me kohë lindi nevoja e krijimit të një redaksie dhe të një grupi bashkëpunëtorësh, që punuan me përkushtim pa shpërblim material, derisa u arrit botimi më 2005. E ndjej përdetyrë të rivlerësoj dhe të falënderoj për rolin që luajtën kolegët e mi, Sulejman Dërmaku dhe profesor Shyqri Galica për përfshirjen në Fjalor të gazetarëve dhe publicistëve nga Kosova.

Pavarësisht nga përpjekjet e redaksisë dhe të bashkëpunëtorëve, në Fjalor nuk arritëm të përfshijmë mjaft gazetarë e publicistë, edhe ngase disa prej tyre nuk iu përgjigjen kërkesave, nuk i plotësuan formularët e përhapur përmes mediave dhe postës elektronike. Fjalori ka nevojë edhe për disa plotësime e qartësime për emrat e publikuar. Prandaj, ka më se një vit që po punohet për ribotimin e këtij Fjalori. E vërteta është se puna ecën shumë ngadalë, se përsëri nuk po na përgjigjen edhe ata kolegë, që kanë shfaqur pakënaqësinë që emrat e tyre mungojnë në Fjalor; por edhe ngase nuk kemi arritur të gjejmë sponsoriues të këtij projekti.



Tungjatjeta, Kosovë! Gëzuar Pavarësinë!

PAQJA: *Jeni gjithashtu autor i librit me udhëpërshkrime, artikuj e ese, të titulluar "Kosovë...Në jetësim të lirisë". Në këtë libër shihet qartë lidhja juaj emocionale me Kosovën. Na thoni si e keni pritur shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe si e shihni të ardhmen e saj?*

Boriçi: Siç e shihni edhe nga titulli "Kosovë, në jetësim të lirisë", ky libër është nisur si përmbledhje e udhëpërshkrimeve nga Kosova në ditët e para të Lirisë. Ju keni të drejtë që shprehni për lidhjen time emocionale me Kosovën dhe kosovarët. Për ta dëshmuar këtë po shkëpus disa radhë nga parathënia e librit:

"Tungjatjeta, Kosovë!

Me këtë urim vij në Kosovën tonë të heq mallin që ruaj në mendje e zemër prej fëmijërisë, mallin e dashurinë për Kosovën, që rrënjosi ndër ne, nxënësit e shkollës fillore të Parrucës në Shkodrën e viteve 1937-1939, mësuesi ynë i parë, i ndjeri Ismet Shaqiri;

...vij në Kosovë të kërkoj, nanën Ikballe, motër gjaku e nënës sime, që, dikund nga katundet e Deçanit, i pat ndjekur "shk-jau", duke u djegur shtëpi e katandi, duke i vrarë mashkulli; dhe ajo me Nuredinin e vogël, me një bohçe tesha në duar, zbriti në Shkodër. Dhe ne ndamë kafshatën e bukës me Ikballen; ajo u përkujdes për ne si për bijtë e saj;

...vij për t'u përlur përpara varreve të jasharëve, që, me qëndresën e tyre heroike, dhanë kushtrimin për luftë vendimtare për lirinë e Kosovës...;

... dhe të përshëndes: gëzuar lirinë, Kosovë!"

U shpall pavarësia e Kosovës! Dhe përsëri u gjendëm në Prishtinë me studentët e gazetarisë të UFO University; u falem me Kosovën e kosovarët, dhe realizuan telereportazhin: Tungjatjeta, Kosovë! Gëzuar Pavarësinë!

PAQJA: *Në Kosovë pritet me admirim çdo libër i Juaji. Cili është libri i radhës që do të mbajë firmën tuaj?*

Boriçi: Ju falënderoj për komplimentet. Ndonëse koha dhe mosha ecën pa u ndjerë; edhe pse vazhdoj veprimtarinë mësimore-shkencore universitare, përpiqem dhe punoj për ndonjë botim

tjetër. Tani, së bashku me kolegun, Doktorin e Shkencave Mark Marku, po punojmë për historinë e shtypit shqiptar në dy vëllime. Krahas kësaj pune, kam marrë përsipër drejtimin e botimit të veprave të plota të Dr. Vasfi Samimit, i mirënjohur sa në shkencat e veterinarisë e zooteknikës, po aq edhe në fushën e publicistikës, të kulturës (letërsi, art dramatik etj). Vepra e tij e përzgjedhur përbëhet prej 28 vëllimesh. Emri i Vasfi Samimit - Visoka është i lidhur ngushtë me Kosovën. Ai është i pari publicist letrar, që shkroi e botoi një libër për Kosovën, në vitin 1943. Jo rastësisht korpusi i publicistikës së tij prej 5 vëllimesh çelët me librin "Nëna Kosovë - Shqipëria e vërtetë" 1938 - 1943 (Ndjenja dhe mendime). Ai shkruan: "Zëri i Kosovës është zëri i historisë dhe shkëlqimi i saj është drita e së vërtetës". Dhe që asokohe shprehte besimin se dita e lirisë do të vinte e "dielli i njerëzimit t'i kthejë rrezet e veta ndër këto vise të Kosovës dhe ta derdhë dritën e lirisë, atëherë edhe ne, me të gjithë hovin e zemrës dhe me gjithë fuqin' e gjakut, do ta këndojmë këngën e drejtësisë".

Të mohosh standardet e gjuhës shqipe të njësuar, do të thotë të biesh në kundërshtim me realitetin historik e shoqëror të kombit tonë.

PAQJA: *Sot ka shumë gazetarë që punojnë në radio dhe televizione të cilët e mbysin gjuhën. Shprehjet e huaja pothuajse janë bërë modë veçmas nëpër mediat elektronike. Si e vlerësoni gjuhën që përdoret sot në mediat tona?*

Boriçi: Gjuha në mediat e shkruara dhe elektronike është një nga problemet shqetësuese, që ende nuk po merr rrugëzgjdhje. Harrohet se gjuha është mjet i shprehjes së mendimit, i kulturës dhe i qytetërimit. Duket se vëmendja e stafëve drejtuese të mediave orientohet në kërkimin e pasqyrimin e të dhënave, fakteve apo ngjarjeve sensacionale. Shfletoni gazetat dhe do të shihni gabime në drejtshkrim, fjali dhe frazeologji të ngatërruar, fjalor të varfër. Në gazeta e revista, më pak dhe në emisionet radiotelevizive, më shumë, vërehen fjalë të huaja, që jo rrallë nuk e shprehin qartë idenë e mendimin. Ka jo pak gazetarë që mendojnë se ai/ajo që përdor më shumë fjalë të huaja është më i ditur, erudit dhe njohës i gjuhëve

të huaja. Kjo vjen ngase redaktorët apo drejtuesit e mediave kulturën gjuhësore e shohin si të dorës së fundit. Ndonëse ekziston një ligj që i detyron mediat të ngarkojnë njohës të mirë të gjuhës dhe të drejtshkrimit për të lexuar faqet apo lëndën para publikimit ose transmetimit radioteleviziv, ai nuk zbatohet.

PAQJA: *Kohët e fundit, në Kosovë, janë shpeshuar paraqitjet publike në ligjërimin jostandard. Janë shpeshuar edhe shkrimet e intervistat që aktualizojnë dhe kontestojnë formimin e gjuhës standarde shqipe duke propaganduar mënjanimin e saj nga përdorimi publik në Kosovë. Si e vlerësoni ju këto tendenca?*

Boriçi: Njihen prirjet dhe praktikat



që vijnë në kundërshtim me gjuhën shqipe standarde. Përfaqësues të këtij krahu nga Prishtina i kanë shfaqur pikëpamjet e tyre edhe në një emision televiziv të Tiranës. Të mohosh standardet e gjuhës shqipe të njësuar, do të thotë të biesh në kundërshtim me realitetin historik e shoqëror të kombit tonë edhe si bashkësi, edhe me gjuhë të njësuar. Kujtojmë se kjo ide u shtrua që më 1899 nga Shoqëria "Bashkimi" e Shkodrës ku bënin pjesë Preng Doçi e Gjergj Fishta, Pashk Bardhi e Ndoc Nikaj, Shtjefën Gjeçovi e Filip Shiroka, Luigj Gurakuqi etj. Shoqëria ngulmoi për shtrirjen e popullarizimin e veprimtarisë gjuhësore e letrare, të përmbajtjes së saj kombëtare, për t'i kaluar caqet e qytetit të Shkodrës; të përhapej, si shkruante Konica në revistën "Albania", gjer në Pragë e të bëhet shqiptare e përgjithshme...

Mirë që bëhen debate, pasi gjuha dikton ndryshime, por pa prekur thelbin e njësimin të saj. Ngulmimi për një shqipe të veçantë, të ashtuquajtur, "kosovare" afron me idenë e, gjoja, individualitetit të "skipetarit".

PAQJA: *Në fund të muajit maj në Tiranë është organizuar një konferencë kërkimore - Shkencore e Gazetarisë me temën "Dukuri dhe probleme të gazetarisë shqiptare bashkëkohëse", ku janë paraqitur me kumtesat e tyre studiues nga Prishtina, Shkupi (Universiteti i Tetovës) dhe Podgorica. Ku qëndron vlera e konferencave të këtij lloji dhe çfarë përfiton prej tyre gazetaria shqiptare në përgjithësi?*

Boriçi: Konferenca fillimisht u mendua të bëhej vetëm nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit - Gazetari të Universitetit tone, UFO. Tematika aktuale tërhoq vëmendjen edhe të kolegëve tanë të Universitetit Publik. Kështu u shtri edhe në media dhe institucione mësimore-shkencore të Prishtinës, të Shkupit, të Malit të Zi dhe nga diaspora, duke marrë karakter kombëtar. Pjesëmarrja aktive e studiuesve nga Kosova, Maqedonia, Prishtina dhe diaspora shqiptare i dha Konferencës ngjyrim dhe tone kombëtare. Kumtesat e tyre u pritën me interesim të veçantë dhe u vlerësuan për mendimin shkencor që sollën për aspekte të ndryshme të përmbajtjes dhe të profesionalizimit në mediat shqiptare. Kjo nismë bashkëpunimi shkencor mund dhe shpresojmë të zgjerohet, të shtrihet e të thellohet në të ardhmen, sidomos me institucionet akademike në fushën e mësimdhënies, të plan-programeve, ashtu si edhe në kërkimet shkencore. Kjo ishte kënaqësia e jonë si nismëtarë. Por, mendoj se konferencës së organizuar në Tiranë, më 30 maj 2008 në sallën e Konferencave të Universitetit UFO, ia rriti më shumë vlerën tematika e larmishme, që buronte nga realiteti i mediave bashkëkohëse dhe serioziteti i pjesëmarrësve me kumtesa, shumica pedagogë e studiues me përvojë.

Konferenca të kësaj natyre kanë rëndësi për nxitjen e përkrahjen e nismave dhe të përpjekjeve studimore me karakter kërkimor shkencor të stafit akademik e studentëve; për vështrimin kritik të problemeve më qenësore të një fushe të caktuar, në rastin tonë të dukurive më tipike e të përgjithshme të gazetarisë dhe të publicistikës bashkëkohëse shqiptare; për lidhje, bashkëpunim e bashkëveprim me universitete dhe institucione të ndryshme mediale, brenda dhe jashtë vendit tonë... Konferenca e UFO University ishte një fillesë premtuese edhe për krijimin e traditës studimore në fushën e gazetarisë, të lënë në harresë prej gati dy dhjetëvjeçarësh. ■

Fati i njeriut që sfidoi shkencën

Pse gjeniu shqiptar Rifat Gjota...

Në jetësimin praktik të zbulimit të motorit të tij, Gjota kishte ftuar edhe akademik Toma Bosanacin nga Zagrebi. I vetëdijshëm se çfarë mund të ishin pasojat e një zbulimi të tillë, akademik Bosanac i kishte thënë profesor Gjotës: “Çka t’u desh që ta bësh këtë kaos në shkencë, or Gjotë?!” I mahnitur me demonstrimin praktik të zbulimit të Rifat Gjotës, kur u nis nga Prishtina për në Zagreb, Bosanac ndër të tjera kishte deklaruar “erdha si akademik dhe po kthehem si student”.



Sabri HALILI

Ata që synojnë vepra të mëdha doemos që kanë edhe vuajtje të mëdha, thotë një filozof, duke pasur parasysh jetën e gjenive të ndryshëm dhe peripecitë e tyre jetësore. Edhe rruga jetësore, sidomos ajo fëmijërore e Rifat Gjotës ishte mjaftë e vështirë dhe me sfida të ndryshme. Ai që në vitet parashkollore ëndërronte që të bëhej “zbulues”. Ai mendohej ta realizonte këtë ëndërr me përsiatjet e tij të mendjes fëmijërore dhe në këtë aspekt dallohej prej moshatarëve të tij në lagje e në shkollë.

Rifati u regjistrua në shkollën fillore, më 1946, te mësuesi Hamdi Tabaku në Pejë. Duke i falënderuar edhe mësuesit të tij të parë, por edhe interesimit të tij për të mësuar, për ta parë sa më mirë botën, ai ishte gjithnjë i suksesshëm dhe i dalluar nga të tjerët. Qysh atëherë ai interesohej për dukurinë e rrymës dhe fshehtësitë e saj. Ai mendohej të bënte diçka që të ishte e domosdoshme për jetën e gjeneratave të ardhshme, ndërkohë që moshatarët e tij as që ëndërronin për një gjë të tillë.

Shkollën e mesme, gjimnazin, e kreu po ashtu në Pejë, më 1958. Edhe në këtë rast ai ishte entuziast për të bërë diçka të veçantë dhe për të qenë më i dalluari.



Studimet në fakultet, sfidat dhe jeta në geto e Gjotës

Menjëherë pas kryerjes së shkollës së mesme, ai u regjistrua në Fakultetin e Matematikës në Zagreb, por shumë shpejt e kuptoi se nuk dëshironte të bëhej arsimtar dhe shkoi në Lubjanë ku u regjistrua në Fakultetin e Elektroteknikës. Atje i vijoi ligjëratat vetëm një muaj dhe u detyrua të kthehet në shtëpi për shkak të kushteve të rënda materiale, por edhe të gjendjes shëndetësore momentale.

Për pak kohë ai punoi edhe si arsimtar matematike dhe në vitin 1959/60 u regjistrua në Fakultetin Elektroteknik në Shkup, në Degën e Makinerisë, në gjeneratën e parë të këtij fakulteti dhe ishte i vetmi shqiptar. Për shkak të kushteve shumë të vështira, për shkak të gjuhës dhe të përkatësisë nacionale, për shkak të rrethit të papërshtatshëm, pasi ishte i vetmi shqiptar në mesin e të tjerëve, ai e kishte tepër të vështirë të jetonte e të studionte. Megjithatë, ai, me një sforcim moral, e tejkaloi këtë sfidë të rëndë të kohës.

Për shkak se ishte student i dalluar, më 1962, Gjota, nëpërmjet Shoqatës Ndërkombëtare për këmbime tekniko-shkencore, u dërgua në një lloj specializimi për dy muaj në Gjermani, ku u njoh drejtpërdrejt me arritjet teknologjike në fabrikat gjermane dhe me prodhimet e ndryshme në Gjermani.

Gjatë studimeve të tij, më së shumti kishte shprehur interesimin për energjinë reaktive si dhe për problemet që ekzistonin me gjeneratorët dhe me

elektromotorët, me rastin e transferimit të energjisë mekanike në atë elektrike, posaçërisht gjatë matjeve nëpër trafostacione dhe objekte të tjera.

Jeta dhe puna e Rifatit në periudhën e studimeve në Shkup, qasjet e studentëve dhe profesorëve maqedonas ndaj shqiptarit të vetëm, janë tepër të dhimbshme por edhe interesante. Ai jetoi me vite në një botë të frikshme, në ankthin e një kohe të hidhur. Ishte e qartë se në atë kohë, dallimi i një shqiptari dhe imponimi me sukses aq të madh në një fushë aq komplekse shkencore, në mesin e maqedonasve apo studentëve të tjerë sllavë, do të ishte tepër sfidues dhe nuk do të shihej me sy të mirë. Shkurt, ai në atë periudhë jetonte në një geto, pikërisht në një prej qendrave të dijes dhe të kulturës.

Është mjaft interesant të theksohet fakti se kur Rifati ishte student i vitit të parë, kishte rënë një herë në provimin e matematikës. Edhe pse e kishte ditur formulën përfundimtare, ai nuk e kishte ditur se si kishte rrjedhur ai rezultat. Ky fakt nuk e kishte thyer moralin e tij të lartë në asnjë moment. Përkundrazi, në këtë rast, Rifat Gjota i kishte thënë profesorit maqedonas se nuk mërzitet për këtë, sepse, “bota është e rrumbullakët dhe do të shihen sërish në shtator”!

Ndoshta ishte ky rast momenti kur Rifat Gjota filloi përsiatjet e tij më të thella në shkencën e matematikës, ndoshta ishte ky momenti i sforcimit të idesë së tij për të bërë kthesa në vitet e ardhshme në angazhimet e tij shumë të mëdha në shkencë.

Ka mbetur në harresën e kohës?

Çfarë i tha akademiku Bosanac profesor Rifatit për zbulimin e tij?

Pas përfundimit të fakultetit, jeta e Gjotës duket të ketë qenë një jetë nomade. Ai, pasi u detyrua të jetonte një kohë të gjatë edhe jashtë Pejës, për shkak të punësimit të tij në Prishtinë, vazhonte të jetonte edhe në Pejë edhe në Prishtinë, pasi një pjesë të familjes e kishte në Pejë. Konkretisht, prej vitit 1968 deri në vitin 1970, ai jetoi në Prishtinë. Më pas u detyrua të kthehet sërish në Pejë, ndërsa në vitin 1975, fakulteti ku punonte i kishte dhënë një banesë në Prishtinë, të cilën ai e bleu më pas.

Edhe pse dëshira e tij që të arrinte në shkencë atë që nuk ishte arritur deri atëherë ishte në qenien e tij që nga fëmijëria, tani ishin pjekur kushtet që të niste rrugëtimin e tij drejt majave të paprekshme të shkencës dhe drejt të panjohurave deri në ato momente, më seriozisht dhe me një qasje më të pjekur. Ai filloi të mendonte se asgjë në shkencë nuk është e përfunduar, se të panjohurën mund ta bënte të njohur, të pamundurën ta bënte të mundshme, se kishte ardhur koha që të mos kishte tema tabu dhe që të bënte hapin e parë për ta thyer akullin që deri në atë kohë askush nuk kishte pasur guximin dhe aftësinë mendore e vepruese për ta bërë. E gjithë kjo me një shikim tjetër, të ri, me një qasje të re - tredimensionale.

Këto qasje dhe ide të reja mundësuan që më 1977 Rifat Gjota të mbrojë, pa ndonjë problem të madh, magistraturën në Universitetin e Zagrebit, me temën "Inventori me tristor 120 KW". Ai nuk u vetëkënaq

asnjëherë me këtë titull dhe më 1985 doktoroi me shumë sukses para komisionit në përbërje të të cilit ishin akademik Toma Bosanac, prof. dr. Momçillo Bogdanov dhe prof. dr. Abdurrahman Grapci, me temën e disertacionit të doktoratës, "Dirigimi i shndërruesit me inventor rrymor".

Kur prof. Gjota filloi jetësimin praktik të motorit të tij, kishte ftuar në këtë aktivitet edhe akademik Toma Bosanacin, profesorin e tij të studimeve postdiplomike. Pasi vështroi veprimin inventiv të Gjotës në shkencën e elektroteknikës, akademik Bosanac, i vetëdijshëm se çfarë mund të ishin pasojat e një zbulimi të tillë, i ishte drejtuar duke qeshur profesor Gjotës: "Çka t'u desh që ta bësh këtë kaos në shkencë, or Gjotë?!" Ai kishte mbetur i mahnitur me demonstrimin praktik të zbulimit të Rifat Gjotës dhe kur u nis nga Prishtina për në Zagreb, i kënaqur shumë me atë që kishte parë e përjetuar në shoqëri me zbulimin e ri të Gjotës, kishte deklaruar "erdha si akademik dhe po kthehem si student".

Njeriu që nuk njihte pikë në shkencë

E. H. ARMSTRONG citohet të ketë thënë për Nikolla Tesllën se "bota edhe shumë kohë duhet të presë një mendje që është e përafërt me Nikolla Tesllën, në aspektin e krijimtarisë dhe pasurisë së mendimeve". Askush nuk kishte menduar se Tesla do të arrihej nga një shkencëtar shqiptar, se pikën që kishte vënë Tesla, një shkencëtar shqiptar do ta shndërronte në presje dhe do të thoshte se "në shkencë nuk ka pikë", pasi shkenca asnjëherë nuk është e përfunduar. Pra, askush nuk do të

kishte menduar se mendja e Tesllës do të tejkalohet me një mendje më të ndritur, me një zbulim më të përsosur në elektroteknikë. Këtë, fatmirësisht e kishte arritur Rifat Gjota në vitin 1985.

Falë njohurive të larta teorike dhe praktike, punës së gjatë kërkimore e hulumtuese dhe inteligjencës së lartë teknike, ai filloi për herë të parë realizimin eksperimental të elektromotorit me parim të ri, i cili u realizua me sukses të plotë. Ky zbulim u quajt epokal dhe zgjoi vëmendjen e opinionit të gjerë shkencor në ish-Jugosllavi e më gjerë. Po këtë vit filloi edhe një fushatë e ngjeshur për sensibilizimin dhe implementimin e zbulimit të tij spektakular në fushën elektroenergjetike..

Inovacioni "Makinat komplementare" fillimisht është mbrojtur dhe patentuar në 33 shtete më të zhvilluara industrialisht si SHBA, Japoni, BRSS, Zvicër etj. Për herë të parë, në vitin 1985, profesor Rifati falë eksperiencës së tij teorike dhe praktike dhe punës shumëvjeçare kërkimore, i rreket me guxim të veçantë realizimit eksperimental të elektromotorit me parim të ri, zbulim që, për një kohë shumë të shkurtër, tërhoqi vëmendjen e opinionit shkencor. Me zbulimin e elektromotorit me parim të ri komplementar të punës, prof. Gjota ia hapi dyert vetes që të gjendet në mesin e elitës shkencore botërore dhe të prezantohet në tubime, simpoziume, ekspozita, kongrese të ndryshme të karakterit shkencor ndërkombëtar në vend e në botë. Në vitin 1986, prof. Gjota u ftua të marrë pjesë në Tubimin Ndërkombëtar të Shkencëtarëve që punojnë në hulumtimin e gjithësisë dhe në Simpoziumin ndërkombëtar të mendjeve të mëdha botërore në lëmin e elektromotorëve dhe gjeneratorëve, që u mbajt në Monter të Zvicrës. Po në këtë vit, në Torino të Italisë prof. dr. Gjota paraqiti teorinë e re për makinat elektrike dhe po në këtë vit u prezantua edhe në Universitetin e Jenit, të Nju Jorkut, të Ankarasë dhe universitete të tjera të njohura. ... (vazhdon) ■

Në numrin e ardhshëm: Përballjet me realitetin e hidhur - sfidimi në matematikë dhe kundërshtimet ndjellakeqe – ku dhe si jeton sot Rifat Gjota – çka thonë të tjerët për Rifat Gjotën – cilat ishin angazhimet institucionale për ta ndihmuar këtë njeri ...



Profesor Gjota me bashkepunetorë gjatë demonstrimit praktik të motorit të tij

Korrespondencë nga Shkupi

Mes pajtimit dhe nënshtrimit



Avni AVDIU

Më në fund zgjedhjet në Maqedoni u konkretizuan me arritjen e koalicionit qeverisës ndërmjet VMRO/DPMNE-s dhe BDI-së. PDSH-ja mbeti jashtë loje.

Hyrja e saj sërishmi në qeveri (si në vitin 2006) do të kishte qenë etikisht e pamoralshme, për shkak të diferencës së madhe të BDI-së në numrin e deputetëve prej shtatë më shumë. Shikuar në perspektivë është herët të flitet për suksesin ose mossuksesin e mundshëm të këtij koalicioni. Gjersa pikëpamja pesimiste nuk e konsideron jetëgjatë këtë farë mënyre qeverisjeje, ajo optimiste mendon se do të arrihet gjithsesi ajo që synohet, sepse qëndrimet ekstreme nganjëherë janë të prira të gjenerojnë progres. Pikëpamja skeptike e sheh pozicionin e tanishëm të shqiptarëve në bashkëqeverisje si më të dobëtin që kanë pasur ndonjëherë shqiptarët në qeveritë e këtij vendi. Në publikimin e marrëveshjes, nga ana e partisë maqedonase, thuhet se gjatë mandatit qeverisës nuk do të hapet asnjë çështje etnike (lexo: shqiptare), nuk do të miratohet ligji për flamurin, çështja e ushtarëve të luftës së 2001-shit do të realizohet në kuadër të ligjeve aktuale të Maqedonisë. Në marrëveshje nuk përfshihet as njohja



e pavarësisë së Kosovës, as bashkimi i komunës së Kërçovës me komunat përreth. Mandatari e kushtëzoi BDI-në që të mos përfshijë disa emra në poste qeveritare, ndërsa ministrat shqiptarë nuk do t'i japin llogari liderit të partisë së tyre për punën e tyre, por drejtpërdrejt kryeministrit. Kjo është ajo që është publikuar, ndonëse kuptohet se edhe BDI, nga ana e tij, duhet të ketë strategjinë e tij të veprimit, që për shkaqe të arsyeshme ndoshta edhe nuk do të bëhet publike.

Koalicioni VMRO-DPMNE –BDI i atribuohet faktorit ndërkombëtar

VMRO-DPMNE frikësohet se duke bërë koalicion me BDI-në mund të pësojë fatin e LSDM-së, e cila në zgjedhjet e sivjetme pësoi fiasko. Flitet se shumë anëtarë të VMRO-DPMNE-s janë kërcënuar mandatarit se do të largohen nga radhët e partisë nëse vendoset për bashkëqeverisje me BDI-në. Ekziston një urrejtje e madhe e kësaj partie nacionaliste ndaj partisë shqiptare, që në sfondin e saj ka historikun e luftës së 2001-shit. Tani PDSH e ndodhur në opozitë, e ka lehtë të kritikojë dhe pa kurrfarë dyshimi brenda një kohe të shkurtër do të fillojë fushatën e saj kundër këtij koalicioni, përkatësisht kundër partisë shqiptare në pozitë. Sekretari i PDSH-së në konferencën e parë për media, pas publikimit të lajmit për arritjen e marrëveshjes VMRO/DPMNE-BDI, theksoi se PDSH-ja nuk arriti marrëveshje, sepse nuk u respektuan gjashtë pikat e marrëveshjes së arritur para zgjedhjeve, ndonëse pakkush mund të besojë se pikërisht kjo mund të ketë qenë arsyeja. Më së shumti ky koalicion i atribuohet faktorit ndërkombëtar. Ndërkaq hyrja e BDI-së pa kushtëzime do t'i japë PDSH-së shkak që ta ngrejë zërin për akuza të njëpasnjëshme. Parashikimet se si do të rrjedhin gjërat me qeverinë e re, janë për momentin të pamundshme sepse është si një lloj eksperimenti që bëhet për herë të parë.

Sido që të jetë, këto zgjedhje të parakohshme, të cilat u shndërruan në zgjedhje të kohëpaskohshme, nxorën

fitues absolut kryeministrin Nikolla Gruevski. Ai arriti ta realizojë ëndrrën për të pasur 63 deputetë, në mënyrë që të mos jetë i kushtëzuar nga shqiptarët dhe që të mbjellë në mënyrë të tërthortë hasmëri ndërmjet partive politike rivale të shqiptarëve. Në momentin kur ai u prononcua se do të mund të formonte qeveri edhe pa shqiptarët dhe se ndonjë parti shqiptare do ta ftonte jo për tjetër, por vetëm nga zemërgjerësia e tij demokratike, nuk u gjet një bir nëne shqiptari në Maqedoni – një burrë i vetëm që t'i thoshte: 'ne dimë ndryshë'. Dhe në vend se t'i vardiseshin Gruevskit për t'i marrë në qeveri, do të ishte i mirë që partitë shqiptare të kujdeseshin që t'i fshinin sado-kudo mëkatet e fushatës parazgjedhore, të tregonin pjekuri politike dhe në vend se të zgjidhnin nënshtrimit ta zgjidhnin bashkimin. Do të ishte më mirë që të ishin të bashkuar e të vendosur për të mos hyrë në një qeverisje ku anashkaloheshin kërkesat e shqiptarëve. Edhe fëmijët e dinë se bashkimi bën fuqi, se taktika e palës së tretë 'përça e sundo' është funksionale gjithnjë kur palët e konfrontuara s'kanë rezon për të menduar thellësisht dhe gjerësisht. Megjithëkëtë, te shqiptarët pika e urrejtjes vloi në atë nivel sa arriti maksimumin sa që u derdh edhe gjak. Shqiptarët të ndarë në taborë luftonin për interesa të ngushta: lufta për të drejta u bë luftë për pushtet, lufta për të mirën e shqiptarëve u bë luftë për tragjedinë e tyre. Në këtë mënyrë, imazhi i shqiptarëve në përgjithësi u prish në atë masë, sa prej nesh mund të jenë zhgënjyer e neveritur edhe miqtë tanë më të mëdhenj. Zgjedhjet u përsëritën edhe më 15 dhe 29 qershor nën masa të rrepta sigurie. Kësisoj e sollëm punën të na disiplinonjë ata të cilëve më 2001 iu kthyem tytën... Prandaj, nëse nga 2001-shi është marrë ndonjë grimë lavdie e krenarie, atë tashmë, sivjet, e kemi mbuluar me vello marrëzie. E sa i përket fajit, kush më pak e kush më shumë, atij nuk mund t'i ikë askush. Bile atë e bartin edhe ato parti të vockla që morën fare pak vota. S'ka melaqe kur bëhen veprime në shërbim të dreqit. Prandaj, ne shqiptarët është

Premtohet gatishmëri dhe intervenim më serioz në rast zjarresh masive

Mobilizim i gjithëmbarshëm kundër zjarreve

“Janë bërë disa përgatitje dhe është vendosur një rregull për mobilizimin sa më të hershëm në rast të përhapjes së zjarreve në territorin e Kosovës. Gjatë intervenimit do të marrin pjesë edhe forcat e KFOR-it, si dhe TMK-ja...” - ka deklaruar Enver Oruçaj, këshilltar i ministrit Zenun Pajaziti



Burim XHEMAJLI

Ministria e Brendshme e Republikës së Kosovës, si dhe shërbimet emergjente, sidomos zjarrfikësit, kanë “mbledhur mënd” nga vera e kaluar dhe muaj më parë kanë filluar përgatitjet që, në rast të shpërthimit të zjarreve nëpër pyjet e Kosovës, situata të qetësohet menjëherë.

Blerje pajisjesh për intervenim, riparim të atyre që nuk kanë punuar si duhet, trajnime për intervenim në raste emergjente, vëzhgim më i madh nëpër terrene fushore dhe malore – janë disa nga masat që këto institucione kanë marrë për të qenë sa më të përgatitur në rast se zjarret kthehen sërish në Kosovë.

Verën e vitit 2007, në tërë territorin e Kosovës u dogjën afër gjashtë mijë hektarë tokë me pyje dhe kullosa duke u shkaktuar një dëm prej afro 4 milion eurosh. Kësaj “hallakame” të krijuar, përveç të nxehtit i kontribuoi edhe faktori njeri dhe për këtë arsye policia arrestoi rreth 60 persona.

Vëzhgim më i shtuar në terren

“Janë bërë disa përgatitje dhe është vendosur një rregull për një mobilizim sa më të hershëm në rast të përhapjes së zjarreve në territorin e Kosovës. Gjatë intervenimit do të marrin pjesë edhe forcat e KFOR-it, si dhe TMK-ja” – ka deklaruar për revistën “Paqja” Enver Oruçaj, këshilltar i ministrit Zenun Pajaziti.

“Përveç kësaj janë bërë disa riparime teknike në pajisjet të cilat kanë qenë të dëmtuara për vitin 2007” - ka

dashur të ishim më të vëmendshëm, ashtu që para se të na fusnin të tjerët “gishtin” ‘aty ku s’bën’, ta kishim vënë ne vetë ‘aty ku bën – pra në kokë’, e të mendonim më thellë për të mos u bërë gaz i botës. Kur sjell ndër mend atë që ndodhi gjatë fushatës paraelektorale dhe ditëve të zgjedhjeve, pyes veten “po të ishin gjallë Naimi, Çajupi, Asdreni e të tjerë, vallë si do ta qanin me vargje këtë mjerim mentalitetesh që godet partitë dhe popullin, që luftën për pushtet e vë mbi gjithçka, që këtë luftë e kupton si ‘jetë a vdekje’”? Duke njohur temperamentin patetik të Gjergj Fishtës kam përshtypjen se po të ishte gjallë do t’i çonte të gjithë në rr... Plot një muaj u shfrynë me gojë e kallash... demonstruan një ‘logjikë’ mjerane që s’mendonte më larg se sa hija e karriges. U harrua se partitë vijnë e shkojnë, se të këqijat, të zezat e të ligat e bëra mund të mbesin sot për sot edhe nën hije, por, megjithatë, vjen një ditë kur ato do të shkruhen në faqet e historisë. Për të prekur ndjenjat e popullit u luajt edhe në kartën e Kosovës. PDSH-ja, gjersa ishte në qeveri, tha se prej saj varej njohja e pavarësisë, kurse BDI-ja u shpreh se posa të vinte në pushtet vendi do ta njihte pavarësinë e Kosovës. As njëra e as tjetra. Nga dëshira për t’u vetëfaktorizuar, të gjitha partitë shqiptare e humbën toruan. Ato harruan se në rrethanat e krijuara mund të bëheshin faktorë vetëm të bashkuara, e jo të ndara, të armiqësuar dhe nënshtruara. Fatkeqësisht u humbi ndjesia për t’u skuqur... u bë çmos dhe nuk mbeti gjë pa u bërë. Historia do t’i shënojë me emër e mbiemër të gjithë protagonistët e këtyre ngjarjeve famëkeqe. Dhe kush nuk i frikohet historisë mund ta godasë mallkimi edhe nga ndonjë ofshamë e thjeshtë, sepse kur zullumi trashet së tepërmi, ai këputet nga vetë trashësia e tij. Një zë i mekur engjëllor duket se dëgjohet në brendi të ndërgjegjeve të pastra. Ai troket përbrenda lëkurave të tyre të ngushta. Është inkarnuar ndonjë dëshmor që luftoi për ideale, i cili nuk mund të durojë nën tokë trakullimën e këmbëve e as në qiell buçitjen e zërave që premtajnë shumë e s’bëjnë asgjë.

Gjersa, nga njëra anë, të tjerët mund të qeshin, nga ana tjetër të vjen të qash tek e sheh këtë popull të dënuar për t’u përballur me Luciferin, në pamundësi arratisjeje për ta kaluar Urën e Siratit. ■



thënë Oruqaj, duke shtuar së janë blerë edhe një sasi pajisjesh.

Oruqaj ka theksuar se në fund të muajit maj është bërë një trajnim i përbashkët mes TMK-së, KFOR-it dhe njësiteve të zjarrfikëseve. Sipas tij, këto trajnime kanë shërbyer që në vitin 2008 njësitet përkatëse të përballen më profesionalisht me zjarrin.

Këshilltari i ministrit Pajaziti ka theksuar, gjithashtu, se shërbimet emergjente gjatë kësaj vere do të jenë më shumë prezent nëpër terrenet fushore, sidomos nëpër ato ku ka pasur ara të mbjella me grurë, meqë vitin e kaluar, shumica e zjarreve u përhapën nga stërnishtat të cilave ua kishin vënë zjarrin pronarët.

Ndërkohë edhe shërbimet e zjarrfikësve duket së kanë bërë përgatitjet e tyre që të intervenohet sa më shpejt në rast të përhapjes së zjarreve masive.

Viktor Krasniqi, komandat i shërbimit të zjarrfikësve në Prishtinë, i ka thënë revistës "Paqja", se për momentin nuk është bërë ndonjë mobilizim 24 orësh, por, sipas tij, përgatitje për të qenë sa më të gatshëm në këtë kohë, janë bërë vazhdimisht. Edhe Krasniqi ka thënë së brigadat e zjarrfikësve do të jenë këtë verë më shpesh në terren për të vëzhguar situatën.

"Pajisjet që kemi janë funksionale, por jo edhe aq të mjaftueshme. Këto pajisje që kemi mund të kryejnë punë në vendet fushore dhe malore" - ka thënë Krasniqi, duke shtuar se presin që këtë muaj t'u vijnë disa automjete të reja.

"Ne, qysh më herët, edhe tani jemi në kontakt të vazhdueshëm me SHPK-në, TMK-në dhe KFOR-in që në rast zjarresh masive të intervenojmë së bashku" - ka thënë Krasniqi duke shfaqur shpresën se sivjet nuk do të ketë probleme me ujin. Sipas Krasniqit, brigada në Prishtinë ka gjetur paraprakisht disa pika furnizuese që të furnizohet në rast nevojë.

Ndërkohë që edhe zyrtarë të SHPK-së i kanë thënë se do të jenë të gatshëm për të reaguar në rastet kur shërbimet emergjente do të kenë nevojë për ta.

Mbetet të shihet në ditët dhe muajt në vazhdim nëse kjo gatishmëri dhe kjo përgatitje do të jetë efektive. ■

Vallëzimi i bletëve



Bujar SEJDIU

Ndoshta shumë prej njerëzve ndihen krenarë që janë të vetmet krijesa në këtë planet që janë pajisur me të folur dhe ndihen krenarë për mundësinë e tyre për komunikim.

Po të dalim në natyrë dhe të veshetrojmë jetën që bëjnë llojet e ndryshme të botës shtazore, në shikim të parë do të mendojmë se jeta e tyre është krejtësisht e paorganizuar dhe se ato jetojnë vetëm sipas rastësisë.

Por, po të ndalemi t'i analizojmë lëvizjet e tyre dhe ta studiojmë jetën e tyre, sigurisht që do të mbeteshim të shtangur dhe të habitur. Asnjëherë nuk do të na kishte shkuar mendja se kafshët kanë mundësi të jetojnë në një organizim shumë preciz dhe aq efikas.

Të gjitha krijesat kanë mënyrën e tyre të veçantë të organizimit të shoqërisë së tyre. Por, janë të rralla ato krijesa që mund të jenë më mahnitëse se sa bletët. Ato jetojnë në një shoqëri shumë interesante dhe mjaft të komplikuar. Shoqëria e tyre përbëhet prej mbretëreshës, rojeve, ndërtesave, pastruesve, shërbimit inteligjent-zbulues, prodhuesve të mjaltit, teknikëve për ftohje dhe ngrohje, infermierëve, mbledhësve të nektarit, polenit, ujit, rrëshirës dhe secila bletë gjatë jetës së saj kalon nëpër disa prej këtyre punëve. Ato qeverisin me një sistem politik demokratik ku të drejtë vote ka secili anëtar, por është interesante se mbretëresha është pa të drejtë vote. Ato ndërtojnë shtëpi-hoje shumë komplekse me dhoma të bukura në formën e heksagoneve perfekt. Kryejnë lëvizje shumë të shkathëta fluturuese. Ato dallojnë më shumë ngjyra dhe aroma se sa ne. Ato kanë mundësi ta shohin strukturën e polarizimit në qiell. Dhe çka është shumë interesante, ato komunikojnë mes vete me


Bletët komunikojnë mes vete me një gjuhë unike që nuk gjendet te asnjë mbretëri tjetër. Ato përdorin një mjet komunikimi shumë të sofistikuar dhe të saktë që nuk është as radioja, as interneti, por gjuha e tyre simbolike e cila njihet si "vallëzimi i bletëve".

një gjuhë unike që nuk gjendet te asnjë mbretëri tjetër e kafshëve. Ato përdorin një mjet komunikimi shumë të sofistikuar dhe të saktë që nuk është as radioja, as interneti, por gjuha e tyre simbolike që njihet si: "vallëzimi i bletëve".

Përdorja e diellit si kompas

Në librin "Historia e kafshëve" (Historia Animalium), Aristoteli shkruan: "Çdo bletë kur kthehet është e shoqëruar nga tre apo katër përcjellës... se si e bëjnë këtë ende nuk është observuar".

Pas Luftës së Dytë Botërore, i fascinuar nga puna e përbashkët e bletëve, natyralisti austriak Karl von Frisch, filloi një studim më të thellë të organizimit të bletëve. Gjatë vëzhgimit të bletëve ai arriti të përgjojë bisedat e bletëve dhe ta interpretojë gjuhën e tyre simbolike. Ai kishte kuptuar që lëvizjet e tyre në formën e tetëshes nënkuptonin p.sh. nektari 1.5 km larg në drejtimin 30



shkallë nga pozita momentale e diellit. Ai i habitste fqinjët e tij kur u tregonte që bletët e tij ishin ushqyer në fermat e tyre të cilat ai nuk i kishte parë.

Ai e kishte kuptuar këtë fakt, por ishte i habitur se si ka mundësi që bleta ta dijë pozitën e diellit? Eksperimentet e mëhershme kishin vërtetuar që bletët përdorin diellin si kompas. Edhe pse ishte e vështirë për t'u besuar, Frisch konkludoi që bletët mund ta dallonin modelin e polarizimit në qiell.

Bletët pasi e gjejnë nektarin diku në natyrë, pa marrë parasysh distancën, nuk janë egoiste të ushqehen vetëm për vete. Ato kthehen në zgjojet e tyre për t'i informuar edhe bletët e tjera për vendndodhjen e nektarit dhe këtë e bëjnë përmes gjuhës së tyre unikalë komunikuese: vallëzimit.

Pasi kthehen në zgjoje, bletët ua komunikojnë vendndodhjen e nektarit bletëve të tjera duke vallëzuar në një vend të veçantë të dhomës që njihet si fusha e vallëzimit. Zakonisht fusha e vallëzimit gjendet afër hyrjes, por ndonjëherë mund të lëvizë edhe më brenda. Në natyrë dhomat apo fletëzat janë në pozitë vertikale dhe performanca bëhet në rrafsh vertikal. Kjo ka në vetvete një domethënie të madhe pasi informatat për orientime horizontale duhen dhënë në një rrafsh vertikal. Por ndodh që vallëzimi të bëhet edhe në rrafsh horizontale.


Vallëzimi rrethor

Kur bletët e gjejnë ushqimin afër zgjoit ato kryejnë një vallëzim shumë të thjeshtë, që njihet si vallëzimi rrethor. Ky vallëzim nuk ofron shumë informata, por është thjesht një dhënie sinjali. Bleta kërkuese vallëzon përgjatë një rrethi të vogël duke lënë një qeli brenda rrethit. Bletët e angazhuara e përcjellin vallëzuesen pastaj fluturojnë për kërkimin e ushqimit dhe këtë e bëjnë në çdo drejtim, por në afërsi të zgjoit. Po ashtu bleta vallëzuese mund të transmetojë aroma të cilat janë të njohura për disa

bletë që janë ushqyer në lule të njëjta dhe, me këtë rast, bletët fluturojnë direkt te ato lule.

Vallëzimi i lojës me bisht

Kur caku është më larg, bletët kanë nevojë për një komunikim më të sofistikuar. Nëse ushqimi është i pakët, bletët udhëtojnë për ushqim deri në 15 km dhe në krahasim me përmasat e vogla të këtij insekti kjo distancë është mjaft e madhe. Vallëzimi i lojës me bisht u tregon bletëve të tjera në mënyrë shumë



të saktë se në çfarë d i s - tance dhe çfarë drejtimi gjendet ushqimi, ashtu që ato të shkojnë vetë për ta kërkuar.

Në një vallëzim tipik të lojës me bisht (Fig. 1) bleta e mjalit (*Apis Mellifera*) vrapon drejt në një distancë të shkurtër dhe pastaj bën një kthesë duke formuar pastaj një gjysmërreth deri te pika startuese, vrapon përsëri në të njëjtën vijë në distancë të njëjtë duke bërë përsëri një gjysmë rreth, por tash në anën e kundërt dhe kjo gjë përsëritet kështu me një vazhdimësi të rregullt. Vrapimin gjatë pjesës nëpër

trajektoren e drejtë e bën me vull dhe duke kryer një vibrim anësor të trupit. Gjithashtu gjatë vallëzimit ajo emiton edhe zë. Është interesante që spektatorët e vallëzimit përmes një fishkëllime mund ta ndalin vallëzuesen për t'iu dhënë një shije të nektarit.

Llogaritja e distancës

Lidhja reciproke mes distancës dhe gjatësisë kohore të vallëzimit është baza e kësaj informate. Me rritjen e distancës numri i vallëzimeve apo rretheve për njësi të kohës zvogëlohet, ndërsa vet gjatësia dhe koha e rrethit apo vallëzimit rriten. P.sh. nëse distanca është 100 m bleta bën 10 vallëzime të shkurta për 15 sekonda, por nëse distanca është 3 km atëherë bleta performon vetëm 3 vallëzime të gjata për të njëjtën kohë. Dhe kështu bletët e angazhuara e llogarisin distancën me një precizitet mbresëlënës.

E tëra kjo është një mrekulli që do ta habitte çdonjërin, ashtu sikurse kishte habitur natyralistin Karl von Frisch dhe në shikim të parë do të tingëlonte e pabesueshme apo thjesht një rastësi. Për natyralistin Karl von Frisch ishte e paqartë se si bletët kishin mundësi ta dinin pozicionin e diellit, edhe pse më vonë kishte ardhur në përfundim se kjo specie e dallon polarizimin në qiell.

Por ajo çka e sqaron më së miri këtë fenomen kaq interesant është fjala e Krijuesit të këtij insekti, i cili në Kur'anin Famëlartë, në versetet 68 dhe 69 të kapitullit të quajtur Bleta, thotë: **“Zoti yt i dha instinkt bletës: “Ndërto shtëpi nëpër kodra (male), nëpër drurë (pemë) dhe nëpër kulmet që ata (njerëzit) i ndërtojnë. Pastaj ha nga të gjitha (llojet) frutat dhe futu nëpër rrugët e nënshtuara (e të mësuar) prej Zotit tënd. Nga barqet e tyre (të bletëve) del lëng, ngjyra e të cilit është e ndryshme dhe në të cilin ka shërim (bar-ilaç) për njerëz. Edhe në këtë ka arsye për atë popull që mendon thellë.”** ■

Mitrovica – arenë e problemeve ndëretnike



Florije ADEMI

Situata politike dhe ajo e sigurisë në qytetin buzë Ibrit, të ndarë në baza etnike nga mbarimi i luftës në Kosovë, është keqësuar dukshëm pas 17 shkurtit 2008 kur u shpall Pavarësia e Kosovës.

Punëtorët shqiptarë të gjykatave dhe doganave, të vetmet institucione të Kosovës që punuan deri atëherë në veriun e Mitrovicës dhe Kosovës, u dëbuan me dhunë nga vendet e tyre të punës dhe, me gjithë premtimet e deritanishme të zyrtarëve të lartë vendorë dhe atyre të UNMK-ut, nuk u kthyen më atje.

Ndonëse institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare u shprehën kundër mbajtjes së zgjedhjeve serbe në Kosovë duke pasur parasysh definimin e statusit të saj si shtet i pavarur, ato u lejuan të mbahen në territorin e Kosovës, edhe pse deklarativisht konsiderohen si ilegale.

Faktorizohen strukturat paralele serbe

Për të dëshmuar edhe një herë sistemin paralel të tyre, pas mbarimit të zgjedhjeve serbët mbajtën kuvendin serb dhe zgjedhën strukturat e tyre të cilat funksionojnë ilegalisht apo legalisht në veri të Kosovës, ku zbatohen ende ligjet e Serbisë e jo të shtetit të Kosovës.

Pasojat e lejimit të mbajtjes së zgjedhjeve serbe në veri, sot po reflektohen në praktikë. Pas shumë angazhimeve të banorëve shqiptarë të asaj pjese të qytetit për fillimin e rindërtimeve të pronave të tyre për t'i paraprirë procesit të kthimit atje, komuna e Mitrovicës ndau mjete për rindërtim në "Luginën e Doktorëve" dhe filloi realizimin e projektit të ujësjellësit në fshatin Suhodoll.

Mirëpo, serbët, të ndikuar nga strukturat e dala nga zgjedhjet kontestuese që dëshirojnë me çdo kusht të bëhen faktor, pengojnë çdo projekt të filluar.

Para një kohe u ndërpre punimet për rindërtim në "Luginën e Doktorëve" në mënyrë që të shmangen tensionet, ndërkohë që ndërprerjes së punëve në ndërtimin e

ujësjellësit në Suhodoll i kanë paraprirë disa incidente ndëretnike, që u zhvilluan në prani të forcave të KFOR-it dhe atyre të UNMIK-ut.

I pari i komunës së Mitrovicës, Bajram Rexhepi, që këmbëngul se nuk dëshiron të bisedojë për asnjë çështje me strukturat e dala nga zgjedhjet e kontestuarra, deklaroi çdo ditë se në veri ose do të ketë rindërtim edhe për shqiptarët ose s'do të ketë fare.

Por, si duket, ai nuk e ka përkrahjen e institucioneve qendrore të Kosovës në këtë drejtim, siç u tha edhe në një debat për Mitrovicën që u mbajt në objektet e kësaj komune nën organizimin e OJQ-së "Me dorë në zemër", e aq më pak përkrahjen e ndërkombëtarëve të cilët për shumë vite dëshmuuan njëanshmëri në punën e tyre në këtë rajon, duke lejuar qeverinë e Serbisë të ndërtojë objekte për banim kolektiv e, në anën tjetër, duke penguar direkt apo indirekt ndërtimet shqiptare atje.

Këtë e dëshmon edhe rasti konkret i projektit për ndërtimin e shkollës në lagjen veriore "Kodra e minatorëve", i cili pret prej disa muajsh vetëm dritën e gjelbër nga ndërkombëtarët.

Përkundër problemeve të shumta me të cilat ballafaqohet Mitrovica e pasluftës, para një muaji e gjysmë, me urdhër të Qeverisë së Kosovës, në afërsi të Parkut Industrial "Trepça" janë vendosur tri maune me materie helmuese që i kanë irrituar tepër qytetarët e kësaj komune, në veçanti banorët në afërsi të cilët janë brenjosur për shëndetin e fëmijëve të tyre.

Ka disa ditë që, me organizimin e disa organizatave joqeveritare dhe disa partive politike që veprojnë në këtë qytet, po mbahen protesta për largimin e tyre nga Mitrovica, duke vlerësuar se kjo i është dashur më së paku Mitrovicës së stërngrakuar me probleme.

Kryetari i kësaj komune, Bajram Rexhepi, e konsideron legjitime kërkesën e tyre, mirëpo, sipas tij, komuna para së cilës janë mbajtur disa sosh është adresë e gabuar, pasi është Ministria e Ambientit ajo që është duke u marrë me procedurat e asgjësimit të materieve që janë në ato maune. Ndonëse, sipas Rexhepit, komuna është injoruar nga autoritetet që kanë mar-

rë vendim për vendosjen e tyre në territorin e Mitrovicës, ai tha se ka kërkuar nga ata që të bëhet një zgjidhje për to.

Mripa: Zyrtarët e UNMIK-ut në Mitrovicë deri më tani kanë zbatuar politikën e Koshtunicës

Qytetin e problemeve, Mitrovicën, këto ditë e ka vizituar shefi i ri i UNMIK-ut në Kosovë, Lamberto Zannieri i cili është takuar në veriun e këtij qyteti me përfaqësues të serbëve dhe shqiptarëve. Kreu i UNMIK-ut me këtë rast ka thënë se negociatat për statusin e Kosovës kanë përfunduar, ndërkohë që është njohur me shqetësimet dhe brengat e banorëve.

Musa Miftari, përfaqësues i OJQ-së "Bregu i Veriut", thotë se ata ia kanë përcjellë kryeadministratorit shqetësimet për pengesat që po i bëjnë serbët dhe UNMIK-u në lidhje me procesin e rindërtimit dhe kthimit të të dëbuarve nga pronat e tyre dhe se ai ka premtuar se do të angazhohet që t'i përmirësojë gabimet që janë bërë në këtë drejtim. Zanieri ka përmendur si prioritet kthimin e punëtorëve në gjykata dhe rifillimin e punës, për t'u ballafaquar me kriminalitetin që ka lulëzuar në veri.

Adem Mripa, përfaqësues i shqiptarëve të "Lagjes së Boshnjakëve", e ka njoftuar Zannierin se zyrtarët e UNMIK-ut në Mitrovicë kanë zbatuar deri më tani politikën e Koshtunicës për spastrimin e shqiptarëve që jetojnë në veri të qytetit.

Zannieri u ka kërkuar autoriteteve komunale të jugut që t'i ndërpresin për disa ditë punët në ndërtimin e ujësjellësit në Suhodoll, derisa të gjendet një zgjidhje për këtë.

Në anën tjetër, kryetari Rexhepi, i cili është pajtuar për ndërprerjen e punëve, ka deklaruar se në rast se UNMIK-u nuk ofron zgjidhje brenda një kohe të shkurtër punët do të rifillojnë.

Sidoqoftë, Mitrovica, nëntë vite pas përfundimit të luftës, vazhdon të mbetet arenë e problemeve etnike dhe ndëretnike edhe pse situata e sigurisë në këtë qytet, pas incidenteve të fundit në Suhodoll, vlerësohet e qetë nga zyrtarët komunalë dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

Roli i familjes në shoqëri dhe sfidat e saj

Mirëqenia familjare mund të arrihet përmes një faktori shumë të rëndësishëm, pra kujdesit të anëtarëve të saj në mënyrë që ata të ndihen të rëndësishëm në rolin e tyre brenda familjes



Mirsad KUTELI

Familja sipas Islamit është një institucion hyjnor, origjina e së cilës është që në krijimin e njeriut të parë. Është fakt natyror se njerëzit e lidhin jetën e tyre me shtëpinë dhe familjen, ngase aty e kalojnë pjesën më të madhe të kohës, duke gjetur qetësi, respekt, mbrojtje, dashuri dhe lumturi. Shtëpia është vendi ku familja, si bashkëshortët ashtu edhe fëmijët, marrin edukatën për jetën që kanë nisur. Andaj, me të drejtë familja është konsideruar si shkolla e parë ku njerëzimi hedh hapat e parë të arsimimit. Në këtë kuadër, brenda familjes prindërit luajnë një rol të dyfishtë, pasi ata përveç funksionit të sigurimit të mirëqenies sociale kanë edhe funksion edukativ. Fillimisht, fëmijët priren që t'i imitojnë prindërit e tyre. Kjo është edhe si rrjedhojë gjenetike e lindjes, por më pas ata veprojnë ashtu, ngaqë prindërit e tyre janë qeniet më të dashura dhe më të rëndësishme për ta. Dashuria, sinqeriteti dhe respekti ndaj familjes krijon një klimë humori të mirë dhe shprehje të lirë të mendimeve. Andaj, është e këshillueshme që prindërit të jenë më mendje hapur dhe të nxisin komunikimin e lirë brenda familjes, posaçërisht me fëmijët, në mënyrë që ata të shprehin lirshëm mendimet e tyre. Kështu ata do të ndihen të rëndësishëm pasi fjala e tyre dëgjohet. Mirësjellja hap rrugën drejt fatit. Për ta kuptuar rolin e martesës në shoqërinë njerëzore, së pari duhet ta kuptoni qëllimin e saj...

Nuk duhen shikuar vetëm të metat

Është fakt i pranuar se edhe jeta e shëndoshë dhe e qëndrueshme familjare ka probleme të veçanta. Andaj, nuk

duhet pritur që të plotësohen të gjitha kërkesat nga ana e familjarëve. Në situata të tilla, nuk duhen shikuar vetëm të metat. Në raste të tilla përpiqu të kujtosh të mirat që ke përfituar dhe tregohu mirënjohës. Për këtë, Henry Risner thoshte se dashamirësia është veti e shpirtit që di të mos e vërejë gardhin e thyer në oborr dhe ta drejtojë shikimin te trëndafilat që lulëzojnë në anën tjetër të rrugës. Shpeshherë problemi qëndron në perceptimet tona, në atë se çfarë presim ne nga të tjerët. Kur ndodh që shpresat tona nuk realizohen, situata rëndohet. Nuk duhet të merremi me paragjykime. Duhet ta pranojmë situatën ashtu si është. Të përpiqemi ta ndryshojmë për të mirë. Mbi të gjitha, duhet ta kuptojmë se jeta jonë reale nuk është si bota e filmit, apo si një roman fantastik. Duhet bërë dallimi i botës reale nga ajo areale. Një fakt tjetër i rëndësishëm me të cilën po përballet aktualisht shoqëria jonë shqiptare është faktori punë. Shpeshherë bashkëshortët kanë probleme të ndryshme në lidhje me profesionin dhe punën e bashkëshortit. Sugjerojmë se që nga momenti i parë gruaja apo edhe burri duhet të pajtohen me profesionin që ushtron bashkëshorti/bashkëshortja. Është fakt se sjellja jonë është kushtëzuar si në punë, ashtu edhe në familje. Si organizata ku punojmë, ashtu edhe familja duhet ta pranojë dhe kuptojë individin si tërësi. P.sh. kompania që punëson një person duhet të dijë se personi në fjalë ka edhe përkushtime familjare të patejkalueshme, të cilat në momente të caktuara mund të shkaktojnë probleme të cilat do të reflektohen edhe në ambientin e tij të punës. Nga ana tjetër, shpeshherë na ndodh që kur kemi probleme të pazgjadhura në organizatën ku punojmë, t'i bartim problemet e tilla edhe jashtë orarit të punës kur kthehemi në familje. Në këtë drejtim, duhet pasur kujdes i madh që problemet e tilla mos t'i përdorim si shkarkim mllëfi ndaj anëtarëve të familjes sonë, por të përpiqemi që t'i paraqesim në atë formë

që të kërkojmë sugjerime dhe këshilla për zgjidhjen e problemeve të caktuara. Kjo do të kishte një impakt pozitiv për familjen, ngase ata do të ndiheshin të rëndësishëm dhe të dobishëm. Kështu do të rritet edhe besimi dhe harmonia në familje. Në të kundërtën, do të mbizotëronte disharmonia dhe do të kishte efekte negative.

Mirënjohja apo komplimentet si forma vlerësuese

Dëshira që të jemi në qendër të vëmendjes tek të tjerët buron që nga fëmijëria e hershme. Fëmija, që në fazën e parë të njohjes së realitetit, paraqet kërkesat e tij fillestare që edhe ai të jetë i rëndësishëm për familjen dhe që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë. Një situatë e tillë e përcjell atë edhe në fazat e mëvonshme të rritjes. Në shkollë ai kërkon të jetë më i pranuar tek nxënësit e tjerë si dhe më i shquar para mësuesve të tij. Më vonë, kur fëmija arrin fazën e maturisë dhe martohet, paraqet kërkesa të reja. Pra, lind nevoja e rëndësishme, respektit dhe dashurisë së bashkëshortëve në mënyrë reciproke. Andaj, mirëqenia familjare sigurohet përmes kuptimit të mirëfilltë të këtij faktori mjaft të rëndësishëm, por që shpeshherë neglizhohet me apo pa vetëdijen tonë. Pakujdesia ndaj këtij faktori mund të shpie në konsekuenca negative: prishje e harmonisë dhe mirëqenies familjare, si dhe devijimi i fëmijëve nga rruga e drejtë, në rastet kur ata mendojnë se nuk u kushtohet vëmendje dhe kujdes i duhur nga prindërit. Pra, mirënjohja apo komplimentet si forma vlerësuese ndaj personave janë principe latente, por esenciale të shoqërisë njerëzore. Shumë njerëz në botë kanë arritur suksese të mëdha në jetë falë komplimenteve të mira. Komplimentet shprehen përmes fjalëve, të cilat nuk kushtojnë as në parë, madje as në kohë. Mjafton, vetëm që t'i përdorim në kohën e duhur dhe me sensin e duhur. ■

Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Rikonfigurimi...

Demir RESHITI

Qershori ka qenë muaji më i varfër sa i përket njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës. Gjatë këtij muaji, vetëm një shtet (Sierra Leone), e ka njohur pavarësinë e Kosovës, ndërkohë është vërejtur edhe një zbehje e pranisë së Kosovës në agjandat e politikës ndërkombëtare.

Vendosja e misionit të BE-së, EULEX dhe rikonfigurimi i UNMIK-ut, kanë qenë objekt diskutimi në instancat më të larta ndërkombëtare të vendimmarrjes.

Vendimin e sekretarit të OKB-së Ban Ki Moon për rikonfigurimin e UNMIK-ut e ka përkrahur edhe BE-ja. Shefat e shteteve ose të qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian, në draftin e konkluzioneve të takimit të tyre në Bruksel, kanë përshëndetur raportin e kreut të OKB-së lidhur me rikonfigurimin e UNMIK-ut, duke vlerësuar se kjo hap rrugë për vendosjen e misionit EULEX-it në territorin e Kosovës.

Ndërkohë në takimin e ministrave të mbrojtjes të NATO-s në Bruksel është rënë dakord që kontingjenti prej 16 mijë ushtarësh i KFOR-it të marrë përsipër në të ardhmen edhe përgatitjen e trajnimit e Forcës Mbrojtëse Kosovës...

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit qershor 2008.



Benita Ferero-Waldner

(3 qershor) Waldner: BE-ja është e bindur se Kosova ka perspektivën e integritit evropian

Bruksel – “Bashkimi Evropian është e bindur se një Kosovë stabile, demokratike

dhe multietnike ka perspektivën e integritit evropian” - ka deklaruar komisionerja e BE-së për marrëdhënie ndërkombëtare dhe politikë të fqinjësisë Benita Ferero-Waldner.

(5 qershor) Rohan: Prania e dy misioneve ndërkombëtare në Kosovë krijon situatë të paqëndrueshme

Londër – Ish -ndërmjetësi i OKB-së për statusin e Kosovës, Albert Rohan, në një intervistë dhënë BBC-së, ka thënë se prania paralele e dy misioneve ndërkombëtare, atij të BE-së dhe misionit të OKB-së në Kosovë do të krijonte një situatë absurde dhe të paqëndrueshme.

(6 qershor) Gjermania ua vazhdon mandatin trupave të saj në Kosovë

Bon - Bundestagu gjerman ka miratuar me shumicë votash qëndrimin e ushtarëve gjermanë edhe për një vit në Kosovë. Në diskutimet e bëra për këtë temë, deputetët gjermanë kanë theksuar se situata në Ballkan është ende e brishtë dhe shpërthyes në planin e sigurisë dhe se ajo nuk është qetësuar plotësisht as pas tetë vitesh qëndrimi të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë.



Sergey Lavrov

(7 qershor) Lavrov : Nuk mund të imponohet vendosja e EULEX-it në Kosovë


Beograd - Shefi i diplomacisë ruse, Sergey Lavrov ka deklaruar se vendosja e misionit civil të Bashkimit Evropian, EULEX, në Kosovë, nuk mund të imponohet. Çfarëdo forme e pranisë së mëtutjeshme ndërkombëtare në Kosovë duhet të jetë e pranueshme për të dyja palët – si për Prishtinën ashtu edhe për Beogradin - ka deklaruar Lavrov për mediat serbe.

(11 qershor) Ushtarëve zviceranë në Kosovë u vazhdohet mandati deri më 2011

Bernë -Parlamenti i Zvicrës ka votuar për zgjatjen e mandatit ushtarëve të këtij vendi që shërbejnë në kuadër të forcave shumëkombëshe KFOR në Kosovë, deri në vitin 2011. Forca zvicerane ka qenë pjesë e forcave shumëkombëshe të KFOR-it në Kosovë, që nga viti 1999.

(12 qershor) NATO do të përgatisë ushtrinë e re të Kosovës

Bruksel - Në takimin e ministrave të mbrojtjes të NATO-s në Bruksel u ra dakord që kontingjenti prej 16.000 ushtarësh i KFOR-it në Kosovë, të marrë përsipër në të ardhmen edhe përgatitjen e trajnimit e ushtrisë së ardhshme të Kosovës. Spanja sipas të dhënave të ambasadorit të saj në NATO nuk do të marrë pjesë në këtë mision, pasi qeveria në Madrid nuk e ka njohur Kosovën. Megjithatë, ky vend do të vazhdojë të angazhohet brenda KFOR-it.



Sierra Leone

(13 qershor) Sierra Leone e njeh Republikën e Kosovës

Freetown - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar e Republikës së Sierra Leones, nëpërmjet një njoftimi verbal ka njoftuar Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, se Republika e Sierra Leones e ka njohur Republikën e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

(16 qershor) Engel: Moska e Beogradi nuk duhen lejuar që ta destabilizojnë Kosovën

Prishtinë -Kongresisti amerikan Eliot

Engel, në një fjalë rasti në Kuvendin e Kosovës, ka përsëritur përkrahjen e vazhdueshme të SHBA-së për Republikën e Kosovën, duke theksuar se komuniteti ndërkombëtar duhet ta kuptojë se Republika e Kosovës është e përhershme dhe e qëndrueshme dhe se Moska e Beogradi nuk duhen lejuar që ta destabilizojnë Kosovën. "Misioni i OKB-së në Kosovës tashmë është i përfunduar dhe duhet t'i bartë të gjitha kompetencat te qeveria dhe EULEX-i" - ka thënë Engel.



Bernard Kouchner

(17 qershor) Kouchner: OKB e domosdoshme edhe për një kohë në Kosovë

Paris - Shefi i diplomacisë franceze, Bernard Kouchner, ka deklaruar se Franca do të bashkëpunojë me Komitetin e Bashkuarë për Kosovën, duke shtuar se KB do të jetë e domosdoshme edhe për një kohë në Kosovë. Ndërkaq për misionin e BE-së në Kosovë tha se duhet të jetë një nga shtyllat e UNMIK-ut.

(19 qershor) Bush e Stanishev kanë biseduar për Kosovën

Uashington - Presidenti amerikan, George Bush dhe kryeministri i Bullgarisë, Sergej Stanishev, gjatë takimit në Shtëpinë e Bardhë kanë biseduar edhe për Kosovën. Presidenti amerikan e ka falënderuar Stanishevin për rolin që ka luajtur Bullgaria në Ballkanin Perëndimor.

(20 qershor) Bashkimi Evropian mbështet propozimet e Ban Ki Moonit

Bruksel - Shefat e shteteve ose të qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian, në draftin e konkluzioneve të takimit të tyre në Bruksel, kanë përshëndetur raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Ban Ki Moon, lidhur me rikonfigurimin e UNMIK-ut, duke vlerësuar se kjo hap rrugë për vendosjen e misionit EULEX-it në territorin e Kosovës.



Javier Solana

(21 qershor) Solana mirëpritur raportin e kreut të OKB-së, Bani Ki Moon

Bruksel - Përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme dhe siguri Javier Solana, e ka mirëpritur raportin e sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, Bani Ki Moon, prezantuar në Këshillin e Sigurimit gjatë debatit për rikonfigurimin e UNMIK-ut në Kosovë.

(24 qershor) Frattini: Zannier do të dijë të punojë mirë

Londër - Shefi i diplomacisë italiane, Franco Frattini, në një intervistë për BBC-në, ka vlerësuar se Italia është një vend që luan një rol pozitiv në Kosovë dhe Ballkan. Ai ka shprehur bindjen e tij se, përfaqësuesi i lartë i Ban Ki-Moonit në Kosovë, italianin Lamberto Zannier, do të dijë të punojë mirë.

(25 qershor) Zanier: Edhe pas 120 ditësh UNMIK-u do të ketë rol domethënës

Romë - Shefi i ri i UNMIK-ut, Lamberto Zanier ka deklaruar se rikonfigurimi i UNMIK-ut do të përcillet me ndërrime sa i përket funksionimit të këtij institucioni, i cili do t'i përshtatet realitetit të ri në Kosovë. Sipas tij edhe pas 120 ditësh, UNMIK-u do të ketë rol domethënës në një numër të caktuar të fushave.

(26 qershor) SHBA e vlerëson të drejtë vendimin e Ban Ki Moon-it

Uashington - "Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë quajtur sërish një hap të drejtë vendimin mbi rikonfigurimin e rolit të UNMIK-ut nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Ban Ki Moon" - ka deklaruar në Uashington një zyrtar i lartë i administratës së presidentit Bush.



Ban Ki-Moon

(27 qershor) Ban Ki Moon: Rikonfigurimi një zgjidhje më pak e kundërshtueshme

Nu Jork - Sekretari i OKB-së, Ban Ki Moon, në një konferencë për shtyp në Nju Jork ka folur edhe për rikonfigurimin e rolit të UNMIK-ut në Kosovë dhe raportin që i prezantoi Këshillit të Sigurimit më 20 qershor, duke thënë se ishte i vetëdijshëm se propozimet e tij nuk do t'i kënaqnin të gjitha palët. "Mirëpo vazhdoj të besoj se kjo është një zgjidhje më pak e kundërshtueshme për ta menaxhuar situatën" - ka theksuar kreu i OKB-së.

(29 qershor) Serwer e Petersen kërkojnë më shumë presion ndaj Beogradit për të penguar ndarjen e Kosovës

Uashington - Situata e krijuar në Kosovë në këtë periudhë kalimtare e transferimi kompetencash, si dhe përpjekjet e pareshtura të Beogradit për ta arritur një ndarje de facto të Kosovës, kanë ngjallur shqetësim tek mbështetësit perëndimorë të shtetit të ri të Kosovës. Ish-shefi i UNMIK-ut, Soren Jessen Petersen dhe eksperti i Institutit Amerikan të Paqes, Daniel Serwer, i kanë deklaruar "Zërit të Amerikës" se rruga për ta shmangur këtë skenar është presioni ndaj Serbisë.

(30 qershor) Rohan: Statusi i Kosovës është i pakthyeshem

Uashington - "Ndarja nuk mund të jetë temë e bisedimeve. Ky lloj dialogu nuk mund të përfshijë çështje të tilla. Ky opsion është kundërshtuar edhe nga Prishtina dhe nga bashkësia ndërkombëtare" - ka thënë ish-ndërmjetësuesi në bisedimet Prishtinë - Beograd, Albert Rohan, duke shtuar se statusi i Kosovës është i pakthyeshem. ■

Fotoreportazhi

Në ambientet e hotelit "Victory" në Prishtinë është organizuar një ceremoni pritjeje



Dy gëzimet e Gjeneralit

Në ambientet e hotelit "Victory" në Prishtinë është organizuar një ceremoni pritjeje për gjeneral Rrahim Ademin të sapoliruar nga Tribunali i Hagës ku doli fitimtar ndaj akuzës për krime luftarë gjatë kohës së luftës në Kroaci. Gjeneral Rrahim Ademi është pritur në Kosovë si fitimtar i dyfishtë nga shokët e luftës e të idealit, familjarë dhe

qytetarë të tjerë. Në këtë pritje të organizuar nga bashkëveprimtarët e tij si dhe nga pronari i hotelit Victory, Bedri Selmani, ishin të pranishëm edhe shumë fytyra publike, si Adem Demaçi, ish-kryeministri i Kosovës, Agim Çeku, ish-Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Paskal Milo, etj.



Nikoqiri Bedri Selmani, duke i falënderuar të pranishmit në këtë ceremoni pritjeje ka thënë se lirimi nga akuzat për krime luftarë në Tribunalin e Hagës të gjeneral Rrahim Ademit është një verifikim dhe dëshmi që shqiptarët kudo që kanë marrë pjesë nuk i kanë shkelur rregullat dhe etikën e luftës. "Gjeneral Rrahim Ademi është një shembull dhe gëzon një respekt të jashtëzakonshëm te qytetarët e Kroacisë sepse ai gjatë kohës së luftës në këtë vend ka dhënë kontribut të madh dhe ka arritur fitore të mëdha, e kjo na gëzon edhe neve sepse ai ka ndihmuar në luftën e armikut tonë të përbashkët" - ka theksuar Selmani.



Ish-shefi i diplomacisë së Shqipërisë, Paskal Milo, ka thënë se ndihet nderuar që merr pjesë në këtë pritje. Milo e ka vlerësuar gjeneral Ademin si një njeri që ka lënë gjurmë në historinë e kombit, duke i uruar atij që të vazhdojë të kontribuojë në ndërtimin e paqes.

për gjeneral Rrahim Ademin



Bashkëluftëtari i gjeneral Rrahim Ademit, ish-kryeministri i Kosovës, Agim Çeku, ka thënë se lirimi nga akuzat e Tribunalit të Hagës i gjeneral Rrahim Ademit nuk është fitore vetëm e tij por është fitore e drejtësisë së gjithë shqiptarëve. “Falënderoj mikun tim, bashkëluftëtarin tim, gjeneralin Rrahim Ademi. Jam shumë i lumtur që po e shoh në Kosovë dhe shumë më shumë i lumtur që po e shoh të lirë. E them këtë sepse gjeneralin e njoh mirë, i njoh vlerat e tij, sepse kemi qenë në një ushtri, në një komandë...” - ka thënë Çeku, duke shtuar se lirimi i gjeneralëve Rrahim Ademaj dhe Ramush Haradinaj dëshmon se këta janë shembuj që shqiptarët kudo që kanë luftuar, kanë luftuar si burrat, kanë luftuar armikun, ushtarin, agresorin e nuk janë marrë me pleq, gra e fëmijë”.



Rrahim Ademi, ka lindur në fshatin Karaç të Vushtrisë më 1954. Akademinë ushtarake e ka kryer në Beograd, e më pas ka shërbyer në qytetin e Shibenikut në Kroaci. Në vitin 1986 Gjykata Ushtarake në Sarajevë e akuzon për akte kundërrevolucionare dhe për irredentizëm shqiptar dhe e dënon me një vit e gjysmë burg. Në vitin 1990 dezerton nga Armata Jugosllave dhe u bashkëngjitet formacioneve ushtarake kroate.

I bashkëngjitet zyrtarisht Forcave të Armatosura Kroate më 1991. Ai gjatë luftës ka shërbyer në shumë vende, kurse në vitin 1999 është emëruar ndihmës shef i Inspektoratit të Forcave të Armatosura në Zagreb. Më 2001 akuzohet nga Tribunali Ndërkombëtar për krime për ish-Jugosllavinë... Më 30 maj 2008 ai lirohet nga të gjitha akuzat nga Tribunali i Hagës dhe i kthehet jetës normale.

Me duartrokitje është pritur fjalimi i simbolit të rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, i cili duke përmendur shembuj nga historia tha se shqiptarët kanë bërë dhe kanë dhënë njerëz për shumë vende. “Kam nderin e madh që të them se populli ynë, edhe pse i vogël, gjatë historisë u ka dhënë popujve shumëfish më të mëdhenj se ne shumë gjeneralë e udhëheqës. E dimë se kush ishte Kemajl Ataturku dhe çfarë ishte Kemajl Ataturku, e dimë kush ishte Mehmet Ali Kavalla dhe kush ishte Mehmet Ali Kavalla, e dimë që gati gjysma e deputetëve të Parlamentit të parë të Greqisë ishin shqiptarë, e shumë e shumë të tjerë, e rasti i gjeneralit Ademi është një fakt që ne i kemi dhënë edhe Kroacisë mike gjeneralë, e pritët që Kroacia të na shpërblejë këtë me të mira e miqësi të vazhdueshme. Këtu kemi dy gjeneralë që i ndihmuan Kroacisë për ta luftuar Serbinë Çetnike, e duke i ndihmuar Kroacisë i kanë ndihmuar Kosovës, sepse kanë luftuar armikun e përbashkët” - ka përfunduar Demaçi.

Gjeneral Rrahim Ademi duke i falënderuar pjesëmarrësit dhe organizatorët e kësaj pritjeje ka thënë se në vitin 2008 i janë plotësuar dy dëshira të mëdha. “Unë i kam pasur dy dëshira dhe të dyja më janë plotësuar, e para është që Kosova të fitojë pavarësinë e saj, e këtë dëshirë e kam pasur që nga viti 1981, kurse dëshira e dytë dhe fitorja më e madhe ka qenë atëherë kur të gjitha akuzat që ishin ngritur kundër meje, dolën se nuk janë të sakta dhe në fund dola i pastër dhe kjo fitore ka qenë fitorja ime më e madhe, kjo ka qenë beteja ime më e rëndë, por në fund drejtësia fitoi dhe unë u shpalla i pafajshëm. Edhe një dëshirë tjetër mu plotësua sepse erdha ta shoh Kosovën e lirë dhe të pavarur dhe uroj që Kosova të hyjë sa më shpejtë në familjen e madhe evropiane...” - ka theksuar gjeneral Ademi.



Përgatiti:
Osman D. GASHI

Histori Islame (19)

Mbi veprën e Muhammedit s.a.v.s.

Muhammedi s.a.v.s. ishte baba i mirë, pedagog shembullor, psikolog i shkëlqyer, mjek burimor, komandat ushtrie etj. Ky njeri kohët e fundit po studiohet nga psikologë të shumtë, sepse është vërejtur se praktika e tij ka lënë shumë gjurmë në këtë lëmi.



Muhamed JUSUFI
-KAJOLLI

Deri tani kemi argumentuar rreth historikut të këtij njeriu i cili qe pishtari i ndryshimeve të botëkuptimit njerëzor në mbarë rruzullin tonë. Ai duke praktikuar dhe interpretuar mesazhin (Kur'anin) u bë mësuesi i parë i shkollës hyjnore. Jemi dëshmitarë se, sipas disa kriterëve të vendosura nga shumë studiues, ky njeri doli disa herë njëshi i mbarë njerëzimit. Jo më kot numërohet njësh, sepse edhe sot pas shumë shekujsh, ai studiohet nëpër universitetet më të njohura të botës. Vetë përkushtimi rreth këtij personaliteti, lë të kuptohet se ka akoma për t'u thënë për të panjohurat rreth tij. Ai ishte baba i mirë, pedagog shembullor, psikolog i shkëlqyer, mjek burimor, komandat ushtrie etj. Ky njeri kohët e fundit po studiohet nga psikologë të shumtë, sepse është vërejtur se praktika e tij ka lënë shumë gjurmë në këtë lëmi.

Ardhja e tij ishte paralajmëruar disa herë

Atëistët nuk besojnë se vepra e tij kishte të bënte me Qiellin. Ata e kanë të vështirë ta kuptojnë ose as që mundohen ta dinë një lidhje të tillë. Ndërsa sa i përket teistëve, përkundër besimit që kanë, ata jo vetëm që besojnë se ai kishte lidhje të drejtpërdrejtë me Qiellin, por ata shkojnë edhe më tutje duke argumentuar se ardhja e këtij njeri ishte paralajmëruar disa herë shumë shekuj më herët. Shumë kohë më parë, para se Muhammedi s.a.v.s. të vinte në këtë jetë, ishin dhënë detaje rreth këtij personi. Dëshmitarë okularë të kohës së tij kanë treguar rrugëtimin e tyre deri sa kishin arritur në vendin ku supozohej se do të lindte ai, ose ku ai do të vepronte si i dërguar i All-llahut. Disa njohës të librave të më hershme të shenjta, sikur Tevratit ose Tora - Dhiata e vjetër dhe In-

xhili ose Dhiata e re, e dinin saktë kohën e ardhjes së peygamberit të premtuar. (... Jearifunehu...). Në librat e hebrenjve dhe të krishterëve disa studiues të paanshëm kanë interpretuar disa paralajmërime për ardhjen e Muhammedit s.a.v.s. Vërtet, ai që është i interesuar të dijë rreth kësaj fushe duhet të lexojë librin "Muhamedi në Bibël, të Keldanit" aty do të mësojë shumë gjëra të mahnitshme. Ky ish-ipeshkëv i Urmias është marrë me interpretimet e këtyre paralajmërimeve në librin e adhuruar prej tyre, dhe ai në këtë libër sjell tituj të tillë si: "Dhe Ahmed i të gjithë kombeve do të vijë, këtë e vërteton edhe Kur'ani..., pastaj, e fshehta e 'mispas'-s..., pastaj, Muhammedi është 'shiloh'-u...pastaj, tregimi i Kostandinit të Madh rreth përbindëshave dhe i 'Bar Nasha'-s...pastaj, mbreti David atë e quan 'Zoti im' e etj." Thuhet se një prej arsyeve të fuqishme të shpërnguljeve të çifutëve nga Palestina për në qytetin e sotëm të Medinës në Arabinë Saudite para shekullit të shtatë, ishte ardhja e peygamberit të premtuar. Si gjithmonë ata pretendonin se peygamberi i premtuar do të ishte prej tyre. Ata ishin shumë të informuar dhe e dinin saktë vendin, por, ata nuk e dinin se ai do të ishte një njeri prej fiseve të arabizuara.

Ishte përhapur lajmi se tani është koha e lindjes së peygamberit të premtuar dhe sipas të dhënave që ata posedonin ai duhej të quhej Muhammed. Kështu, ata të cilët ishin të informuar, të porsalindurit e tyre filluan t'i emërojnë me këtë emër. Ata e dinin saktë se ky njeri do të kishte me vete mesazhin universal, e jo si të tjerët, mesazhet e të cilëve ishin lokale. Ai duhej të ndryshonte botën, prandaj programi i tij do të ndryshonte nga programet e paraardhësve të tij.

Mohuesit e fesë janë të prirë të intrigojnë, ndërsa atyre ju japin ngjyrimet të ndryshme. Të bazuar në veprën e njeriut për të bërë mirë dhe keq, shumë prej tyre vazhdojnë akoma edhe në ditët tona të intrigojnë për këtë figurë të ndritur. E gjithë joshja dhe magjepsja që shkakton tek zbuluesit e mëdhenj e të vegjël njohja për Profetin e Islamit në zgjimin e tyre

nga "gënjeshtrat e shumta" që përmend Kerlajli, siç do të vihet re edhe në veprën e prof. Davudit, nuk mund të mos na kujtojë fjalët e Dr. Jozef Adam Pirsonit: "Ata që shqetësohen se mos një ditë armatimi bërthamor bie në duart e arabëve, nuk arrijnë ta kuptojnë se bomba islamike është lëshuar tashmë, ajo ra ditën që lindi Muhammedi." Që ai na qenka edhe më i rrezikshëm se edhe vetë bomba atomike, këtë tani filluam ta mësojmë e dëgjojmë. Ajo që është për t'u habitur është se, askush prej mohuesve të Islamit nuk e vështron atë nga këndi i afrimit midis civilizimeve, por gjithçka e shikojnë si ogur të zi.

Originali i Biblës nuk gjendet para nesh, por shumë prej fjalive që gjenden në të, argumentojnë ardhjen e Muhammedit s.a.v.s. Pasuesit e Islamit e njohin këtë vërtetësi nga një verset kur'anor 61/6. Nëse femohuesit duan të mësojnë saktë dhe drejtë, ata duhet ta lexojnë Librin e tyre duke qenë neutral dhe të paanshëm. Pasi ta kenë lexuar atë, le të merren pastaj edhe me Kur'anin. Në fakt, çfarë është Kur'ani?

Kur'ani

Kur'ani u tubua nën kujdesin e vetë Muhammedit s.a.v.s. derisa ai ishte gjallë dhe u përmbledh edhe njëherë menjëherë pas vdekjes së tij, brenda pak muajsh. Kjo përmbledhje u bë nën kujdesin e një komisioni të rreptë i cili edhe e lidhi në një kopertinë...

Kur flitet ose mendohet për Muhammedi s.a.v.s., secilit i shkon ndërmend Libri i Shenjtë. Kur'ani në sytë e mohuesve të tij shikohet si vepër e njeriut, pra, vepër e Muhammedit s.a.v.s. Atyre nuk ju shkon ndërmend që ta shohin atë si diçka jo njerëzore. Fatkeqësisht, ai shihet si të gjitha librat e tjerë të shkrimtarëve ose dijetarëve të kohës së hershme. Nëse ai shihet kështu sipas tyre, atëherë ju themi atyre se një numër tjetër shumë i madh njerëzish në botë nuk e sheh këtë Libër sipas këndvështrimit të tyre, por atë e konceptojnë atë si një Libër në të cilin Qielli kishte ndërhyrje të drejtpërdrejtë. Sidoqoftë, ai duhet respektuar jo për hir të pasuesve të tij, por për arsye se ai meriton të respektohet si

një Libër që ndryshoi njerëzimin, si libër që përmbysi tiraninë dhe barazoi gjininë mashkullore dhe atë femërore. Ai e ngriti femrën në vendin e merituar.

Pasuesit e këtij Libri, e njohin atë si mrekulli të gjallë hyjnore. Mrekullitë e tij janë të vazhdueshme. Kur'ani përmban në vete mrekulli kuptimore, shkencore dhe gjuhësore prandaj kur besimtarët e lexojnë këtë Libër, përveç përfitimit të tyre në adhurim, ata përfitojnë prej tij nga të dhënat e tij të sakta. Ai nuk shihet në asnjë mënyrë si libër shkencor e as historik, ai nuk shihet as si libër filozofik e as sociologjik, por ai është: "... fjalë e All-llahut, i zbritur tek i dërguari i Tij, adhurohet me leximin e tij, ai sfidon mbarë njerëzimin dhe xhinët si dhe çdo gjë që gjendet në botë... Kur'ani sfidon secilin që e ndjen veten të fortë dhe që posedon lirinë e zgjedhjes, përderisa ekzistojnë alternativat e mundshme, ai i sfidon të gjithë në të gjitha periudhat kohore."

Pra, Kur'ani sfidon secilin njeri që e konsideron veten se është dijetar, shkencëtar, gjeni, ose është novator i diçkaje prej së cilës mendon se është mbinjeri. Ai i sfidoi të gjithë shkencëtarët që nga kohërat e hershme deri tek shkencëtarët ekzistues të gjeneratës sonë, si dhe do të sfidojë të gjithë shkencëtarët e kohërave që do të pasojnë. Duke u orvatatur ta njollosin atë, shumë njerëz kanë rënë në ndikimin e tij sepse zbulonin të vërtetën. Zbulimet e reja shkencore vetëm sa e kanë vërtetuar saktësinë e vargjeve të tij. Arkeologët, astronomët dhe shumë shkencëtarë të shkencave të ndryshme mahniten me saktësinë e shenjave ose vargjeve të tij. Ata dhe shumë prijës të religjioneve të ndryshme, pas shumë studimeve, po mësojnë se Kur'ani nuk është libër i shkruar nga një autor që i përket racës njerëzore. Fatmirësisht, shumë prej tyre po binden dhe kështu po vërtetojnë thënien e Kur'anit i cili thotë se vetëm dijetarët i frikohen All-llahut. (7/ 120).

Duke qenë se Kur'ani nuk është vepër e njeriut, atëherë, ai padyshim do jetë i mbrojtur nga Qielli kundër intriguesve dhe qëllimkëqijve. Është vërtetuar historikisht se Kur'ani nuk ka pësuar ndryshime dhe ai as që do të ndryshojë ndonjëherë. Ai është Libër Hyjnor dhe një libër i tillë nuk mund të ndryshojë me ndryshimin e periudhave njerëzore. Ai është Libër Hyjnor dhe mosndryshimi vërteton saktësinë dhe precizitetin e vargjeve të cilat i përgjigjen secilës periudhë njerëzore.

Në momentet kur njeriu mendon se një varg nuk është më funksional ose nuk ka më vlerë, ai duke e sfiduar atë "mosvlerë" zbulon mrekullinë prej së cilës detyrohet të konvertohet me vetëdëshirë.

Hadithet Kudsije – Fjalët e shenjta

Pasi larguam dilemën e autorësisë së Kur'anit, atëherë na mbetet të shpjegojmë edhe një formë tjetër të shkrimit, të cilën pasuesit e Islamit nuk ia atribuojnë Muhammedit s.a.v.s. Muslimanët, përveç Librit të shenjtë Kur'anit, besojnë edhe në një shkrim autor i të cilit është gjithashtu Krijuesi, por në esencë këto thënie vijnë gjithmonë si rezultat i informacionit shpirtëror për robërit-besimtarë. Mund të thuhet se këto thënie nuk janë Kur'an e as nuk janë fjalë ose tradita të Muhammedit s.a.v.s.

Ndodh që robërit të mos i perceptojnë saktë dhe drejtë vargjet e All-llahut në Kur'anin Kerim prandaj i Lartëmadhëruari i ka afruar robërit e Tij më afër Vetes me anë të thënieve interpretuese, si hadithi Kudsij në të cilën All-llahu xh.sh. tregon se si e ndien Vetën kur besimtari e lexon suren el Fatiha etj. Këtë lloj interpretimi, All-llahu nuk ia la në kompetencë të dërguarit të Tij, Muhammedit s.a.v.s., që të tregojë se si ndiet Krijuesi ynë në këso rastesh.

Duke qenë se këto hadithe kudsije nuk janë të përmbledhura sikur Kur'ani dhe duke qenë se muslimanët nuk i kanë mësuar përmendësh siç e mëson Kur'anin, ndodh që midis tyre të mos ketë hadithe të sakta. Ndodh që dikush nga mosbesimtarët ose besimtarë të pakujdesshëm t'i kenë ndryshuar këto hadithe dhe tani gjeneratat tona të përballen me thënie të dyshimta ose gënjeshtër. Por kjo nuk ka mundur të ndodhë me Kur'anin.

Hadithet e Pejgamberit

Nga nëntitulli i sipërm mësuam se hadith do të thotë thënie, por në kuptimin etimologjik hadithi i Pejgamberit nënkupton secilën thënie, traditë ose veprim të Muhammedit s.a.v.s. Muslimanët qenë shumë të kujdesshëm në përmbledhjen e Kur'anit. Ata ishin gjithashtu shumë të vëmendshëm në përmbledhjen e haditheve. Duke qenë se frikësoheshin nga përzierja e haditheve të Muhammedit s.a.v.s. me vargjet e All-llahut të Lartëmadhëruar në Kur'an, ata e shtynë për një kohë më të gjatë përmbledhjen e tyre të shkruar në ko-

pertina. Hadithet barteshin gojarisht nga një person në një tjetër, por kishte edhe prej tyre që i kishin edhe të shkruara. Ishin dijetarët e shkollave juridike dhe filozofike ata që interesoheshin më së shumti për këto hadithe. Shumica e haditheve janë tubuar në libra vetëm dyqind vjet pas vdekjes së Muhammedit s.a.v.s., prandaj kjo ka bërë që shumë prej tyre të mos janë të sakta. Duke qenë se besimtarëve po ju vështirësohej harmonizimi i vargjeve të Kur'anit me atë që lexonin te hadithet, dijetarët themeluan shkencën e haditheve, prej së cilës mësojmë se në mesin e haditheve të përmbledhura kemi hadithe të ndryshme. Kur themi të ndryshme, kemi ndërmend hadithe që në esencë nuk janë fare thënie nga vetë Muhammedi s.a.v.s., prandaj këto hadithe kanë shkaktuar shumë probleme në mesin e muslimanëve. Ndryshe këto hadithe quhen israilijet-thënie të izraelitëve. Ashtu sikur kemi sot mendime të orientalistëve të cilët mundohet ta interpretojnë Kur'anin ose edhe ngjarjet historike. Për dallim nga orientalistët, israilijet ishte vështirë të njiheshin, sepse ato nuk tregojnë se nga kush ishin thënë këto thënie, sepse ato i adresoheshin Pejgamberit s.a.v.s., e kjo ishte edhe më e rrezikshme.

Kështu dijetarët e kësaj shkence i kanë ndarë hadithet në disa sosh: hadithe të vërteta ose autentike-Sahih, hadithe të transmetuar nga shumë transmetues-Mutevetir, hadithe të vërteta nga një transmetues-Ahad, hadithe të dobëta, esenca e të cilëve kanë dobësitë e tyre të ndryshme-Daif, hadithe që transmetohen drejtpërdrejtë-Mursel, hadithe të trashëguara nga i Dërguari-Merfu, hadithe të njohura mirë-Mesh-hur, hadithe që ju mungon ndonjë hallkë e transmetuesit-Munkati, pastaj kemi hadithe të sëmura, jo të vërteta, etj.

Të gjitha këto lloje hadithesh kanë bërë që dijetarët të janë shumë të kujdesshëm për secilën thënie të Muhammedit s.a.v.s, pasi hadithet e pavërteta i kanë shkaktuar dëme jo vetëm botës muslimane, por edhe mbarë njerëzimit.

Muslimanët mbështeten te fakti se ata kanë Kur'anin e pandryshuar, prandaj kanë shpresë ta rikthejnë saktësinë e thënieve autentike të Muhammedit s.a.v.s. Në një rast e kishin pyetur gruan e Muhammedit s.a.v.s., Aishen: - Kush është morali i Muhammedit? Ajo ishte përgjigjur: - Morali tij është Kur'ani. Që do të thotë: lexo Kur'anin dhe do të kesh një pasqyrë të saktë për Muhammedin s.a.v.s. ■

Vonesa mendore



Batjar HALILI

Vonesa mendore është një problem i zakonshëm dhe mjaft i njohur, i karakterizuar nga një funksionim nënmesatar i aftësive të përgjithshme mendore dhe intelektuale, si dhe deficite në aftësitë adaptuese jetësore. Vonesa mendore nis përpara moshës 18 vjeçare.

Simptomat tipike dhe karakteristikat shoqëruese

Vonesa mendore i referohet limiteve thelbësore në funksionimin aktual të personit. Ajo karakterizohet prej një funksionimi nën mesatare të inteligjencës së individit dhe prek prej dy ose më shumë prej fushave të mëposhtme: komunikimin, kujdesin vetjak, jetesën shtëpiake, aftësitë sociale, vetëdrejtimin, frekuentimin e komunitetit, shëndetin dhe sigurinë, edukimin funksional, kohën e lirë dhe punën. Vonesa mendore manifestohet para moshës 18 vjeç.

Ky përkufizim përmban 3 pjesë kryesore: - Funksionim nën mesatare të inteligjencës çka lidhet me një KI (koeficient inteligjence) më poshtë 75-70 sipas testit të inteligjencës. - Limitet në dy ose më shumë fusha të aftësive adaptuese të cilat i referohen KI të ulët. - Shfaqet para moshës 18 vjeçare duke përfshirë kështu njerëzit që mund të shfaqin deficite mendore si pasojë e ndonjë aksidenti gjatë jetës.

Një KI nën mesatare

Koeficienti i inteligjencës (KI) matet kryesisht me një test WISC-R për fëmijë ose adultë që mat aftësitë intelektuale të individit, por në këtë rast duhet pasur kujdes në standardizimin e këtij testi me kulturën dhe popullatën në të cilën realizohet.

Testet e inteligjencës përdoren gjerësisht sidomos për të vlerësuar performancën e dikujt në shkollë. KI është një

karakteristikë që është e stabilizuar në kohë. Matjet e fëmijëve parashkollorë priren të jenë jo të stabilizuar në kohë në krahasim me ato të fëmijëve shkollorë dhe më të rriturit. Një fëmijë shkollor që ka një KI nën mesatare do të vazhdojë ta ketë të tillë edhe më vonë në jetë.

Një çështje që lidhet me testet e inteligjencës është edhe pyetja nëse ato janë kulturalisht të drejtë.

Një tjetër çështje është edhe fakti se çfarë quajmë inteligjencë, vetëm aftësinë shkollorë, apo edhe aftësi të tjera?

Limitet dhe aftësitë adaptuese

Këto aftësi adaptuese, që përbëjnë edhe një pjesë të mirë të inteligjencës, përfshijnë si inteligjencën praktike ashtu edhe atë sociale. Inteligjenca praktike i referohet aftësisë për të menaxhuar aktivitetet e zakonshme të jetës së përditshme, kurse ajo sociale tregon aftësinë për të kuptuar si të sillemi në situatat sociale.

Kemi 10 aftësi që duhen marrë parasysh në përcaktimin e vonesës mendore: komunikimi, kujdesi vetjak, jetesa shtëpiake, aftësitë sociale, vetëdrejtimi, frekuentimi i komunitetit, shëndeti dhe siguria, edukimi funksional, koha e lirë dhe puna.

Këto aftësi mund të gjykohen lidhur me moshën. Të parashkollorët aftësitë adaptuese përfshijnë përfitimin e aftësive motorike, gjuhën dhe vetëkontrollin.

Aftësitë kyçe në moshën shkollorë përfshijnë performancën akademike dhe marrëdhëniet sociale me moshatarët. Në moshën e rritur këto aftësi janë të tilla si aftësia për të menaxhuar veten, për të jetuar në mënyrë të pavarur dhe për të marrë rolet dhe detyrat ndërpersonale.

Fillimi në periudhën zhvillimore

Nga kriteret që përmendëm më lart, thamë që fillimi ishte para moshës 18 vjeçare. Kjo gjë përfshijte njerëzit deficitet intelektuale të të cilëve kanë filluar më vonë në jetë si rezultat i një dëmtimi ose sëmundjeje. Individët me vonesë mendore nuk i kanë humbur aftësitë e tyre që kanë zotëruar dikur dhe as kanë përjetuar ndonjë ndryshim në kushtet e tyre jetësore. Fatkeqësisht, vonesa e tyre

kuptohet si një gjë që ata e kanë dhe jo si diçka që ju ka ndodhur.

Klasifikimi bashkëkohor

Vonesa mendore klasifikohet duke u bazuar në dy kritere të ndryshme. Njëri prej tyre është rezultati i KI dhe tjetri bazohet në etiologjinë e njohur. Të dyja janë të vlefshme në qëllime të ndryshme. Megjithatë është pranuar një klasifikim i tillë për vonesën mendore.

Vonesë e butë mendore – i referohet një KI midis 50-50 deri 70. Këtu hyn rreth 85% e individëve të vonuar mendorë. Këta kanë pak dëmtime fizike dhe kanë një funksionim intelektual të një individit në klasën e 6-të dhe jetojnë në komunitet pa ndihmë.

Vonesë e moderuar mendore – i referohet një KI prej 35-40 deri 50-55. Këtu hyjnë rreth 10% e individëve të vonuar mendërisht. Ata mund të kenë dëmtime fizike të dukshme të tilla si karakteristika të sindromit Down. Kanë një zhvillim akademik të klasës së dytë, kanë nevojë për supervizionim dhe jetojnë më shumë vështirësi në komunitet.

Vonesa e ashpër mendore – qëndron me një KI 20-25 deri 35-40. Këtu hyjnë rreth 3-4% e individëve të kësaj kategorie. Zhvillimi motorik i tyre është i dëmtuar dukshëm, komunikimi është shumë i vështirë dhe kanë nevojë për supervizionim të vazhdueshëm.

Vonesë e thellë mendore – me një KI nën 20-25 ku përfshin rreth 1-2% të individëve. Aftësitë motorike, komunikimi dhe kujdesi për veten janë tërësisht të dëmtuara dhe jetojnë në komunitet dhe institucione të specializuara.



Etiologjia e vonesës mendore

Faktorët biologjikë, çrregullimet kromosomike, çrregullimet gjenetike, sëmundjet infektive, toksinat, anomalitete të tjera biologjike, faktorët psikologjikë, faktorët socialë.

Trajtimi

Parandalimi primar – Përdorimi i kujdesit amënor dhe shëndeti i fëmijëve është hapi i parë drejt parandalimit primar të shumë shkaqeve biologjike të vonesës mendore. Të tilla janë vaksinimi prej rubeolës dhe detektimi dhe trajtimi i sëmundjeve infektive. Dieta e duhur gjatë shtatzënisë. Komplikimet e lindjes hasen të nënat nën 18 dhe mbi 35 vjeçare.

Një tjetër mënyrë parandalimi është edhe detektimi i vonesës gjatë fillimit të shtatzënisë përmes amniocentezës, që i rekomandohet kryesisht grave të moshuara.

Parandalimi sekondar – Ndërhryjet sociale dhe edukuese mund të udhëheqin drejt parandalimit sekondar të vonesës mendore. Është parë se fëmijët dhe prindërit e tyre që marrin pjesë në workshope edukacionale dhe krijuese mund të rritin ndjeshëm KI e tyre. Projekte të mëdha mund t'u shërbejnë fëmijëve të nënave me KI nën mesatare duke rritur ndjeshëm inteligjencën dhe aftësitë e tyre.

Prarandalimi tercial – Një lloj i këtij parandalimi do të ishte detektimi i PKU në moshë të fëmijërisë së hershme, nëse detektimi më i hershëm ka qenë i pamundur. Ndërhryja konsiston në detyrat që i jepen fëmijëve të vonuar mendërisht, prindërve të tyre që t'ua bëjnë detyrat në shtëpi, duke promovuar një marrëdhënie të mirë prindërore në këto familje.

Trajtimi i nevojave sociale dhe emocionale të personave të vonuar mendërisht janë shumë të rëndësishme. Atyre iu mësohen aftësitë e vetëkujdesjes, të tilla si të ushqyerit, tualeti, veshja dhe, më vonë, aftësi të tjera në jetë.

Medikament dhe neuroleptikë të ndryshëm mund të jenë ndihmesë e madhe për shumë persona të vonuar mendërisht.

Normalizimi – Ky term i referohet faktit që të vonuarit mendërisht të mund të jetojnë sa më shumë të jetë e mundur si anëtarët e tjerë të shoqërisë. Vendosja e fëmijëve të vonuar në shkollat publike normale ka qenë një nga qëllimet e normalizimit.

Fëmijët me vonesë të butë dhe të moderuar synohen të futen në shkollat publike normale dhe jo në klasat speciale siç bënin më përpara. Por ka shumë probleme lidhur me këtë pikë.

Deinstitucionalizimi nisi në 1960 dhe në vitet 1970-81 numri i të vonuarve të institucionalizuar, sidomos me vonesë mendore të butë, ra ndjeshëm. Jetesa në komunitet ka përmirësuar shumë prej aftësive sociale dhe vetëkujdesëse të tyre. Përveç frikës dhe paragjyqimeve, mund të themi se të vonuarit mendorë mund të kontribuojnë ndjeshëm me punën e tyre në komunitet. ■



Optimizmi për

'pavdekësinë e njeriut'

Ndërhryja e pakujdesshme dhe e pakontrolluar e njeriut në tokë bart pa dyshim rrezikun e prishjes së ekuilibrit biologjik të jetës në tokë, prandaj nuk duhet synuar pas "fitimit" imediat, por duhen peshuar humbjet perspektive.

Ajni & Mimoza Sinani

Dualizmi jetë-vdekje është fenomeni më thelbësor i pashpjegueshëm nga njeriu dhe qëndron mbi të gjitha çështjet e tjera enigmatike. Nëse njerëzit do ta dinin se çka në të vërtetë përtej vdekjes, bota do të ndryshonte rrënjësisht. Mirëpo, vdekja nuk është tragjedia finale e jetës. Kjo tragjedi ndodh atëherë kur njeriu përjeton së gjalli vdekjen e tij shpirtërore. Jeta e njeriut nuk kufizohet në këto pak vite të ekzistencës së tij në këtë botë. Atij i është shpallur qartë se ai është një qenie e përjetshme, që nuk asgjësohet me vdekjen e tij. Ai është një qenie që jeton dy jetë, jetën e sosur të kësaj bote dhe jetën e amshueshme të botës tjetër. Me vdekjen e tij nuk merr fund çdo gjë. Njeriu është qenie materiale, por ai ka gjithashtu shpirt hyjnor. Ai ndihet i lidhur me një lidhje të përhershme me përjetësinë, madhëstsinë e përsosmërinë. Ai e ndien se është një qenie që nuk mund të asgjësohet kurrë nga vdekja pas së cilës zë fill një tjetër epokë e re jetësore. Në Kur'an thuhet: **"E kur ta përsos atë (njeriun) dhe t'i jap atij shpirtin që është krijesë e Imja.."** (Kur'ani, 15:29).

Kur njeriu të kuptojë të vërtetën dhe natyrën e tij të vërtetë, ai s'do të ketë frikë nga vdekja. Kështu, ai do të zbulojë kënaqësinë e plotë të lumturisë së pamasë qysh në ekzistencën e tij tokësore.

Njeriu, autor i arritjeve të suksesshme por edhe i tragjeditë të tij, ka ndërmarrë guximshëm realizimin e pavdekësisë së qenies njerëzore përmes klonimit. Prej thellësisë së mijëra e mijëra shekujve shohim ndjenjat e fosilizuara të dëshirës për përjetësi. Njeriu, nën një agresivitet, krijon kultura të pavdekshme dhe bën historinë me qëllim që t'i ikë vdekjes. Ndërtimi i gjithë këtyre monumenteve jetëgjatë nga njerëzit, si piramida, statuja, gradaçela etj., tregon se të pasurit dhe liderët donin të glorifikonin dhe mishëronin përjetësinë, pra t'i iknin vdekjes. Dëshirën për përjetësi, qysh në lashtësi, e dëshmojnë më së miri piramidat, që thuhej se i përkisnin shekullit të 4-të para erës së re, por zbulimet e fundit kanë supozuar se ato janë ndërtuar diku para 13 mijë vjetësh.

Gjithashtu, edhe "Epi i Gilgameshit", vepra më e vjetër e shkruar rreth para 4000 vjetëve dhe e zbuluar në qytetin Ninive, në bibliotekën e Asurbanipalit, përshkohet nga ideja e përpjekjeve për t'i shpëtuar vdekjes dhe për të gjetur jetën e amshuar.

Edhe tek "Mahabarata", eposi i sjellë nga fiset ariane në Indinë e Lashtë, përmendet lëngu i një peme që e zgjaste jetën deri në dhjetë mijë vjet. Gjithashtu, edhe në mitologjinë

greke flitet për një ushqim shumë herë më të ëmbël se mjalti që quhej "ambrozi" dhe që falte rini të përjetshme.

Ndjenja e dashurisë dhe admirimit të tepruar për vetveten, që në kohën tonë përkon me dëshirën për klonin e vet, takohet edhe tek miti i Narcisit, biri i hyjit të ujit Kefes dhe i nimfës Liriopa, i cili pasi pa fytyrën e vet të pasqyruar në ujin e një burimi, ra në ekstazë dhe i dëshpëruar ngaqë s'mund ta kapte këtë vetvete tjetër lëngoi në shtrat dhe vdiq.

Tek novela e titulluar "Frankeshtain" e Mary Shelly-t, botuar më 1818, shohim guximin e 'vjedhjes' së misterit të krijimit të njeriut për ta bërë atë të pavdekshëm. Mjeku Frankeshtain, pas disa eksperimentesh të 'solistikuara', arriti të krijojë të parën qenie të gjallë, një monstër që u ngjallte frikë të gjitha qenieve normale njerëzore, që nuk e dinte se kush ishte, një qenie që s'kishte as prindër, as të afërm. Por, Frankeshtaini, një model modern i mitit të lashtë të Prometeut (mit, që simbolizon rebelimin e njeriut ndaj perëndive), u ndëshkua për guximin e tij prometian prej vetë monstrës që ai krijoi, duke e paguar shumë shtrënjtë çmimin e kurajës së tij. Thelbi i mitit të Frankeshtajnit, këtij Prometeu modern, përdoret sot për të treguar se çfarë rreziqesh mund të mbartë me vete një zbulim shkencor i pakontrolluar dhe se si shkencëtarët mund të bëhen peng të papërgjegjësive të tyre.

Të gjithë të dërguarit e Zotit, predikimet dhe metodat e tyre edukuese, i kanë filluar me 'JO' ose 'Mos'. Kjo 'JO' apo 'MOS', i porosit njerëzit që të kenë kujdes në bërjen e veprimeve të tyre, sepse njeriu përjeton pakrahasueshmërisht më shumë fatkeqësi nga bërja e disa veprimeve prej tij, se sa nga mosbërja e tyre. Më shumë lot njerëzimi ka derdhur nga pasojat e asaj që ka bërë, se sa të asaj që s'ka bërë. Të gjitha fetë e Zotit, gjatë gjithë historisë, që nga i dërguari i parë i Zotit, Ademi a.s., e deri te i dërguari i fundit, Muhammedi a.s., janë bazuar në ndalesat që i kanë bërë njeriut. Në dhjetë porositë kur'anore, shumica e tyre janë ndalesa. Këto ndalesa, nuk janë bërë me qëllim që ta denigrojnë qenien njerëzore, por përkundrazi që ta lartësojnë dinjitetin e tij dhe ta çojnë atë drejt përsosjes morale.

Në vitet '70 e këtej, filluan shenjat e para të kritikës ndaj kërkimeve shken-

core. Disa studime në fushën e biologjisë dhe mjekësisë u klasifikuan si skandale të vërteta, pasi realizuesit e tyre i kishin shkelur të gjitha rregullat etike, duke dhënë shenjat e para se si kërkimi shkencor mund të dalë jashtë kontrollit. Zbulimet fundamentale të biologjisë u shoqëruan me një reagim dhe tronditje të shoqërisë njerëzore sidomos në planin etiko-moral.

Kërkuesit me anë të inxhinierisë gjenetike kanë futur gjene të reja, duke krijuar bimë dhe kafshë transgjenike, me pretendimin se kanë pjellori më të lartë dhe janë më rezistente ndaj infeksioneve virusale. Por, përkundër euforisë së bioinxhinierëve që japin siguri se po përmirësojnë disa parametra, shumë të tjerë mendojnë se ndërhyrja në aparatit gjenetik të bimëve dhe të kafshëve mund ketë efekte të ndryshme, të cilat do të dëmtojnë ekzistencën e vetë llojit: "Allahu i Madh ju ka dhënë nga të gjitha gjërat që ju duhen." (Kur'ani, 14:34). "O ju njerëz, hani nga ajo që është në tokë e që është e lejuar dhe e mirë, e mos shkoni hapave të djallit se ai është armik i hapët i juaji." (Kur'ani, 2:168). "Kemi bërë që në të (tokë), të mbijnë bimë të caktuara të të gjitha llojeve..." (Kur'ani, 15:19). "I Cili krijoi dhe përsosi. Dhe i Cili përcaktoi e orientoi" (Kur'ani, 87:2-3).

Teknika e bartjes së gjeneve bart me vete rreziqe katastrofike për njerëzimin

Kërkuesit e fushës së biologjisë, këta guximtarë të tipit të Frankeshtajnit, synojnë të prekin dhe të ndryshojnë thelbin e jetës, ADN - në, që është bartësi i informacionit gjenetik dhe që quhet 'libri i jetës', pasi përmban të gjithë informacionin që ka të bëjë me formën dhe funksionin e organizmave të gjallë. Teknika e bartjes së gjeneve bart me vete edhe riskun e rreziqeve katastrofike për njerëzimin. "Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj..." (Kur'ani, 7:56).

Mjafton një baktere apo virus me fuqi vdekjeprurës që mund të kishte pasojë katastrofike për njerëzimin. Bomba të tilla biologjike do të ishin më të tmerrshme se ato atomike. Entuziazmi për zbulimin e energjisë atomike nuk zgjati shumë. Pas Hiroshimës u kuptua se çdo të thotë të keqpërdorësh shkencën.

Ndërhyrja e pakujdesshme dhe e pakontrolluar e njeriut në tokë bart pa dyshim rrezikun e prishjes së ekuilibrit biologjik të jetës në tokë, prandaj nuk duhet synuar pas "fitimit" imediat, por duhen peshuar humbjet perspektive. "E kur atyre u thuhet: 'Mos prishni rendin në tokë!' Ata thonë: 'Ne jemi vetëm përmirësues'. Vini re, ata në të vërtetë janë shkatërruesit, por nuk e kuptojnë." (Kur'ani, 2:11-12).

Pretendohet se bioteknologjia e klonimit të njeriut do t'i kontribuojë ruajtjes dhe përjetësisht të elitës intelektuale njerëzore, gjë që do ta çonte shoqërinë më shpejt përpara. Ithtarët e eugenikës e shikojnë teknikën klonuese dhe inxhinierinë gjenetike si tepër favorizuese për përmirësimin e qenies njerëzore, për lindjen dhe shtimin e "mbinjerëzve". Problemi i klonimit human, përveç pengesave teknologjike eksperimentale, po përballlet fuqishëm me një sërë problemesh etike që lidhen me traditën e civilizimit të sotëm.

Njeriu është qenie biologjike dhe shoqërore dhe ai është njëkohësisht objekt dhe subjekt i marrëdhënive shoqërore ekonomike, politike, ideologjike, filozofike, etike, juridike, të cilat janë në lidhje dhe bashkëveprim të ndërsjellë.



Klonimi njerëzor, që s'është një guxim i çnësues, është një guxim i çnësues të natyrshme të ciklit jetësor të vetë shoqërisë njerëzore.

Njeriu ka një thelb të lindur. Ai ka natyrë që është, në të njëjtën kohë, tokësore dhe qiellore. Ai ka tendenca dhe instinkte të ndryshme si dhe aftësi dhe dëshira të ndryshme. Por ai duhet të zhvillojë thelbin e tij individual nëpërmjet përpjekjeve dhe vullnetit të tij personal. Talentet dhe prirjet e tij ofrojnë një terren mbi të cilin atij i duhet të ndërtojë thelbin e vet dhe të vendosë se kush duhet të jetë.

Qenia njerëzore nuk është thjesht qenie biologjike, por produkt i rrethanave sociale në të cilat jeton, të cilat nuk programohen gjenetikisht.

Në Kur'an thuhet qartë se: **"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre..."** (Kur'ani, 49:13); **"Dhe Ai është që krijoi llojet - mashkullin dhe femrën. Nga pika e farës që hidhet."** (Kur'ani, 53:45-46). **"A nuk ka qenë ai një pikë uji që derdhet?"** (Kur'ani, 75:37). **"Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkëdyzuar..."** (Kur'ani, 76:2). Nga të gjitha këto ajete del qartë se krijesa e quajtur 'njeri' është pasojë e një riprodhimi seksual dhe edhe sikur të arrijë ndonjëherë shkencat të realizojë teknikën

e

klonimit të njeriut, ajo shartesë me siguri do të ishte një 'monstër'.

Klonimi njerëzor, që është veçse një delir i tipit narcistik, është një guxim i çmendur për të dalë jashtë ligjeve të natyrshme të ciklit jetësor dhe rrezikon ekzistencën e vetë shoqërisë njerëzore, pasi bën që të humbasë përfundimisht koncepti i prejardhjes familjare, meqë në nivelin antropologjik, nuk mund të dish më nëse kloni është vëllai, motra, biri apo bija e origjinalit. Raportet shekullore të fafesisnisë dhe familjes asgjësohen dhe bashkë me të edhe identiteti personal.

Familja është një institucion hyjnor, origjina e të cilës përkon me krijimin e njeriut dhe lloji njerëzor është rezultat i këtij institucioni. Megjithatë ruajtja e llojit është një nga qëllimet kryesore, familja nuk është një 'fabrikë' për prodhimin e njerëzve, por është bazë e gjithë strukturës social-kulturale dhe një mekanizëm i mjaftueshëm për të siguruar stabilitetin social, ideologjik e kulturor të shoqërisë.

"Dhe nga argumentet e Tij është se për të mirën tuaj, Ai (All-llahu) krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe ndërmjet jush krijoi dashuri dhe mëshirë." (Kur'ani, 30:21); **"Gratë janë vendmbjellje e juaj."** (Kur'ani, 2:223)

Optimizmi për të nesërmen e pavdekësisë së njeriut dyzohet nga frika për humbjen përfundimtare të identitetit njerëzor dhe të konceptit të familjes. Një specialist shprehet: "kloni konsiderohet si një koloni alienësh pa identitet. Çfarë mund të jetë një njeri pa ekzistencën e unit? Tek një klon, uni është i thërrmuar". All-llahu i madhërishtëm duke na rrëfyer për djallin thotë: **"... do t'i urdhërojë (djalli) dhe ata do të shëmtojnë krijesat e All-llahut. E kush e bën mik djallin, e jo All-llahun, ai ka dështuar sheshazi."** (Kur'ani, 4:119)

Të riprodhosh teknologjikisht një qenie njerëzore do të thotë të dhunosh dinjitetin njerëzor

Një numër gjithnjë e më i madh njerëzish pyesin të shqetësuar se drejt çfarë caku synon të arrijë guximi i tmerrshëm i biologëve për të prekur e për të ndryshuar thelbin e jetës, aparatit gjenetik të së gjallës. Bioteknologjia e klonimit artificial të së gjallës, sidomos

klonimi i njeriut, ka ngjallur një debat të zjarrtë jo vetëm në rrethet shkencore, por edhe ato politike, filozofike, etike e sidomos fetare. Kundërshtarët e klonimit e shohin lindjen e deles Dolly si një qenie apokaliptike, si një ndërhyrje që prish rregullin e vendosur në natyrë. Teknikat e klonimit, në aspektin fetar, konsiderohen si teknika perverse, pasi të riprodhosh teknologjikisht një qenie njerëzore do të thotë të dhunosh dinjitetin njerëzor. Njeriu ka të drejtën e lindjes në mënyrë njerëzore dhe jo laboratorike dhe jeta duhet respektuar qysh në momentin e ngjizjes së embrionit. Islami e shenjtëron jetën njerëzore dhe e trajton tërë gjininë njerëzore si një familje dhe armiqësia kundër një anëtarit të saj, konsiderohet armiqësi kundër tërë gjinisë njerëzore: **"Kush mbytur një njeri, pa pas mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pas bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë është si t'i kishte mbytur të gjithë njerëzit."** (Kur'ani, 5:32). Përkrijimi i njerëzimit mbështetet në riprodhimin seksual, në themel të së cilit qëndron dashuria njerëzore, një ndjenjë tepër e fuqishme dhe e patjetërsueshme për njeriun: **"Ai nga lloji juaj krijoi për ju bashkëshorte edhe nga kafshët krijoi çifte, ashtu që t'ju shumojë."** (Kur'ani, 42:11); **"Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkëdyzuar"** (Kur'ani, 76:2); **"... ato (gratë) janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për to..."** (Kur'ani, 2:187).

Në një anketë të bërë për të testuar sensibilitetin e publikut në lidhje me pikëpamjen fetare për klonimin kish rezultuar se klonet janë në kundërshtim me vullnetin e Zotit. Duam të kujtojmë se çdo ndërmarrje dhe arritje njerëzore, qoftë ajo dhe e ndaluar nga aspekti islam, kryhet brenda kuadrantit të vullnetit të Zotit, por, njeriu, me papërgjegjësinë e vet dhe mosrespektimin e rregullave të caktuara nga Zoti, tërheq mbi vete moskënaqësinë dhe hidhërimin e Tij, pasojat e së cilës do t'i ndiejë në këtë botë dhe do të ndëshkohet në Ditën e Gjykimit. Vullneti i lirë i njeriut është bekuar me mbrojtjen dhe favorin hyjnor në qoftë se përpiqet dhe lëviz në drejtimin e duhur. Po të dëshirojë, Zoti mund t'i bëjë të pasuksesshme të gjitha përpjekjet e njeriut. Njeriu nuk mund të zotërojë pushtet absolut as brenda asaj kornize që Zoti ka caktuar për të. Në mjaft raste, Ai ka bërë të dësh-

është veçse një delir i tipit narcistik, çmendur për të dalë jashtë ligjeve të natyrshme të ciklit jetësor dhe rrezikon ekzistencën e vetë shoqërisë njerëzore.

tojnë përpjekjet e individëve e të grupeve të caktuara, përkundër çdo lloj parashikimi, duke u kujtuar atyre në këtë mënyrë se mospërfillja e pëlqimit dhe dispozitave të të Gjithëpushtetshmit është e pafalshme. Në Kur'an thuhet: **"Një shumicë, duke mos pasur kurrfarë dije, por vetëm nga pasionet e tyre, duan t'i largojnë (njerëzit) nga e vërteta. Po Zoti yt di më së miri për ata që i shkelin dispozitat."** (Kur'an, 6:119). **"A është i njëjtë ai që iu bind All-llahut dhe kërkoi kënaqësinë e Tij, si ai që tërhoqi kundër vetes hidhërim të madh nga All-llahu dhe e ardhmja e tij është xhehenemi, që është përfundim shumë i keq"** (Kur'ani, 3:162).

Tentimi për të ngushtuar kufirin midis prodhimit seksual dhe atij joseksual ka bërë që të vendosen një sërë kufizimesh legislative që nuk lejojnë manipulimin me embrionin e njeriut dhe aq më pak klonimin e tij.

Shumë studiues të ndërgjegjshëm, reflektojnë në mënyrë kritike për t'u vënë fre studimeve të pakontrolluara dhe ndërmoren një fushatë sensibilizuese për publikun, duke i dhënë mundësi që të debatojnë dhe të jetë faktor aktiv në gjykimet për punën e shkencëtarëve. Problemi i klonimit bëri që të përfshihen në një debat të gjerë jo vetëm qarqet shkencore morale, etike, filozofike, fetare etj, por edhe qarqet politike dhe në mjaft vende filluan projekt ligje për ndalimin e klonimit human, duke i konsideruar të paligjshme dhe duke kërkuar që qendrat kërkimore në këtë fushë të jenë nën kontrollin e shtetit. Janë hartuar një sërë deklaratash, ligjesh dhe konventash që kërkojnë të ndërpriten ndërhyrjet arbitrare në thelbin e jetës, të shenjtërohet pacenueshmëria e trashëgimisë gjenetike dhe të merrret në mbrojtje dinjiteti njerëzor. Ky debat i ka kapërcyer kufijtë e auditorëve të specialistëve dhe është bërë pjesë e një debati publik që sa vjen e shtohet. Megjithatë, përkundër pengesave ligjore, në shumë laboratorë punohet çdo ditë, gjë që dëshmon se kërkimet vazhdojnë.

Klonimi është përpjekje e teknologjisë që njeriu t'i rrëmbejë Zotit sekretin e krijimit, në mënyrë që njeriu të arrijë amshueshmërinë pa e shijuar vdekjen. Ndërkaq, feja na mëson se ka amshueshmëri, por deri tek ajo mund të arrihet vetëm duke e shijuar vdekjen.

Kërkuesit e fushës së biologjisë, pretendojnë t'i atribuojnë vetes cilësitë e Zotit, sipas të cilëve, njeriu i krijuar sipas imazhit të Zotit tani e ka radhën të krijojë sipas imazhit të tij. Por, në të vërtetë, këta shkencëtarë nuk bëjnë gjë tjetër veçse operojnë dhe manipulojnë në mënyrë perverse, me material të gatshëm gjenetik, të krijuar nga Zoti i plotfuqishëm. Në Kur'an thuhet:

"A mos u krijuan prej kurrgjësë, apo ata vetë janë krijues?" (Kur'ani, 52:35). Nëse nise mi nga prizmi kur'anor, njeriu është mëkëmbësi i Zotit në sipërfaqe të tokës. Relacioni i hierarkisë ontologjike ndërmjet Zotit dhe njeriut nuk rrjedh nga largësia në një rrafsh të njëjtë, por nga dallueshmëria e rrafsheve të ekzistencës absolute. Zoti i Lartësuar, me atributet hyjnore, i përfshin të gjitha rrafshet ekzistenciale dhe në njërën nga ato rrafshet të ekzistencës njeriut i është më i afërt se aorta.

All-llahu krijon, All-llahu nuk kopjon. All-llahu është Një dhe çdo herë që krijon, Ai krijon në mënyra të ndryshme. Zoti asnjëherë nuk përsërit. Përmes përpjekjeve për klonimin e qenies njerëzore, njeriu tenton të ç'shenjtëroj papërsëritshmërinë me të cilën Krijuesi ka vulosur fytyrën e secilit prej nesh, buzëqeshjen dhe ngazëllimin që e dallon dhe e thekson veçantinë e secilit njeri. **"I Tij është pushteti në qiej e në tokë. Ai jep jetë dhe Ai jep vdekje dhe Ai ka fuqi për çdo send"** (Kur'ani, 57:2). ■

Të mos

Ne shqiptarëve që kemi fatin të flasim dhe të shkruajmë me karakteristika të një gjuhe të lashtë e kreative, nuk na



Besim R. CENGU

Administratës të mbretit Zog, prej lëvruarëve të gjuhës shqipe të asaj periudhe, i qe marrë për të madhe, madje si injorancë apo edhe mungesë e theksuar e kulturës gjuhësore, fakti se në një telegram të kohës, që një prej ministrave (në mos gabohem në vitin 1936) u drejtonte prefekturave, me një tekst prej gjashtë rreshtave, u identifikuan 27 gabime ortografike në bazë të rregullave e normave gjuhësore që kishte vendosur Komisia Letrare aty nga fundi i dekadës së dytë të shekullit të njëzetë. Për respekt të së vërtetës, prej inteligjencës të asaj kohe, i kushtohet shumë rëndësi konsolidimit të gjuhës, kulturës në të shkruar dhe në format e shprehjes, si një prej cilësive identifikuese të një populli që po ndërtonte sefte shtetin e vet, por njëkohësisht edhe po konsolidonte gjuhën si mjet të komunikimit të përditshëm, si lëndë ndërtimi të veprave shkencore e kulturore.

Pas rilindësve, që dhanë aq shumë për krijimin e vetëdijes kombëtare, formësimin e shtetit shqiptar, por edhe për konstituimin e gjuhës shqipe si mjet komu-



e "bdarim" gjuhën shqipe

më gjuhën shqipe e cila është plot mundësi shprehëse dhe e pasur në fondin e fjalëve e shprehjeve figurative, falet në asnjë rast të abuzojmë me këtë pasuri tepër të çmuar.

nikimi, shtypi i kohës të kësaj Lëvizje të ndritshme kombëtare luajti një rol të pazëvendësueshëm dhe pas shpalljes së pavarësisë, përmes kontributit patriotik e atdhetar të intelektualëve të përgjegjshëm për rëndësinë fundamentale që ka gjuha e standardi i saj. Këta njohës skrupulozë, lëvrues pasionantë, e njohës thellë të fondamentit e magjisë të gjuhës tonë të bukur, ishin shkolluar kryesisht në perëndim, e prej andej sollën konceptin e përparuar, se të respektosh gjuhën tënde do të thotë të kesh respekt për popullin të cilit i përket, konsideratë për historinë e tij, përujle për njerëzit që kanë bërë historinë, për prijësit që e kanë udhëhequr etj.

Gazetat e para, si "Fjamuri i Arbërit", "Albania", "Drita", bie fjala, apo më vonë, mjeshtër të mendimit, gjykimin e interpretimit, përmes gjuhës së shkruar shqipe, por edhe të përdorimit mjeshtëror të saj, luajtën një rol të jashtëzakonshëm në konsolidimin, por edhe në evoluimin e gjuhës shqipe në të gjitha drejtimet, në planin strukturor, fonetik, morfologjik e

sintaksor. Në gjysmën e parë të shekullit të njëzetë, intelektualë si Noli, Konica, Fishta, Asdreni, Mosi, Merxhani, Xhuvani, Nonda Bulka, Ismet Toto, Vangjel Koça etj, i dhanë një impuls të madh zhvillimit të gjuhës, duke e ngritur shqipen në një nivel të denjë.

Ndal masakrimit të gjuhës prej administratës drejtuese

Ne shqiptarëve që kemi fatin të flasim dhe të shkruajmë gjuhën shqipe e cila është plot mundësi shprehëse dhe e pasur në fondin e fjalëve e shprehjeve figurative, karakteristikë e një gjuhe të lashtë e kreative, nuk na falet në asnjë rast të abuzojmë me këtë pasuri tepër të çmuar. E them këtë, pasi para disa kohësh më ra në dorë një shkresë e një prej institucioneve tona, e cila u drejtohej drejtorive të shkollave për problemin e transportit të mësuesve në fshatrat e largëta. Shkresa e firmosur prej titullarit kishte 24 rreshta. Teksti përbëhej prej dy fjalive super të gjata dhe kishte 96 gabime ortografike. Për më tepër, ky tekst që komprometon rëndë administratën shtetërore, ishte një mishmash i gjallë pa asnjë pikë kuptimi. Ky është turp intelektual dhe administrativ. Është shqetësues fakti, se kjo shkresë (e cila nuk është as e para dhe as e fundit e administratës së sotme shqiptare në Tiranë e Prishtinë), dëshmon qartë kulturën minimale gjuhësore të atyre që e shkruajnë dhe mosnjohjen e rregullave elementare gjuhësore të vendosura në forumet shkencore akademike. Është turp administrativ sepse, në epokën e sotme demokratike e pa asnjë barrierë, duke vepruar kështu nuk mund të bëjmë fjalë për një administrim cilësor në përputhje me konceptet e kohës moderne.

Mjerisht, pas më shumë se shtatëdhjetë vjetësh, që prej shembullit që morëm prej kohës së mbretërisë, gabimet gjuhësore rezultojnë fatkeqësisht më të thella e më fatale. Duke pasur bindjen e qëndrueshme se ky rast nuk është i veçantë, por refren i përditshëm, rasti i paraqitur si shembull përbën vërtet shqetësim se-

rioz. Kjo padyshim është papërgjegjshmëri totale që vjen nga moskujdesja, por realisht edhe nga mungesa e theksuar e kulturës gjuhësore. Sot shkollat tona i kushtojnë shumë pak hapësirë kulturës gjuhësore, njohjes me rregullat e saj të drejtshkrimit a drejtshqiptimit. Ai që mëson nxënësit, por edhe që shkruan gjuhën shqipe sot (administrata aktuale publike, por edhe gazetarët), nuk merret pothuajse aspak me teknikat e të shkruarit, përzgjedhjes së fjalës shqipe apo artit stilistikor.

"Agresioni" i sotëm imponues dhe rezistenca gjuhësore

Në kombet e qytetëruara i kushtohet shumë rëndësi ruajtjes e lëvrimin të gjuhës, për të mos u "bdarur" (për të mos u prishur, shkatërruar), siç kishte drojën civilizuese Gjon Buzuku për gjuhën tonë, edhe nëse gjuhët e tyre janë të mëdha si në rastin e anglishtes, frëngjishtes, gjermanishtes, rusishtes, apo spanjishtes. Punë shumë më e madhe u del kombeve më të vegjël, pasi gjuha e tyre është e ekspozuar para "agresioneve të ndryshme asimiluese" ose "bdarëse" të gjuhëve të kombeve të mëdha me ekonomi të madhe, e rrjedhimisht kulturë të madhe. Duke qenë se jetojmë në epokën e globalizmit jemi të ndërgjegjshëm se gjuha e kombeve të vegjël ndodhet nën trysinë e "agresionit" të këtyre gjuhëve dhe kulturave të kombeve më të mëdhenj nga të gjitha drejtimet. Një dukuri e kësaj natyre ndodh edhe me letërsinë, muzikën e artin në përgjithësi, teknikën etj. Në kontekstin e gjuhës, me siguri ndikimi i gjithanshëm kulturor (sigurisht edhe ekonomik) është gjithnjë e më tepër prezent e më tepër imponues. Ndërsa në disa drejtime të jetës e zhvillimit ky "agresion" luan rol pozitiv, në aspektin gjuhësor në shumë raste është negativ. Shkurt jemi të detyruar që në fondin e gjuhës tonë të pranojmë shumë fjalë a shprehje që na nevojiten t'i përdorim në praktikën e përditshme. Por, është e pafalshme ta deformojmë gjuhën për



shkak të këtij "agresioni". Ndërkohë ekzistojnë mundësi të pafundme të shmangies, që synojnë ruajtjen e strukturës, fondit dhe normave tona të shqipes.

Nëse gjuha jonë është lëvruar, pasuruar e zbukuruar prej intelektualëve të mëdhenj, që prej rilindjes kombëtare e deri sot, prej Naim Frashërit, Ndre Mjedës, Gjergj Fishtës, Faik Konicës, Aleksandër Xhuvanit, Kostaq Cipos, e deri te Eqerem Çabej, Idriz Ajeti, Ismail Kadare, Rexhep Qosja dhe Dritëro Agolli, është detyrimi ynë atdhetar që jo vetëm t'i ruajmë vlerat e çmuara që kemi por edhe t'i çojmë më përpara hullitë që ata na i kanë lënë të hapura.

A po plagoset sot gjuha shqipe?

Aktualisht, pasuria jonë më e madhe, që është gjuha shqipe, tash po plagoset përnjëmend. Po plagoset prej veprave të dobëta, tepër të dobëta artistike të gjinive të ndryshme letrare. Botohen vëllime poetike, tregime, romane me shumicë, por jo vetëm larg nivelit artistik dhe ideor, por edhe shumë poshtë standardit të gjuhës të përcaktuar nga institucionet shkencore. Në këtë drejtim, mungon pothuajse plotësisht institucioni redaksional gjë që mundëson prodhimin e kësaj letërsie poshtë mediokritetit. Tek ne ende nuk ka një politikë kombëtare që rregullon këtë problem kulturor. Një ditë më dhuruan një dramë në Prishtinë. E mora për mirësjellje, por pa e hapur ende kapakun, vëreja se poshtë titullit nuk ishte shkruar "dramë" por "dram". Gjithë qenien time ma përshkroi ideja se kur niset me një gabim elementar gjuhësor që në kopertinën e veprës së shkruar, merre me mend se si do të jetë brenda.

Gjuha jonë e bukur po plagoset përnjëmend edhe nga gazetarët e publicistët që janë vazhdimisht aktivë në shtypin tonë të përditshëm. Në gazetarinë e sotme nuk ka asnjë shenjë ku të mund të shihet tendenca për ta ruajtur në standardet e sotme, a për ta zhvilluar gjuhën gazetareske si pjesë integrale të gjuhës tonë të përditshme.

Së pari, shkruajmë gjuhë të papastër. Duke shkruar ngutshëm për konsumatorin e informacionit që vlen vetëm për një ditë, gazetari i sotëm nuk e kontrollon fjalën, nuk e lëmon atë, nuk e zgjedh fjalën shqipe që tingëllon bukur e me kumt, por

përdor më së tepërmi fjalë të huaja të panevojshme, që në shumë raste nuk i kupton as ai vetë e as ai që i lexon shkrimet e tij.

Së dyti, nuk kujdeset për fjalinë, materialin e ndërtimit të artikullit, esesë, reportazhit, informacionit apo fejttonit. Mjafton që të transmetojë tek lexuesi lajmin. Kjo është vendimtare dhe ky është qëllimi, pastaj se si e qysh përcillet mesazhi, në ç'mënyrë, me ç'art, me ç'teknikë, nuk ka shumë rëndësi për gazetarin.

Së treti, fjalja nuk ka semantikën e duhur. Ajo në të shumtën e rasteve bëhet lëmsh nëpërmjet fjalive të gjata sa krejt shkrimi, diku del mbiemri para emrit, diku-diku praktikohet kakofoni e panevojshme që varfëron ligjëratën, përdoret fjala e huaj pa asnjë kriter, gjë që rëndon mendimin, duke bërë kështu që materiali gazetaresk të mos jetë i qartë e mendimi të jetë një tollovi e vërtetë.

Së katërti, sot gazetarit të shtypit të përditshëm a publicistit, në shumë raste nuk i ha fort palla për rregullat elementare të drejtshkrimit apo për përdorimin me vend të shenjave të pikësimit. Lëre më që shumë prej tyre nuk i njohin këto rregulla, apo normën e sotme gjuhësore. Edhe sikur t'i njohin ato, ata nuk janë korrekt në vënien e tyre në përdorim gjatë ndërtimit konstruktiv të një shkrimi, në mënyrë që fjala shqipe të përcillet thjesht, drejtpërdrejt, bukur, me tingëllim muzikor dhe me elokuencë, me ngarkesën e duhur emocionale, gjithnjë në funksion të formulimit të një mendimi të qartë e të kuptueshëm.

Së pesti, morfologjikisht, shumë prej gazetarëve e publicistëve, në raport me rregullat e sotme drejtshkrimore, janë në shumë raste në pozicion "jashtë lojë". Pothuajse në çdo rast ngatërrohen kohët e foljeve, e nuk përdoren drejt rasat e emrave apo përemrave. Në vend që të thuhet p.sh., se "Kryeministri, do ta shikojë (ose shohë) me kujdes këtë problem", thuhet se "kryeministri... do ta shikon (ose sheh) këtë problem". Aq më keq kur vërehen raste flagrante të keqpërdorimit në të shkruar, si në rastin kur në vend të shprehjes "kam për t'ia dhënë materialin" praktikohet forma "kam me ja japë!". Ose në vend që të shkruhet "tani fëmija im ka filluar të mësojë" shkruhet "tani fëmija im ka filluar të mësoi". Në vend që të shkruhet "ujë krojesh" praktikohet rëndom "ujë të krojeve" etj. Çdo të thotë kjo? A mund t'i vëmë emër tjetër, përveçse mungesë e theksuar e kulturës gjuhësore?

Se nuk ka se si të trajtohet ndryshe. Unë them se mjerisht kështu është, përkundër përpjekjeve tepër mbresëlënëse të vetë popullit tonë për të përmirësuar gjuhën në të gjitha drejtimet, në kushtet e reja të sotme tepër optimale për të evoluar e pasuruar gjuhën tonë.

Gjuhën e përmirësojnë vetë kombet, jo individët

Pas përfundimit të luftës çlirimtare të vitit 1999, e cila u kurorëzua me dëbimin e okupatorit prej territoreve tona, nuk ndihet më të pranishme në gjuhën e përditshme barbarizma të tilla, si 'strujë' në vend të fjalës 'rrymë', 'zadruga' në vend të fjalës 'shitore', 'devojkë' në vend të fjalës 'vajzë' etj. Kur shikojmë përpjekjen serioze të popullit tonë për ta përmirësuar gjuhën tonë dhe për ta purifikuar atë, ne gazetarëve e publicistëve, letrarëve e historianëve, nuk na falet të luajmë dashje pa dashje rol regresiv përmes shkrimeve tona, që janë ushqim i përditshëm shpirtëror i popullit.

Gjuha jonë shqipe, si një nga me të pasurat e me mundësi të panumërtat shprehëse, padyshim ka nevojë të përmirësohet në përputhje me situatat e reja të krijuara. Kështu përmirësohen të gjitha gjuhët e tjera të botës. Por problemet që i dalin përpara gjuhës shqipe nuk mund të zgjidhen nga një individ apo edhe grup individësh. Meqë gjuha është pronë e një kombi, është detyrë e tij kolektive ta përmirësojë dhe ta pasurojë atë me fjalë të reja, me forma të reja shprehëse, d.m.th., është detyrë e akademikëve dhe institucioneve shkencore gjuhësore, është edhe detyrë e ne... gazetarëve, që jemi të vetmit që komunikojmë përditë me popullin.

Duke ndjekur traditën shembullore të intelektualëve tanë brilantë, prej rilindjes e deri sot, duke parë me seriozitet kontributin që ata kanë dhënë e po japin për pasurimin e gjuhës shqipe, duhet ta kuptojmë mirë misionin që kemi, veçanërisht në kohën kur dikush po do ta "bdarë" gjuhën tonë, po do ta ndajë në gjuhë shqipe e gjuhë kosovarishite. Ruana zot, kur nesër të mbijnë papritur "shkencëtarë" apo "akademikë" të tjerë, që të pjellin prej psikologjisë së tyre të sëmurë edhe ndonjë gjuhë të shqiptarëve të Maqedonisë, të Malit të Zi a të Luginës së Preshevës. ■

Kritikë letrare

Pikëvështrimi shënjuar i tekstit

Secila situatë në rrëfimin e novelave do të përcaktojë fate të ndryshme, duke u bërë edhe kategori përcaktuese- ideore në strukturën e novelave, për t'u parë, para se gjithash, edhe vetë sprovimi dhe fati i personazheve.



Flamur MALOKU

a) Leximi-strukturimi

Novelat e Martin Camajt 'Pishtarët e natës' dhe 'Rrunga-ja në mars' thurin në rrëfimin strukturor fatet dhe situatat e ndryshme përbrenda vetë rrëfimit, për t'u identifikuar kështu edhe më mirë me ngjarjen e shtruar dhe të identifikuar, nëpër të cilën ngjarje personazhet formohen e sfidohen, përballë fatit të përcaktuar. Pra, të dy novelat, 'Pishtarët e natës' dhe 'Rrunga-ja në mars', në rrëfimin e tyre gjatë sistemit kohor, konceptohen në përjetimin dhe në fatin e personazheve. Andaj, përjetimi i këtyre është i ndërlidhur me fatin e tyre. Kjo është e përshkruar dhe e theksuar brenda narracionit të tekstit. Mirëpo, duke qendruar në ide, e sidomos duke njohur fatin e personazheve në kohë, rrëfimi do t'i lërë vend përshkrimit nëpërmjet këtyre situatave-fateve. E themi këtë, sepse secila situatë në rrëfimin e novelave do të përcaktojë fate të ndryshme, duke u bërë edhe kategori përcaktuese-ideore në strukturën e novelave, për t'u parë, para se gjithash, edhe vetë sprovimi dhe fati i personazheve.

b) Identifikim i vetmisë

Në novelën "Pishtarët e natës" sprovimi i personazhit-Nikës, pse jo edhe i definuar, bëhet paraqitje e identifikuar, duke krijuar kështu në tërë hapësirën narrative të novelës një

relacion: **njeri-mohim-vetmi**, brenda idesë. Relacioni i këtyre shtrihet në novelë në formë përjetimi edhe sprovimi. Përjetimi dhe sprovimi në theksim të plotë, bëhet nga vetë kërkimi i vetmisë individuale. Vetmia bëhet e kërkueshme nga Nika për të realizuar një dëshirë: të largohet nga familja, atje thellë në male. Mirëpo, pavarësisht nga kjo vetmi dhe nga ky largim për një ideal jetësor, Nika asnjëherë nuk largohet nga ndjenja e dashurisë që ka për gruan -Lenën. Dashuria për Lenën është e madhe. Kjo dashuri jepet në shtresimin e kodit tematik të novelës dhe në vetë figurën e titullit "Pishtarët e natës". Takimi i Nikës me Lenën natën me dritën e pishtarëve bëhet ide e kësaj dashurie, që e forcon kuptimin e vetë dashurisë



së tyre. Mirëpo, Nika ka një ideal jetësor, i cili e ka shtyrë që të largohet edhe nga ambienti familjar dhe i cili krijon njëherësh edhe vetminë. Shtrirja e vet-

misë në strukturën narrative të novelës reflektohet edhe në gjendjen përjetim-sprovim, që si e tillë kushtëzon edhe fatin e personazhit para kësaj vetmie dhe pangopësie. Vetmia shtrihet në vetë situatën, e cila bëhet domosdoshmëri jetësore-faktike. Kështu, në pjesën më të madhe të novelës, situata dhe përshkrimi i vetmisë kthehet në një përvojë rëndë që është e pranishme te personazhi. Prandaj, që të jemi më të qartë, kjo bëhet para se gjithash për ta realizuar ëndrrën e vet jetësore: blerjen e asaj toke në Gurra, atje thellë në male. Andaj, situata e vështirë në kohën e vetmisë së personazhit në atë vend do të identifikohet. Këtë identifikim të vetmisë Nika mundohet ta argumentojë me idealin që ka, duke e çuar drejt fundit, që bëhet

edhe pasojë, tani të identifikuar në sprovim, si kërkim vazhdimësie jetësore. Kështu, të gjitha ato përjetime në Gurra, që strukturohen nga variantet e sprovave, më të shumtën dalin fakte jetësore të përjetuara. Një fakt i tillë në rrëfimin e novelës është përshkrimi dhe formimi i tij gjatë ndodhjes së tij në Gurra, si ëndërr-ideal, që në shkrimin fikcional përbrenda personazhit përjetohet në pangopësinë individuale. Dëshmia e ekzistuar jetësore e Nikës dhe pangopësia e tij karshi fatit theksohet brenda novelës përmes një përcaktimi tragjik, gjithnjë duke qitur në pah përjetimin e vetë Nikës. Andaj një paraqitje e tillë në fund të novelës, bëhet ide e kësaj pangopësie, pra, reflektim për vetë kohën e vetmisë, që në esencë shfaqet duke u bërë edhe fat tragjik për Nikën:

"I jati qëndronte përmbys, vdekë, në tokën e çelun për së pari, andej kufinit të pronës së vjetër. Mordja, si ta kishte

gjuejtë vetima për së kthjelltit, i kishte ardhë e papritur. E kthyan për së mbari dhe panë se në grushtat e ngrimë e në gojë shtrëngonte dhe. Në tokën e re shihëj lavra e përpushjeve si të egërsinës së ramë në kurthë.”

Tani fati i Nikës theksohet dukshëm, gjithnjë në bazë të asaj që ka ndodhur. Vdekja e tij është shumë misterioze. Kjo njëherësh iu jep shkas të tjerëve që të flasin për të, duke e përkufizuar, karshi vetmisë dhe pangopësisë individuale. Kjo ka kuptimin e asaj që kërkohet vazhdimisht në jetën e përditshme në masën e tepruar të Nikës, duke qenë njëherësh edhe ideal i tij jetësor.

c) Novelë e dashurisë

Ndërsa novela “*Rrungaja në mars*” ndërtohet mbi dashurinë, brenda fatalitetit të personazheve. Pra, është tekst mbi dashurinë e porealizuar të Jerës dhe të Dakut. Dinamika e situatës në rrjedhën e rrëfimit të novelës, do të prekë padyshim fatin dhe përjetimin e Jerës dhe të Dakut, ku konceptohet përjetimi dhe theksimi në domethënien e asaj që krijon dhembja në dashurinë e porealizuar të tyre. Mjaftojnë situata të ndryshme për një personifikim të karakterit të plotë të Jerës, duke dhënë esencën e vetë të përshkrimit e të identifikimit. Dëshira për njohjen e gjërave tek Jera është e madhe. Kjo gjatë thurjes së tekstit bëhet edhe domosdoshmëri. Pra, dëshira e flaktë e personazhit-Jerës

për njohje bëhet esenciale- jetësore, edhe fjalët që kjo jep gjatë shpjegimit tregojnë vendosmërinë e saj. Njohja e Jerës me njerëzit e *Përteqafës* shtrihet në rrëfimin e drejtpërdrejtë, si esencë dhe si eksplikim ideor. Jera nuk i dëgjon as motrat e as familjen. Ishte e vetmja vajzë nga familja që shkonte në shkollë në Shkodër. Ajo vishej si djalë dhe dilte në male, shëtiste vetëm e vetëm që të njihte. E tërë kjo do të bëhet kushtëzim për fatin e vazhdueshëm të Jerës. Tani fati i saj jepet duke sintetizuar idenë e përcaktimit si element i pashmangshëm në kuptimin e pësimit individual. Jera ka dëshirë t'i njohë edhe njerëzit e *Përteqafës*. Aty ajo njih edhe Dakun. Etika e saj vërehet vazhdimisht në strukturën e tekstit. Mirëpo, dashuria në rrafshin e njohjes, vjen ngadalë duke u formësuar, duke u plotësuar dhe do të prekë ndjenjën shpirtërore të Jerës në kuptimin e brendisë-dashurisë. Dashuria bëhet identifikuese karshi Dakut. Kjo vërehet kur Daku vdes-mbytet nga rrungaja në mars, vetëm që ta shohë Jerën, duke mos dëgjuar as të atin e tij. Mirëpo dashuria për Dakun ruhet nga Jera. Kjo do të shihet kur Jera takohet rastësisht në të atin e Dakut pas një viti:

“Një vjetë para se të vdiste, Jera ndeshi në rrugë një plak ma se tetëdhjetë vjeç. Ky kishte shikimin e Dakut, andaj e pyti:

“Si të quajnë, orë burrë?”

“Loshi- U përgjigj ai-Çka po të duhet emni im?”

Kështu, në novelë vërehet së vetë trupi i Jerës është përherë i kalitur nga kujtimet e të së shkuarës. Koha e shkuar mbetet në vetëdijen e Jerës pritje-dhembje-vetmi. Jera, në novelë, vuan në të tashmen jetësore për dashurinë që kishte për Dakun, për një të kaluar shpirtërore, e cila tani artikullohet vazhdimisht në narracionin dhe në strukturën e novelës, në figurën e shprehur. Andaj, për Jerën ndarja në dashuri do të mbetet çdoherë dhembje, e cila bëhet edhe më e vështirë gjatë përjetimit, sepse nga përjetimi i rëndë:

“Sepse Jera kishte vdekë dalëngadalë shumë mote maparë”

Andaj, kjo është dhembja e Jerës, e cila shtrihet, identifikohet, ndërtohet me plotë vuajtje në pritjen e kotë të saj. ■



Kthimi i këngës epike

Këto ditë përfundoi punimet konferenca shkencore ndërkombëtare për epikën e Ballkanit Perëndimor. Në qytetin universitar boshnjak Tuzlla, u tubuan studiuesit e epikës gojore nga shumë shtete të Ballkanit, të Evropës, të Amerikës dhe të Azisë.

Jehona GASHI

Tema bosht e kësaj konference qe puna e profesorit të njohur amerikan të Harvardit, Millmen Peri, (Milman Parry), në fushën e epikës gojore në Ballkanin Perëndimor. Koleksioni i Millmen Perit, i mbledhur dhe i incizuar në vitet 30 të shekullit të kaluar, me ndihmën e asistentit Allbert Llord, është koleksioni më i madh në botë me këngë, kryesisht epike, nga Ballkani Perëndimor, ku vend me rëndësi zënë edhe këngët epike shqiptare. Këtë konferencë shkencore katërditore, që filloi më 3 korrik, me titull Kthimi i këngës: Koleksioni i Millmen Perit (Milman Parry), dhe jehona e tij receptive në botë, e organizuan Universiteti i Tuzllës (Bosnjë e Hercegovinë) dhe Universiteti i Harvardit (Kembrixh, SHBA). Në këtë konferencë, nga Kosova mori pjesë dr. Zymer Neziri, këshilltar shkencor i Institutit Albanologjik të Prishtinës, me kumtesën Lahutarët e Allbert Llordit (Albert Lord) nga Shqipëria e Veriut, që u prit me interesim nga të pranishmit për hulumtimet e tij në Harvard dhe në terren (Shqipëria e Veriut), për lahutarët shqiptarë, me të cilët punoi profesori amerikan A. Llord, më 1937. Grupi më i madh i kumtesave të studiuesve të jashtëm qe ai amerikan, nga universitetet Harvard (David Elmer, Aida Vidan, Peter McMurray), Missouri (John Miles Foley), Berkeley (Ronelle Alexander), etj. Nga studiuesit boshnjakë qenë: Gjenana Buturoviq, Mirsad Kuniq, etj. Kumtesa lexuan edhe shumë studiues nga disa qendra universitare të Ballkanit, si dhe nga Britania e Madhe, Zvicra, Austria, Greqia, Rusia, Irani, etj. Në këtë tubim të madh shkencor, gjatë 22 orëve punë, u lexuan rreth dyzet kumtesa dhe u diskutuan vlerat e tyre nga profesorë dhe studentë, që e mbushnin sallën çdo ditë, gjë që është një rast i rrallë dhe për lakmi. Këshilli Organizues i Konferencës, në krye të të cilit qenë Aida Vidan (Harvard) dhe Mirsad Kuniq (Tuzull) e kreu punën e vet me shumë profesionalizëm dhe përkushtim dhe kjo gjë mund të shërbejë si shembull për të tjerët. Kjo konferencë shkencore ndërkombëtare, e organizuar nga boshnjakët dhe amerikanët, është më e madhja deri më sot e këtij lloji për epikën e Ballkanit Perëndimor. ■

Diskursi kur'anor në letërsinë shqipe (II)

Muhamed ÇITAKU

Bejtexhinjtë e shihnin Kur'anin si një derë për ta përgjithësuar shkrimin. Ata përmes Kur'anit iknin prej realitetit duke përgjithësuar idetë. Pra, poezitë e tyre kishin referenca të dyfishta: realitetin dhe Kur'anin. Këtu diskursi kur'anor hynte me dy funksione: rregullonte jetën dhe ofronte simbole për rend të ri. Përmes të dyjave problemet kohore bëhen simbolike. Pra, kemi idetë sociale që duke komunikuar me Kur'anin prodhojnë ide, situata dhe rende të reja estetike, madje duke qenë simbolike dhe me mundësi komunikimi me të gjitha kohët, vendet dhe njerëzit. Skematikisht, ky komunikim i bejtexhinjve mes shkrimit të tyre, Kur'anit dhe realitetit do të dukej kështu:



Kur'anit i drejtohet gjithë njerëzimit. Ekziston një vetëdije e bejtexhinjve për problemet kohore, por edhe një vetëdije e tyre për shkrimin simbolik.

Diskursi kur'anor me simbolikë jetësore

Bejtexhinjtë morën nga Kur'anit një terminologji të gjerë. Përmes saj ata emëruan jetën, rrethin shoqëror e kulturor, brendinë e tyre, etj. Pra, terminologji për brendi e jashtësi. Madje kjo do të hetohej më shumë po të vihej përballë terminologjisë së autorëve të kohës së tyre të rrethit bibliq. Kjo e zbulon terminologjinë si problem jo dhe aq formal. Ajo përmbledh përbrenda fjalë-koncepte me moralitet të kulturave të ndryshme. Këtu hyjnë

emërtimet si iblis, meleq, Rahim, Rraham, All-llah, Xhebbar, Kur'dret, Kur'an, kible, tespah, Qitap, kurban, sexhde, fetfa, Xhunub, nefis, xhenet dhe xhehenem, etj:

*Gjellrat si në xhenet / Të mira
me shumë lezet
Bilça u mbush me zifafet / Me
tepsi e me sahanë*

Falënderimet ndaj Krijuesit janë shenjat e tjera kur'anore që barten te bejtexhinjtë. Këto dalin si falënderime personale të autorëve përballë fenomeneve të ndryshme jetësore. Pra ato tregojnë për gjendje jo të natyrshme. Me to autori shpreh ose habi të madhe, ose gëzim të madh, ose hidhërim të madh. Pra gjendje që s'mund të shprehen me fjalë të tjera. Këtu hyjnë fjalët si Elhamdulillah, Ej vallah, Ej ehli vafa, Takdirullah, etj. Për shembull te Nezimi kemi:

*Bismil-lah thirra, Allah / Zura
lutjen
O behar, elhamdy-lil-lah, /
Thure këngën*

Te bejtexhinjtë realiteti paraqitet me kulturën e vet islame të sjelljes, të mendimit, të shkrimit a korrigjimit. Në nivel korrigjimi, situatat e ndryshme, veprimet a gjendjet, vihen përballë Islamit. Tash diskursi kur'anor tregon vendin që duhet të kenë kategoritë e njerëzve dhe fenomenet shoqërore. Jemi te bartjet e ideve. Por kjo nuk krijon artistiken. Problemi shkaktohet kur nuk respektohet rendi fetar dhe ndeshen: dramaciteti, çrregullime e parregullsi. Kështu H. Z. Kamberi flet për shtresën e lënë të njerëzve, konkretisht Gratë e va. Tash ndeshet çrregullimi derisa ato nuk respektohen, nuk mëshirohen, askush nuk kujdeset për to etj. Ndërsa autori u kujton se Islami ka respekt të veçantë për to dhe se ato janë nën mbrojtjen e All-llahut xh. sh. ■

Poezi

Jeta nuk është rrugë njëkahëshe

Avni XHEMAJLI

PËR NE S'KA FLAMUR NË GJYSMËSHTIZË

Kokëngritur dua të të shoh si gjithmonë
E jo të mërzitur
Shoku miku im
Botë e intrigave dhe e njerëzve të ligë është kjo
Të mirët nuk e kanë lehtë këtu - për të mos thënë ferr
Qëndro
Siç din të qëndrosh stoik
Shoku dhe miku im, kokëngritur dua të të shoh!
...Se jeta nuk është rrugë njëkahëshe
E as Trekëndësh i Bermudeve
Zotin e Gjithfuqishëm e kemi
Për ne s'ka flamur në gjysmështizë!

HUMBJE E NJERËZORES

Njerëzit e duan jetën
Por bëjnë atë që merr jetën!

Njerëzit i duan armët
Por armët jo njerëzit!

E duan jetën e vet
E duan vdekjen e tjetrit!

SPROVË

Ç'është jeta?
Pyetje që shtruan
dijetarë, poetë, filozofë e shkrimtarë
me radhë ndër shekuj, me radhë

... është mister, është enigmë, zbuloje
është hendek, është sfidë, sfidoje
është stoli, është dhuratë, shijoje
është betejë, është luftë, fitoje
- mos e humb!

Dhe çfarë tjetër është ajo vallë?
Po
Herë hekur, herë akull, herë zjarr
Është jeta
Tërmet ndër këmbë shpeshherë

E nganjëherë?
Flakë në shpirt e në zemër zjarr
Është jeta
Nganjëherë!

FRIKË NGA SHKUJA

Hapi dritaret e tua
mbyllur mos i lë
nxirr krejt çka ke jashtë
gjë brenda mos lë...

Dhe
kur të ngadhënjesh
mbi urrejtjen, frikën e hidhërimin
dije se
ke mposhtur çdo gjë!

Milazim Krasniqi: "Rulët ruse për Ali Pashën", "Arbëria", Tiranë 2004

Ag APOLLONI

Aktualizimi i ngjarjeve historike ka një traditë në dramaturgjri, ku ndonjëherë ka funksionuar edhe si imperativ kategorik i vlerës. Edhe në dramën e Milazim Krasniqit "Rulët ruse për Ali Pashën" kemi një aktualizim të një ngjarjeje të rëndësishme, e cila i flet të sotmes me gojën e të kaluarës. Rrethimisht, qëllimi i aktualizimit është vendosja e një paraleleje mes historisë dhe aktualitetit. Dhe pikërisht, në këtë paralele qëndron mesazhi i veprës dhe ideja e autorit. Kjo dramë, ashtu si edhe "Monedha e Gentit" e këtij autori, paraqet një filtrim të historisë nëpër figurën e ironisë dhe kjo dëshmon qasjen kritike të autorit ndaj objektit.

"Rulët ruse për Ali Pashën" është dramë historike me qasje politike. Qasja e tillë potencion gabimin politik të protagonistit si shkak për humbjen e shansit historik për bërjen e shtetit të Arbërisë. Këtu politika shihet si një lojë fati, ruletë ruse. Milazim Krasniqi e shkruan dramën ruletiane, ku loja e gabuar në gjashtë pamjet paraprake, i prin vdekjes së lojtarit (protagonistit) në pamjen e shtatë, që është pamja e fundit e Ali Pashës dhe pamja e fundit e dramës.

Formulimi i titullit përmban idenë autoriale se loja luhet në kurriz të Ali Pashës. Sintagma "ruletë ruse" etimologjikisht nxjerr në shesh edhe armikun e Ali Pashës, që, sipas zhvillimit të dramës, është armiku rus në kolaboracion me armikun grek, të cilët së bashku shfrytëzojnë moshën e shtyrë dhe mendjen e fryrë të Luanit të Janinës për ta nxitur në luftë kundër Padishahut. Përderisa Ali Pasha udhëhiqet nga ndjenja nacionale (për bërjen e Arbërisë shtet sovran), greku dhe rusi udhëhiqen nga ndjenjat fetare (për bërjen e perandorisë ortodokse apo, si thonë diku, për Bizantin e Ri). Dy nxitësit e konfliktit, greku dhe rusi, deklarohen si përkrahës të Pashës në luftën kundër Padishahut. Fillon loja ruletë. I pari godet Ali Pasha, por akti i tij është vetëm provokim ndaj Padishahut, të cilit, pasi i vjen radha, goditja nuk i shkon huq. Krejt kjo mund të cilësohet si një lojë ruletë, madje tamam ruletë ruse (Russian roulette), sepse rusët i premtojnë, por nuk i japin ndihmë Ali Pashës. Në vend të ndihmës ushtarake, ata ia ofrojnë një "ruletë ruse", domethënë e lënë në mëshirë të fatit.

Struktura e dramës

Drama "Rulët ruse për Ali Pashën" është strukturuar në shtatë pamje. Sipas rregullit dramaturgjik, pamjeve u prin regjistri i aktantëve, ku bëhet radhitja e personazheve pjesëmarrës në dramë. Në krye të listës është Autori, pastaj vjen Aliu si krijesë fikzionale e tij. Regjistri përfshin gjithsej shtatëmbëdhjetë personazhe dhe disa aktantë që nuk kanë status personazhi (roje, statistë). Në regjistrë nuk figuron asnjë femër, sepse autori nuk trajton anën erotike, por vetëm atë nacionale dhe religioze të Ali Pashës. Mungesën e elementit erotik e arsyeton me moshën e shtyrë të protagonistit, pavarësisht se aty-këtu aludohet në shturjen morale të tij, siç janë për shembull skenat e dënimit të fshatarëve, ku dënon njeriun që

Elegji për Arbërinë

mbbron nderin e gruas, ndërsa fal homoseksualizmin që, sipas etikës tradicionale, është nëpërkëmbje e nderit. Hipotetiki i personaliteti i personazhit të Pashait del homoseksual dhe kështu justifikohen disa veprime femërore (paniku dhe vajtimi me zë) në skenat e mëvonshme.


Duke u nisur nga diferencimi që i bën Umberto Eko *fabulës* dhe *thurjes* në "Lector in fabula", mund të shohim se fabula barazohet me logos-in (përmajtjen: çka?) e mesazhit/tekstit, kurse thurja me *lexis-in* (mënyrën: si?). Fabula e dramës së Milazim Krasniqit është kjo: Ali Pashë Tepelena, i nxitur nga "miqtë" e kabinetit të tij, e vret Syrjain e kabinetit të Padishahut për ta nxitur në luftë këtë të fundit dhe për ta mposhtur me ndihmën e "miqve". Ndërkohë nxitësit e tij kuptohet që janë kundër tij. Nga ana tjetër, Padishahu kërkon takim me Pashën, i cili, duke e ditur se çfarë e pret, refuzon ofertën e tij, duke shpresuar në ndihmën e rusëve. Kur e kupton tradhtinë, Ali Pasha i kthehet religjionit, por kot. Naiviteti i tij e ka humbur përgjithmonë shansin për ta bërë Arbërinë dhe për të mbretëruar. I tradhtuar nga "miqtë", Ali Pasha përfundon me vdekje nga dora e zgjatur e Padishahut. Dhe...përralla në shkallë, dukati në ballë.

Fabula nuk konsiderohet parakusht për përcaktimin e vlerës së një teksti. Teoritë e reja më shumë interesohen për thurjen, mënyrën sesi zhvillohet fabula. Konkretisht, thurja e dramës "Rulët ruse për Ali Pashën" ndjek këtë linjë:

Pamja e parë: në skenë del Autori për të bërë një pakt me publikun: "Vetëm Zoti e di saktësisht sesi janë mpleksur ngjarjet që sollën tragjedinë. Drama ime është krejtësisht imagjinare (...) Këtu vetëm loja e aktorëve është e vërtetë". Pastaj Autori deklaron se nuk pretendon të zgjidhë çështje (prandaj dramën e tij Eko nuk do ta cilësonte si vepër definitive), por të shkaktojë dilema (pra të bëjë një vepër aoperative). Ligjërata e shkurtër e Autorit kryen funksionin e diferencimit të fiksionalitetit karshi fakticitetit. Pas largimit të Autorit nga skena, fillon loja e aktorëve nëpërmjet së cilës jepet dilema e Ali Pashës: dëshira për të vrarë dhe droja se mos vritet. Këtë

dilemë e zhdok Kosta, këshilltar intrigant i Aliut, duke ia mbushur mendjen Pashës se Fuqitë e Mëdha, e sidomos Rusia, do ta përkrahin aktin e tij kundër Padishahut. Pas fjalëve të Kostës, Aliu dërgon dy djem ta vrasin Syrjain, të përkëdhelurin e Sulltanit.

Pamja e dytë: në didaskaljen e parë shfaqet simboli kristian, një kryq i madh. Dialogët zbulojnë tre personazhet komplotistë: Kostën, Vladimirin dhe Aleksisin. I pari pretendon ta marrë gruan e Ali Pashës, i dyti synon ta bëjë Bizantin e Ri, ndërsa i treti është thjesht vegël e dy të parëve.



Pamja e tretë: Ali Pasha provokon Padishahun, duke ia plagosur Syrjain. Prandaj Padishahu e shpall Pashën fermanli.

Pamja e katërt: Ali Pasha shfaqet mizor dhe i padrejtë: dënon të ndershmit, fal të pandershmit. Aleksisi, miku i tij i zemrës, i jep pije që ia turbullojnë arsyen. I bëhet me dije që Sulltani do ta sulmojë, por Ali Pasha shpreson në përkrahjen e rusëve.

Pamja e pestë: Aliu është në gjendje paniku. Bën rituale bektashiane. Kërkon ndihmë nga baballarët.

Pamja e gjashtë: Aliu, për t'i treguar se nuk ka ndërmend të dorëzohet, vret Vladimirin. Një pas një, atë e mohojnë të gjithë bashkëpunëtorët. Detyrohet ta

lëshojë kalanë dhe të shkojë në sarajet e liqenit për të pritur një ferman të ri.

Pamja e shtatë: Përderisa Dervishi kërkon vdekjen pas perdeve që luhaten, Ali Pashës i vjen vdekja andej nga s'ë pret: Muhamet Pasha, miku i ngushtë i tij, e ther në mënyrë perfide.

Thurja e dramës është lineare, nga shkaku te pasoja. Sipas Todorovit, kjo formë e mbajtjes së interesimit të lexuesit cilësohet si suspens. Ndërkaq, zgjedhja e diskutit deklarativ si formë e ligjëritimit shpallon vetëdijen e dramaturgut mbi emetimin retoriko-patetik si mënyrë më efektive për bindje. Qëllimi i kësaj drame nuk është zbukurimi i veprimit, po dhënia e idesë. Autori preokupohet me ideologemë, idenë e bërjes së shtetit të Arbërisë, prandaj kjo ide e madhe dominon mbi veprimin, i cili është ilustrim/animizim i idesë autoriale.

Në radhë të parë, "Rulët ruse për Ali Pashën" është dramë e idesë. Ideja është e lidhur me figurën e Ali Pashës, kështu që ajo mund të quhet edhe dramë e protagonistit.

Ideja e aktualizimit të historisë i jep dramës karakter reflektiv/kritik. Paralelja mes kohës së protagonistit dhe kohës së autorit dëshmohej edhe në ngjashmërinë e kohës fabulative me kohën e shkrimit/botimit. Të dy kohët kanë të përbashkët shansin historik: bërjen e shtetit të Arbërisë dhe bërjen e shtetit të Kosovës. Protagonisti dhe autori gjenden në prag të bërjes së shtetit të tyre.

Dramaturgu Milazim Krasniqi është edhe analist politik, prandaj një nga mesazhet e dramës së tij është edhe mesazhi politik. Aktualizimi i figurës historike të Ali Pashës mund të shihet edhe si një apel për përgjegjësi drejtuar parisë së Kosovës në kohën e shansit historik. Sintagma "rulët ruse" është nyja ku lidhen koha e personazhit dhe koha e autorit. Ajo shënjon lojën e rrezikshme. "Rulët ruse për Ali Pashën" është një "metafiksion historiografik" (L. Hutcheon) i shkruar për një shans historik të humbur. Prandaj, drama e tillë nuk ka se si të lexohet ndryshe, pos si një elegji për Arbërinë që s'u bë dot. ■

Dehidrimi

Iliriana Alloqi & Bernard Tahirbegolli

Dehidrimi është mungesa e mjaftueshme e ujit në organizëm. Ai mund të rezultojë nga mosmarrja e mjaftueshme e ujit apo largimi i tepruar i tij nga organizmi dhe mund të jetë i menjëhershëm apo i ngadalshëm.

Dy të tretat e trupit të njeriut (përafërsisht 70%) përbëhen nga uji. Uji është një substancë esenciale për funksionimin e trupit të njeriut. Ai mban të lagur syrin, ndihmon tretjen, pastron hapësirat e hapura të organizmit dhe e mban lëkurën të shëndoshë. Në kohë të nxehtë, një person i rritur humb mesatarisht 2.5 litra ujë në ditë. Kjo humbje



Nëse jeni punëtor aktiv në kohë të nxehta është rrezik i madh se mund të pësoni dehidrim. Për ta parandaluar këtë duhet ta shtoni sasinë e ujit që merrni.

bëhet nga mushkëritë me anë të frymëmarrjes, nga lëkura me anë të djersitjes apo nga veshkat me anë të urinimit. Po ashtu, uji humbet edhe përmes jashtëqitjes. Për të mbajtur balancimin ujqor të organizmit duhet që brenda ditës të merret e njëjta sasi e ujit që largohet.

Përafërsisht, dy të tretat e ujit që na nevojitet merret nga pijet dhe një e treta nga ushqimi. Ndërsa një sasi e ujit vjen nga vetë reaksionet kimike në organizëm. Uji përbën më se 80% të trurit dhe ai është elementi esencialisht i transmetimit të sinjaleve nervore. Marrja e paktë e ujit ndikon drejtpërsëdrejti në aftësinë për të mësuar dhe për t'u koncentruar. Shumë njerëz dehidrohen nga koha në kohë dhe, zakonisht, kjo është e lehtë të përmirësohet. Por një e treta e tyre e ngatërrojnë ndjenjën e etjes me atë të urisë, kështu që në vend që të

Gjatë jetës së tij, një person pi mesatarisht 60 600 litra ujë.

pinë ujë ata hanë ushqim. Duke marrë parasysh se 50% e popullatës botërore është e dehidruar, se 75% e qytetarëve në vendet e zhvilluara janë në dehidrim kronik dhe se gjatë dehidrimit të lehtë i gjithë metabolizmi i trupit zvogëlohet për 3%, atëherë mund të themi se dehidrimi është vërtet problem global, edhe përkundër faktit që planeti ynë ka më shumë ujë se sa tokë. Është konstatuar se pirja pa masë e ujit të detit shkakton dehidrimin e qelizave dhe dëmtimin e veshkave. Ndërkohë organizmi është i aftë të pranojë vetëm 0.2 litra ujë deti në ditë nëse veshkat janë të shëndosha.

Nëse jeni i sëmurë apo keni barkqitje të shpeshta duhet ta shtoni sasinë e ujit të marrë.

Cila kategori njerëzish atakohet nga dehidrimi?

Dehidrimi, si problem, mund të atakojë çdokënd, por predispozita të veçanta kanë:

- ◆ Foshnjat dhe fëmijët për arsye se kanë peshë relativisht të vogël dhe kjo i bën më të ndjeshëm ndaj humbjes së lëngjeve trupore.
- ◆ Pleqtë që zakonisht hanë pak dhe që mund të harrojnë të hanë dhe pinë gjatë ditës.
- ◆ Njerëzit me sëmundje kronike, si

ato të veshkave dhe njerëzit e alkoolizuar janë më të rrezikuar nga dehidrimi.

◆ Sëmundjet akute, si infeksionet virale, mund të rezultojnë me dehidrim për shkak të temperaturës, djersitjes dhe humbjes së lëngjeve nga trupi.

◆ Njerëzit që jetojnë apo punojnë në klimë të nxehtë, apo ata që bëjnë ushtrime apo lëvizje të tjera.

Me rritjen e moshës, toleranca e trupit për zvogëlimin e ujit ulet dhe personi ndihet i etur më shpejt. Sëmundjet e vështirësojnë më së shpeshti të ushqyerit dhe të pirit e mjaftueshëm. Agjencioni për Standardet e Ushqimit rekomandon që në vendet me klimë të nxehtë të merren 1-2 litra ujë brenda ditës. Ky agjencion, paralelisht me ujin, rekomandon edhe qumështin dhe lëngjet e frutave.

Kush e shkakton dehidrimin?

Dehidrimin e shkaktojnë:

- ◆ aktiviteti i zgjatur fizik pa konsumim të sasive adekuate të ujit, posaçërisht në mjedise të ngrohta,
- ◆ ekspozimi i zgjatur në ajër të thatë,
- ◆ gjakderdhjet nga traumat fizike,

Rekomandimi standard për fëmijët shkollor është 6-8 gota ujë në ditë dhe posaçërisht 3-4 gota ujë përderisa janë në shkollë.

Nëse ushtroheni duhet të pini deri në një litër ujë shtesë për një orë ushtrime. Kjo duhet shtuar doemos nëse ushtroheni në temperatura të larta, apo djersitni më shumë dhe trupi humb shumë ujë menjëherë.

- ◆ diarreja (barkqitja),
- ◆ hipertermia (temperatura e lartë trupore),
- ◆ shoku,
- ◆ të vjellit,
- ◆ të qarët,
- ◆ kequshqyerja,
- ◆ çrregullimi i elektroliteve,
- ◆ hiponatriemija/hyponatriemia,
- ◆ agjërimi,
- ◆ humbja e shpejtë e peshës trupore,
- ◆ refuzimi i të ngrënit dhe të pirit,
- ◆ pirja e tepërt e alkoolit,
- ◆ sëmundjet ngjitëse, si: kolera, gastroenteriti, shigelloza, ethet e verdha, etj.

Humbja mbi 15% e ujit është fatale për njeriun

Kur humbet 2% e sasisë normale të ujit në organizëm themi se kemi të bëjmë me dehidrimin e trupit. Ai, fillimisht, manifestohet me etje që shoqërohet me humbje të oreksit, zvogëlim të urinimit, gjegjësisht të sasisë së urinës, tharje të gojës dhe së fundmi me tharje të lëkurës. Kjo mund të shoqërohet edhe me kapsllëk.

Humbja 5-6 % e ujit mund të shkaktojë përgjumje, kokëdhembje apo mundim për vjellje apo mpirje të buzës.

Pas humbjes deri në 10-15 % të ujit muskujt mund të shtangoen, lëkura bëhet e vrazhdë – çahet, shikimi turbullohet, urinimi zvogëlohet dukshëm dhe bëhet i dhimbshëm, po ashtu mund të pasojë edhe humbja e vetëdijes.

Humbja mbi 15% e ujit zakonisht



Uji i humbur nga ushtrimet fizike duhet të kompensohet 150 % për t'u arritur ekuilibri normal i tij në organizëm.

është fatale për njeriun.

Trajtimi më i mirë për dehidrimin fillestar është pirja e ujit dhe ndalja e humbjes së ujit. Kompensimi i ujit dhe i elektroliteve është i domosdoshëm për trajtimin e fazave të tjera të dehidrimit. ■

Për çdo 1 % të ujit të humbur nga organizmi aktiviteti sportiv bie për 10 %.



Historia e sukseseve të boksierit nga Kosova duket se po shkon drejt fundit

Shkëlqimi dhe rënia e Luan Krasniqit

Junikasi vazhdon të ëndërrojë një brez kampioni, por situata në terren duket mjaft e vështirë



Liridon IBËRDEMAJ

Luan Krasniqi vazhdon të jetë edhe sot e kësaj dite shqiptari më i famshëm i ringut profesionist, por në skenën evropiane e atë botërore të boksit profesionist kanë filluar ta konsiderojnë si një ish. Junikasit, që kishte arritur të fitonte titullin e kampionit të Evropës për peshat e rënda vite më parë, do t'i duhet që të kënaqet me rezultatet e së kaluarës së karrierës së tij pasi e ardhmja duket se nuk i rezervon ndonjë gjë të mirë. Luani vazhdon të insistojë në aspiratën e tij për të fituar titullin e kampionit të botës, por duket se përveç dëshirës nuk ka shumë gjëra të tjera që i japin ndonjë arsye për të besuar se do të ketë përsëri rastin për të sfiduar ndonjë nga brezat e rëndësishëm të kampionit të botës.

Madje, jo shumë kohë më parë, ka

rishfaqur edhe një herë ambicien e tij për t'u bërë "gjermani" i parë pas legjendarit Max Schmeling që të fitonte titullin e boksierit më të fortë në botë. Në të njëjtën kohë, kjo do ta bënte atë edhe të parin boksier me gjak shqiptari që do të fitonte një titull botëror në një nga katër versionet e mëdha të ringut profesionist.

"Momentalisht mund të them se këtë vit do të boksoj. Për shkak të Lojërave Olimpikë "Pekin 2008" dhe Kampionatit Evropian, gjatë verës nuk kam pasur mundësi që të planifikoj ndonjë përballje" – ka thënë Krasniqi për mediat gjermane duke paralajmëruar kështu rikthimin e tij në ring.

"Dua të boksoj përsëri sa më shpejt që të jetë e mundur, mundësisht kundër një kundërshtari që është në mesin e dhjetë më të mirëve. Unë jam i gatshëm për të luftuar" – ka shtuar Krasniqi.

Ai planifikon që të përballet së pari me një boksier të nivelit të lartë në mënyrë që ta renditë përsëri emrin e tij në mesin e pretendentëve për një brez të kampionit botëror në kategorinë e rëndë.

Një ëndërr kjo të cilën për pak sa nuk e realizoi, por amerikanin Lamon Brewster shkatërroi gjithçka me një "nokaut" në rundin e nëntë të një dueli që u zhvillua në Shtutgart të Gjermanisë.

Megjithatë, nuk është gjithçka kaq e thjeshtë. Boksieri shqiptar nga Kosova ka kohë që nuk konsiderohet si një pretendent për titull dhe për këtë arsye federata WBA nuk e pranoi atë si sfidues për uzbekun Ruslan Chagaev për të luftuar për titullin e kampionit të botës në kategorinë e rëndë, pavarësisht se të dy boksierët ishin marrë vesh për një duel ndërmjet tyre.

Edhe koha duket se nuk po punon shumë për të, pasi më 10 maj ai mbushi 37 vjet. Në një moshë të tillë vështirë të të jepet një rast tjetër për titullin kampion, sidomos nëse nuk e dëshmon në ring se je akoma në formën tënde më të mirë.

Dy raste të shkuara dëm

Në vitin 2005, Krasniqi ishte shumë afër realizimit të ëndrës së tij teksa po udhëhiqte me pikë pas shtatë rundeve të para të duelit me amerikanin Lamon Brewster. Por një pakujdesi në rundin e tetë të duelit i kushtoi me humbje. Rruga për të arritur deri aty kishte qenë e gjatë dhe aspak e lehtë. Pas debutimit më 1997, Krasniqi i ishin dashur pesë vite dhe 19 fitore në ringun profesionist për të pasur mundësinë që të luftonte për titullin evropian në kategorinë e rëndë. Një fitore e vështirë ndaj Rene Monse në vitin 2002 e kurorëzoi atë si mbretin e boksit evropian, por që në mbrojtjen e parë e humbet titullin duke e dorëzuar ndeshjen përballë polakut Przemyslaw Saleta. Do të duheshin edhe dy vite të



©Eroll Popova

tjera për ta rimarrë titullin evropian të cilin pasi e mbron me sukses dy herë e dorëzon për të sfiduar titullin botëror. Dhe pasi mposht Lance Whitaker në një duel eliminator në maj të 2005-tës, në shtator të po këtij viti sfidon për herë të parë titullin kampion, por Lamon Brewster pengon realizimin e ëndrrës së tij. Pas kësaj u deshën edhe dy duela me boksierë të fortë si David Bostice e Brian Minto për të fituar të drejtën edhe për një luftë tjetër eliminatorë për titullin botëror. Një fitore ndaj Tony Thompson ishte një mundësi e mirë për t'u afruar me brezin e kampionit, por një paraqitje tejet e dobët nga ana e Krasniqit nuk mund të kishte një rezultat tjetër përveç humbjes me nokaut teknik në rundin e pestë.

Këto janë mundësi "të shkuara dëm" dhe mediat gjermane tashmë nuk i kushtojnë rëndësinë e mëparshme boksierit të lindur në Junik të Kosovës, ndërsa analistët botërorë të boksit nuk e shohin atë më si një pretendent real për të fituar titullin e kampionit të botës në një nga katër versionet e rëndë-



Një tjetër luftë e vështirë për titull

I renditur në pozitën e 30-të në klasifikimin e boksierëve më të mirë të botës në kategorinë e rëndë, Krasniqit i duhet të paktën edhe një duel, në mos më shumë, me ndonjë boksier të renditur lart në ranglistat botërore për të bërë realitet aspiratën e tij për një tjetër luftë për titullin e kampionit të botës.

Por lajmi i keq për të është se asnjë nga emrat e mëdhenj nuk dëshiron që të ngjitet në ring me 37-vjeçarin pa një shumë të madhe parash, pasi një fitore përballë Krasniqit një boksieri të renditur mirë nuk i shërben shumë.

Mendohej se talenti Aleksander Dimitrenko do të përballlej me Krasniqin në mars të këtij viti, por ukrainasi

që renditet në mesin e 5 më të mirëve në katër federatat kryesore të boksit profesionist u bë pishman dhe e anuloi duelin. Më pas u përfol për një tjetër duel për titullin e kampionit të Evropës, kësaj radhe përballë britanikut veteran Matt Skelton, duel të cilin Krasniqi e refuzoi, ashtu si bëri edhe për një duel të mundshëm ndaj holandezit Richel Hersisia.

Vetëm një kombinim tejet i komplikuar do t'i jepte mundësinë Krasniqit që të luftojë edhe një herë për titullin kampion bote në një nga katër versionet e mëdha. Së pari, ai duhet të fitojë ndaj një boksieri të njohur dhe të përmirësojë pozitën e tij në renditjen botërore e më pas të shpresojë që kampioni aktual i botës në versionin WBA, uzbekistanasi Ruslan Chagaev të mos e humbasë titullin e tij. Chagaev-i do të boksojë me 5 korrik përballë gjigandit rus Nicolay Valuev, por një dëmtim i Chagaev-it bërë që dueli të anulohet për herë të dytë. Tani federata WBA ka gjasa që t'ia marrë brezin e kampionit boksierit nga Uzbekistani dhe ta shpallë "vakant".


Krasniqi mund të shpresojë për një duel me Ruslan Chagaev, nëse ky do të vazhdojë të jetë kampion bote, për faktin se të dy boksierët menaxhohen nga "Universum Box Promotion", kompani që kishte planifikuar këtë vit një përballje mes të dyve për titullin kampion bote, por që ishte anuluar pas refuzimit të federatës WBA për ta pranuar Krasniqin si "sfidues" për titullin botëror. Në rast të kundërt, aventura e Krasniqit për t'i siguruar vetes një tjetër luftë për titullin botëror duket një mision gati i pamundur. ■

sishme, duke e vënë në pikëpyetje të ardhmen e karrierës së tij.



Fjalëkryqi

Autor: ENDRITI	PRINCESHA E NDJERË BRI- TANIKE (orgj.) DRUAJTJE, FRIKË (shq.)	▼	MJESHTËRIA E PARASHT- RIMIT TË PYETJEVE NË MËNYRË TË DUHUR	PRONË E VOGËL E SPAHIJVE OTOMAN (shq.)	EMNAK I EMRIT ATAGA	GRADË USHTARAKE	🌐	BASHKËT- INGËLLORE	OPEN KERNEL ENVIRONMEN	MUAJI I TRËTË I STINËS SË PRANVERËS	GRUP NJEREZISH TË LIDHUR NGA INTERESA VETJAKE TË NJËJTA (shq.)	RESHAT ARBANA	URUGUAI, MALTA	VEND ME DRURË E ME SHKURRË TË DENDURA
RREGULL NË TË NGRËNË E NË TË PIRË (sh.shq.)							AKTORI NË FOTO TONELATA	◇	◇	◇	◇	◇	◇	◇
GJË E RRALLË E ME VLERË (lat.)								DJALË OSE VAJZË DERI TETË A NËNTË VJEC 3.14						
TINGULLIMITI- MI (muz.)												PJESË E ILIRISË	BRAGA LLOJ PEME	
LLOJ SHPATE JO SHUMË E GJATË (shq.)									TRAJNERI ITALIAN XHOVANI	E MALLKOVE, E PJESË E MOTORIT				
ANGLIA		ERBIUM ZANORE			"RIMINI" QË KA TË BEJE ME FSHATIN			KRYEQYTETI I LIBISË LLOJ DRURI (shq.)						
🌐	PRINC ARAB I FUTUR NË UJËRA						AKTORI HOLLIVUDIAN LESHLI	PËR (huaj) ZANORE				SHKRONJA e 13-të dhe e 17-të PERËNDESHA E LUFTËS (mit. gr.)		AI QË PUNON ME LATË
KËNGËTARJA PERUANE SUMAK		ANTALYA UARDER (shk.)		VEPRIM I NJËANSHËM ZANORE										
KUJDESTARI (lat.)								EMËR MASHKULLI GJERMAN PRAPE				FUTBOLLISTI TIAGO	ZANORE KËNGËTARI I FAMSHËM RAMAXOTI	
RADIO TELEVISIONI ITALIAN (orgj.)				MONOPOLIZIM (sh.shq.) KËNGËTARJA GJATA										
▶							AKTORI I FAMSHËM BRED TRUP QIELLOR NË SISTEMIN DIELLOR			GJYMTYRË E TRUPIT ROSTOCK, INTER				
KANCELARIA GJERMANE ANGELA BASHKËT- INGËLLORE		AKTORI PACINO KLUB FUTBOLLI BELG			FUJE E HOLLË PAMBUKU AUSTRALIAN NATIONAL UNIVERSITY			GOJËTAR BASHKËPUNË- TORET NË NJË PUNË TË KEQE						
UTAH, LUISANA			MUZIKANTI BEQIRI (shq.) MJESHTËRIA QË USHTRON DIKUSH (pashq.)									KAMPIONI		
KËNGËTARJA SHQIPTARE RADI								RENS ISTVUD KITARISTI BRITANIK KLEPTON (shq.)						
🌐	LIGJET (vjet.) FUTBOLLISTI SPANJOLL HOZE MARIA											PAJTUESH- MËRI (turq.)		
AKTORJA AMERIKANE DAVIS					THESAR, ARKË SHTETËRORE (huaj) EPOKË (shq.)									
GODINA MBI LUM				SHKENCA MBI MORALIN OMANI, BOLIVIA										
MUAJI I VITIT							KENDRICK EXTRICATION ZELANDA SHKRONJA E 24-të							
INDIUM			LËNDË PLASËSE (shq.)											



PAQJA

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË



Shtoiçë

Kontribut për ndriçimin e figurës fetare të mulla Idriz Gjilanit

Mulla Idriz Gjilani në mesin e 100 udhëheqësve më të mëdhenj muslimanë të shekullit të 20-të



Vlerësimi i lëvizjes feministe perëndimore nga këndvështrimi islam

Kontribut për ndriçimin e figur



Mr. Sadik MEHMETI

Ndonëse dihet se mulla Idriz ef. Hajrullahu ka qenë myfti i Gjilanit, megjithatë, deri më tani, nuk na është e njohur se kur dhe nga kush që emëruar në këtë detyrë, ku dhe para kujt e pati dhënë betimin.

Prandaj, të dhënat që po paraqesim në vazhdim, japin përgjigjen pikërisht për këto pyetje dhe kështu janë një kontribut dhe shërbejnë për ndriçimin e figurës fetare e patriotike dhe plotësojnë biografinë e mulla Idriz Gjilanit, pa pretendimin se do të thuhet të gjitha.

Pasi Prishtina, që nga gushti i vitit 1941 që bërë seli e Prefekturës, e cila kishte gjithsej 31 komuna dhe përfshinte nënprefekturën e Gjilanit dhe të Ferizajt, ajo që bërë edhe qendër e institucioneve të shumta të prefekturës e të nënprefekturave dhe ishte edhe qendra e njëjës prej dy kryemyftinive, sa ekzistonin atë kohë në Kosovë, pikërisht e Kryemyftinisë së Zonës së Prishtinës, e cila varej

nga Këshilli i Ulemave të Komunitetit Musliman, me seli në Tiranë.

Kryemyftinia e Zonës së Prishtinës, me seli po në Prishtinë, përfshinte zyrat e vakëfeve në Gjilan, Skenderaj dhe Ferizaj.

Në këtë kohë, gjithandëj në territoret e Shqipërisë së Madhe, pra edhe në Prefekturën e Prishtinës, në vendet kyçe të administratës e të institucioneve u emëruan vetëm shqiptarët e Kosovës ose të ardhur nga Shqipëria. Njësoj ndodhi edhe me institucionet islame, në të cilat u emëruan personat më të aftë, më të përshtatshëm, patriotë që kishin dhënë prova të atdhedashurisë në vitet ndërmjet dy luftërave botërore.


Kështu, edhe në myftininë e Gjilanit do të gjendej njeriu më adekuat dhe më i merituar - mulla Idriz ef. Hajrullahu, i cili do të emërohej në këtë post në bazë të vendimit dhe të urdhrit të Kryesisë së Këshillit të Ulemave të Komunitetit Musliman Shqiptar në Tiranë, nr. 548, datë 10 nëntor 1943.

Ç'është e drejta, emërimi i myftiut të Gjilanit ishte bërë pas shkresës nr. 217/II, dt. 6 tetor 1943, të Zyrës së vakëfit të Gjilanit dërguar Këshillit të Ulemave të Komunitetit Musliman Shqiptar, që

tregonte se veprimet e kësaj zyre kishin mbetur gjithnjë pezull dhe pa u plotësuar, për shkak të mosvazhimit për shumë kohë të veprimtarisë së anëtarëve të kësaj zyre, dhe pasi Drejtori i Përgjithshëm i Vakëfeve të Tiranës, z. Salih Vuçiterni, kishte propozuar që të shpejtohej emërimi i një myftiu, i cili pastaj të merrte masat për zgjedhjen e një këshilli që do të kryesohej prej tij, për zhbllokimin e

këtyre çrregullimeve në këtë Zyrë.

Prandaj, Këshilli i Ulemave, në mbledhjen e tij mbajtur më datë 10 nëntor të vitit 1943, kryesuar nga Eminenca e tij, H. Sherif Langu, kryetar, z. Dervish Hilmi Islami e Haxhi Ibrahim Kaduku, nënkryetarë dhe z. Sylejman Kadiu e Haxhi Bedri Hamidi, anëtarë, kishte vendosur: "Emnimin e Z. Idriz





Arbëresh fetare të mulla Idriz Gjilanit

Hajrullahit si Myfti i N/Prefekturës së Gillanit, mbasi i ka cilsinat e duhuna për këtë detyrë". - konstatohet në atë vendim, për të vazhduar: "Betimi ka për t'u ba për këtë herë përpara Titullarit të Kryemyftinis Prizrenit".

Ç'është e drejta, dhënia e betimit para organeve kompetente atë kohë ishte e domosdoshme dhe bëhej sipas nenit

26 të Statutit të Komunitetit Musliman dhe atë duhej ta jepnin të gjithë nëpunësit fetarë, përfshirë këtu edhe imamët dhe myezinët.

Teksti i betimit kishte një përmbajtje fetare dhe kombëtare mjaft domethënëse, dhe ai, sipas dokumenteve të kohës, ishte i njëjtë për të gjithë, me të vetmin përjashtim që në fund të betimit të ndonjë nëpunësi shtohet edhe "Vallllahi, Bil-lahi", që d.m.th.: Pasha Zotin, betohem në Allahun.



Kështu, myftiu mulla Idriz ef. Hajrullahu, në zyrën e Kryemyftinisë së Zonës së Prizrenit, më datë 5 dhjetor të vitit 1943, kishte dhënë betimin para myftiut Hasan ef. Islami (i njohur në popull si Hasan ef. Nahi).

Për këtë, me një shkresë, datë 20 dhjetor të vitit 1943, myftiu i Prizrenit Hasan ef. Islami, e njoftonte edhe Kryemyftininë e Prishtinës, nga e cila varej n/myftinia e Gjilanit.

Aty thuhej: "Kemi nderin me ju njoftue se simbas urdhnit të Kryesisë së Këshillit të Ulemave të Komunitetit Musliman të Tiranës, nr. 361/1, dt. 17. XI. 1943 Hirsija e Tij Idriz Hajrullahi myftiu i Gillanit me datë 5. XII. 1943 asht prezentue kësaj Kryemyftinije dhe ka dhan betimin e duhun, kopja e cillës këtu bashkangjitet.

Me lutje për njoftim.

V.V. /Kryemyftinija e Zonës-Prizrend/

Kryemyftiu, Hasan Islami, d.v.

Në vazhdim ja dhe teksti i procesverbalit mbajtur me rastin e aktbetimit të myftiut mulla Idriz Hajrullahu, i cili i qe bashkëngjitur njoftimit të kryemyftiut të Prizrenit:

"AKT BETIMI

E mbajtur me datë 5 Dhjetor 1943 në zyrën e Kryemyftinisë së Zonës Prizrend simbas urdhnit të Këshillit të Ulemave të Komunitetit Musliman të Tiranës Nr. 361/1 datë 17. XII. 1943.

Të ftohun u paraqit në zyrën e Kryemyftinisë Hirsija e Tij Idriz Hajrullahi i cilli me vendimin e Këshillit të Ulemave Nr. 548 datë 10. XI. 1943 asht emnue si myfti në Gillan dhe në bazë të Artit 26 të Statutit të Komunitetit Musliman, pranë titullarit të kësaj Kryemyftinije u betua si ma posht vijon:


"I nënshkruemi Idriz Hajrullahi betohem në emën të Perëndisë se do të jam besnik i shtetit Shqiptar, i Statutit, i Atdheut e se do të kryej detyrën t'eme me ndërgjegje të pastër Kombëtare, tue ruejt besnikërinë kundrejt urdhnave fetare dhe tue respektue plotsisht Statutin e gjithë rregulloret e Komunitetit".

Idriz Hajrullahi, d.v.

V.V. Sekretar, Abdurrahim Kuqani, d.v."

Vula me shkabë

Dekreti me të cilin z. Idriz Hajrullahu ishte emëruar myfti i Gjilanit, përmes kryemyftiut të Prishtinës - myderrizit famëmadh, profesorit të arabishtes në Medresenë "Isak Beg" të Shkupit, bashkëpunëtorit të rilindësit dibran Said Najdenit dhe të Hasan Prishtinës, kurse më pas edhe të Ferat be Dragës dhe të Sheh Mehmet Sezait të Prishtinës, një si nervit mendor të Organizatës Politike Kombëtare Shqiptare "Xhemijeti"- "Bashkimi", në vitet 1919-1925 dhe veprimtarit të Komitetit të Kosovës, para



dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, dhe shokut të ngushtë të mulla Idrizit, - Rexhep ef. Remziut, i qe dërguar atij nga ana e këshilltarit të Këshillit të Ulemave të Komunitetit Musliman, - z. Bedri Hamidit personalisht, me rastin e ardhjes së tij në Prishtinë.

Në një dokument tjetër të kohës shkruan:

"Bashkangjitur dërgohet Dekreti si dhe shkresa e K. K. Ulemave të z. Idriz Hajrullahit si Myfti në Gjilan, të cilat janë dorëzue kësaj Myftinie prej Hirësisë së Tij, H. Bedri Hamidit personalisht në rastin e ardhjes në këtë qytet. Të na lajmërohet marrja.

V.V. /Kryemyftinija e Zonës së

Prishtinës/

Rexhep Remziu, d.v.

Prishtinë, dt. 4.1.1944

Ndërkaq, Idriz ef. Hajrullahu, duke iu përgjigjur Kryemyftinisë së Prishtinës, atë e njoftonte: "Më datë 16. 1. 1944, iu ashtë dorzue dekreti nr. 131 datë 18. XI.1943".

Pas marrjes së detyrës së myftiut të Gjilanit, mulla Idrizi kishte bërë menjëherë rregullimin dhe organizimin edhe të Zyrës së Vakëfit të Gjilanit, e cila atë kohë, si gjithkund tjetër në territoret e Shqipërisë së Madhe, vepronte në kuadër të myftinisë, ndërsa myftiu ishte edhe kryetar i Zyrës së Vakëfit.

Nëpunës i zyrës së Vakëfit të Gjilanit

ishite Hilmi Kallaba, i cili me vendimin nr. 354, dt. 30 qershor 1943, qe emëruar sekretar dhe arkëtar. Më herët detyrën e sekretarit të Zyrës së Vakëfit të Gjilanit e kryente Ferid Kadriu, ndërsa arkëtar ishte Mahmud Bashoviç, boshnjak.

Ndërkaq, anëtarë të këshillit të këtij Vakëfi "pasi që ishin gjetur të arsyeshëm dhe mundin", ishin emëruar: Haki Taibi (Sermaxhaj), myderriz i vendit, nënkryetar i Vakëfit, Mehmed Behluli, me i-hazet (diplomë të medresesë) dhe imam zyrtar, Sabit Maksudi, me shkollë ruzhdie, kryeplak i vendit, Mehmed Shabiu, me shkollë ruzhdie, tregtar i vendit, Hidajet Bejtullahu, me shkollë ruzhdie, tregtar i vendit dhe Ali Said Hysejni, me gjashtë klasë të medresesë dhe tri klasë të shkollës profesionale të Gjilanit.

Në fillim të punës së tij si myfti i Gjilanit, mulla Idrizi kishte përdorur një vulë, e cila nga Kryemyftinia e Zonës së Prishtinës ishte cilësuar se "nuk është e rregullt dhe si asht caktue prej ligjit", sepse "në mes ka shkabë dhe shkronjat janë gdhendun të shtrembta"

Kjo, thënë kushtimisht ishte vulë personale e mulla Idrizit me diametër 1.75 cm., në të cilën nga e djathta në të majtë, me shkronja të gdhendura në mënyrë joprofesionale dhe të panive-luara, shkruante: ZYRA E MUFTIUT, ndërsa poshtë: NE GILAN. Në sfondin e saj ishte gdhendur shqipja (shkaba), gjithashtu e shtrembër dhe jokonven-cionale, e cila dëshmonte për ndjenjat patriotike të mulla Idrizit.

Meqenëse "këtu (në Kosovë - S. M.) nuk asht e mundun sigurimi i tyne (vulave - S.M.)", Kryemyftiu i Prishtinës kishte kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve e Tiranës që një vulë e tillë "të dërgohet sa më parë". Kështu, kjo drejtori, më datë 7 shkurt 1944 ia kishte dërguar vulën zyrtare n/myftinisë së Gjilanit, e cila ishte e ngja-shme me vulat e nënmyftinive të tjera të asaj kohe.

Prandaj, nga sa u tha më lart, mund të përfundojmë se mulla Idriz ef. Hajrullahu u emërua myfti i Gjilanit nga Këshilli i Ulemave të Komunitetit Musliman të Tiranës, me vendimin nr. 548, datë 10 nëntor 1943, ndërsa betimin e kishte dhënë në Prizren më datë 5 dhjetor 1943, para kryemyftiut të Prizrenit Hasan ef. Islami - Nahi.

P. S. Fusnotat i hoqi redaksia. ■

Mulla Idriz Gjilani në mesin e 100 udhëheqësve më të mëdhenj muslimanë të shekullit të 20-të

Mulla Idriz Gjilani luftoi trimërisht për ruajtjen e Islamit në Shqipëri dhe e bëri atë forcë unifikuese për muslimanët...

Ai ishte përshëndetur dhe pranuar si njeri i shenjtë i kombit.

Historia e Kosovës në shekullin e 20-të ka qenë e rrëmujshme dhe plot trauma. Jeta dhe koha e Mulla Idriz Gjilanit është një dëshmi për këto vite sprovuere. Mulla Idrizi është përshëndetur dhe pranuar si njeri 'i shenjtë i kombit', luftëtar i lirisë dhe bartës i flamurit të unitetit shqiptar; ai u dallua jo vetëm për natyrën e sakrificave, por gjithashtu edhe për vullnetin prej një misionari me të cilin ai i shërbeu kauzës së komunitetit musliman kundër të gjitha mbeturinave destruktive.

Idriz Gjilani u lind më 4 qershor të vitit 1901 në Velekincë, fshat në veri të Gjilanit. Prindërit e tij, Hajrullahu dhe Sale Smakaj nga Cërnica, kishin katër fëmijë. Në mesin e tyre Idrizi ishte fëmijë i veçantë. Ai konsiderohej më i pjekuri në mesin e bashkëmoshatarëve të tij për arsye të vetive dalluese personale të tij. Që në fillim ai shfaqti interesim shumë të madh për edukim dhe për problemet shoqërore. Ai kreu *Mejtepin* e Cërnicës, në vitin 1911, me sukses të shkëlqyeshëm. Me udhëzimin e Mulla Halimit, një *hoxhë* autentik dhe *imam* në Cërnice dhe lagjet e saj, Hajrullah Hasani e dërgoi djalin e tij në Ruzhdije të Gjilanit, për të diplomuar në punën administrative.

Shpërthimi i Luftës Ballkanike çoi në ndërprerjen e studimeve të tij në Ruzhdije. Okupuesit serbë i mbyllën shkollat, por më vonë medresetë u lejuan të punojnë ekskluzivisht si qendra të edukimit fetar. Në vitin 1913, ai shkoi në medresenë Atwk (medreseja e vjetër) e Gjilanit, e cila më parë kishte funksionuar në Dobërçan. Atje, ai pati si mësues Abdurrahim Efendi Llapashticën, një dijetar të famshëm kombëtar.

Lufta e I-rë Botërore e shkatërroi


përkohësisht punën e këtyre medreseve. Idrizi u dërgua me forcë për të shërbyer në Armatën e Mbretërisë Jugosllave për dy vite; më pas ai u kthye përsëri në medresenë Atwk.

Në armatë, Idriz Gjilani mësoi gjuhën serbe e cila e ndihmoi për studimet e tij në fe, filozofi, dhe histori. Në shkollë ai ishte i dalluar në mesin e bashkëmoshatarëve të tij dhe konsiderohej *hoxhë*. Myderrizi Abdurrahim Efendiu, i cili i çmoi aftësitë pedagogjike të Idrizit, e angazhoi atë që t'i mësonte fill-estarët, si dhe stu-

dentët në pikat (fushat) më të avancuara të tyre. Ai ishte i vetmi nxënës i medresesë Atwk, të cilit i lejohej mbajtja e shallit shumë vite para se të përfundonte shkollimin e tij. Në vitin 1926, në moshën 26 vjeçare, ai mori diplomën për *hoxhë*, për *imam*, dhe fitoi emrin *Ixhazet*, Diploma i ishte dhënë për mbizotërimin e shkencave teologjike. Gjithashtu, ai u nderua me titullin e *mulla-s*.

Në vitin 1927, Mulla Idrizi bëhet *imam* i xhamisë për *Xhematin* e Pidiqit, në Karadak. Pas pesë viteve, ai u punësua si imam-ofiqarë për *Xhematin* e Hogoshtit. Në maj të vitit 1938, ai u vlerësua si *bash-vaiz* në *Ulama Maglis* të asamblesë edukative fetare të Shkupit. Ai





dresenë e Isa Beut në Shkup. Organizata tërhoqi shumë *hoxhallarë* progresivë, udhëheqës, patriotë dhe simpatizues të kauzës shqiptare.

Kur'ani dhe Hadithi që përcaktojnë vlerat e edukimit, kulturës dhe etikës udhëhiqej nga veprimtaria e Mulla Idrizit si mësues fetar. “Pa edukim –thoshte ai - nuk ka fe të njëmendtë (të vërtetë)”. “Talebet (studentët) nuk duhet të pajtohen vetëm me leximin e Kur'anit, por, gjithashtu, duhet ta kuptojnë atë. Mësuesit duhet t'i udhëheqin studentët për ta mësuar mirë Islamit dhe jo vetëm ta paraqesin atë si doktrinë statike. Krijimi i një bashkëpunimi bilateral i komunitetit musliman mbeti mision afatgjatë i Mulla Idrizit. Për të, shtypja zyrtare e gjuhës shqipe kishte një

rëndësi të madhe. Ai thoshte “*Sa i mirë është Islami kur shpjegohet në gjuhën shqipe, gjuhë të cilën Zoti e zgjodhi për shqiptarët.*”

Gjatë mbajtjes së detyrës së tij si *imam* dhe *bash-vaiz* ai ishte aktiv në edukimin fetar dhe në aktivitetet patriotike. Ai themeloi *mejtepin* e Pidiçit për vajzat dhe djemtë e regjionit dhe i mësoi ata duke përdorur gjuhën shqipe në skriptin arabik, përkundër ndalimit të gjuhës shqipe. Gjithashtu, ai e paraqiti gjuhën shqipe si subjekt në Medresenë Atike dhe bëri përpjekje që të përforconte bashkëpunimin mes muslimanëve dhe shqiptarëve katolikë të Karadakut.

Falë aktivitetit të Mulla Idrizit në Kosovë dhe në pjesët e tjera të regjionit, shkollat fetare islamike bënë që pr-

ezenca e tyre të ndihet aq e fortë, sa që ajo periudhë mund të quhet periudha e renesancës islamike (1938-1941). Në këtë periudhë, mësimi në medresetë e Kosovës u bë më cilësor dhe më masiv.

Në mesin e shumë institucioneve edukative me famë mund të përmenden medresetë e famshme: Atwk (Gjilan), Pirnaz (Prizren), Gazi Ali Bej (në Vushtrri), Medreseja e Vjetër (Pejë), Medah, Isa Beu, Velika Kralja (Aleksandra), Medreseja e Madhe e Kral Aleksandrit në Shkup dhe Gjakovë, Mehmet Pasha (Prizren), Brodosana dhe medreseja e Haxhi Pllanës (Ferizaj). Nëpër qytete dhe fshatra u hapën qindra *mejtepe* për nxënës të nivelit fillestar. Lëndët islamike u paraqitën në shkollat publike zyrtare në Serbi. Këto përpjekje i penguan në mënyrë të vazhdueshme proceset për serbizimin e rinisë muslimane nëpërmjet shkollave anti-shqiptare, në të cilat mësohej gjuha e okupatorit. Ndërmjet viteve 1939-1940 numri i nxënësve të Medresesë Atwk në Gjilan dhe në *mejtepe* u rrit në mënyrë të konsiderueshme. Përpjekjet e Mulla Idrizit çuan në shtimin e 39 shkollave fillestare dhe shkollave islamike fetare lëvizëse në rrethinën e Gjilanit.

Zyra e Mulla Idrizit në *Ulema-n* e *Mexhlisit* në Shkup ishte vendosur në katin e dytë të Medresesë së Isa Beut, që ishte afër shtëpisë së tij. Kjo i mundësoi atij të mbante kontakte konstante me nxënësit e tij. Ai ishte shumë i veçantë rreth mbajtjes së lidhjeve direkte me nxënësit e regjioneve të Gjilanit, Kaçanikut, Ferizajt, Preshevës dhe Bujanocit. Ai krijonte raporte të përzemërta me nxënësit e nivelit të lartë dhe i motivonte ata për ngritjen e veprimtarisë kulturore, edukative, fetare dhe politike. Përveç të tjerash, ai mbante marrëdhënie të ngushta për sigurimin e bashkëpunimit patriotik dhe politik me studentët shqiptarë të Fakultetit Filozofik në Shkup, e veçanërisht me ata të Medresesë së Madhe të të njëjtit vend.

Përvojën e tij të pasur politike dhe diturinë që e kishte fituar me një punë të mundimshme, Mulla Idrizi ua dha gjenertave të reja dhe fakultetit të medresesë gjatë mbajtjes së detyrës së tij si *bash-vaiz* (predikues kryesor). Mulla Idrizi kontribuoi në riparimin e xhamive ekzistuese dhe në ngritjen e xhamive të reja. Këto veprime simbolizuan vërtetimin

e kulturës islamike shqiptare në regjionet e banuara nga shqiptarët etnikë nën okupimin e Mbretërisë Jugosllave, që ishte një ferr i hapur për shkatërrimin e Islamit, të mendimit dhe të shpirtit islamik.

Mulla Idrizi iu kundërvu dëbimit të shqiptarëve dhe predikonte pikëpamjet e tij antiqeveritare dhe proislamike nëpër xhami, shtëpi banimi, tubime publike, madje edhe në funerale. "Ne jemi përgjegjës para All-llahut dhe kombit për varrezat e baballarëve tanë. Ne nuk guxojmë t'i neglizhojmë dhe t'i lëmë në duart e naçallnikut (kryetarit të komunës) Sllaviçit," - u thoshte ai bashkëqytetarëve shqiptarë.

Ai udhëhoqi dhe mbikëqyri punën për ndërtimin e urave, rrugëve, shatërvanëve, mejtepeve, xhamive dhe për mirëmbajtjen e varrezave, të cilat ai i shikonte si simbole unifikuese të popullit shqiptar. Gjatë kohës që ai shërbeu në Medresenë Atwk të Gjilanit, numri i studentëve u rrit në 734, prej të cilëve 326 ishin vajza. Medreseja e Gji-

lanit organizoi gjithashtu shkolla mobile (lëvizëse) me mësuesit e tyre. Vetëm në zonën e Gjilanit, u themeluan 39 shkolla të tilla. Këto shkolla ringjallën dhe ripërforcuuan ndenjat fetare dhe vetëdijen kombëtare të gjeneratat e reja.

Prej prillit të vitit 1941 e tutje, ai u preokupua me aktivitetet nacionaliste. Si imam, mësues ai luftoi me fuqinë e fjalëve, si luftëtar me fuqinë e armës, si komandant ushtarak që gëzonte besueshmëri të paluhatshme nga ushtarët e tij ai luftoi kundër Serbisë komuniste dhe forcave bullgare të cilët ishin rivendosur për gjenocid. Ai krijoi rezistencën duke vendosur unitetin në mesin e shqiptarëve.

Në qershor të vitit 1944, ai ishte udhëheqës i shqiptarëve në betejën e Kikës, që u fitua kundër ushtrisë komuniste serbe. Po ashtu, ai luftoi

gjatë viteve 1944-1949 dhe fitoi lëvdata për trimërinë e tij. Ai u dogj për vdekje më 25-26 nëntor të vitit 1949. Ashtu si jeta e tij edhe vdekja e tij do të vazhdonte ta motivonte dhe inspironte popullin. Mulla Idriz Gjilani jetoi dhe vdiq si muxhahid. Ai luftoi për ta bërë Islamit forcë kryesore unifikuese për muslimanët e Shqipërisë. Përpjekja e tij për ta ringjallur dhe për ta përforcuar religionin lidhur me vetëdijen kombëtare ka qenë një sukses i qëndrueshëm i shekullit të 20-të. ■

Përktheu nga anglishtja Ibrahim Shaqiri

NJË VËSHTRIM RRETH ISO

Instituti i Studimeve Objektive, i cili e ka publikuar këtë libër, specializon për shkencat shoqërore dhe studimet ligjore. Me kryeqendrën në Nju Delhi, instituti ka gjashtë degë të shpërndara në tërë Indinë. Është themeluar në vitin 1987. Instituti ka bërë 168 publikime madhore.

Ky institut është i involvuar në mënyrë aktive në studimin dhe mbrojtjen e çështjeve dhe kauzave shoqërore. Ka organizuar 704 konferenca, seminare, simpoziume dhe takime të ndryshme me njerëz të fushave të ndryshme. ISO gëzon statusin konsultativ (Roster) në këshillin shoqëror dhe ekonomik të KB (ECOSOC).

ISO boton 5 gazeta ditore dhe periodike: (1) Gazeta e Studimeve Objektive, (2) Religjioni dhe Rishikimi i ligjit (që botohet dy herë çdo vit), (3) Të drejtat njerëzore sot (çdo tre muaj), (4) Newsletter e ISO-s (mujore, anglisht), (5) ISO Khabarnama (mujore, Urdu).

ISO bashkëpunon me institute të tjera hulumtuese, me universitete, organizata joqeveritare dhe grupe qytetarësh në fusha të ndryshme, si: për të drejtat e njeriut dhe për reformat shoqërore.

Në mesin e grupeve të mëdha, që veprojnë në pjesëmarrje me të, është Shoqata Indiane e Shkencave Shoqërore Muslimane, e cila ka 400 akademikë në mesin e anëtarëve të saj.

Instituti i studimeve objektive

Nju Delhi, Indi

Vlerësimi i lëvizjes feministe perëndimore nga këndvështrimi islam



Mimoza SINANI

Islami i ngriti gratë prej pozitës së “një plaçke” në martesë, në atë të partnereve të barabarta. Prej pozitës të një mosqenieje ligjore, ajo u bë një personalitet ligjor në kuptimin e plotë të fjalës. Ky personalitet ligjor i mëvetëshëm i paracakton çdo gruaje të drejtën për të kontraktuar dhe për të drejtuar biznesin, për të blerë dhe për të shitur, për të zotëruar dhe për të fituar si dhe për të mbajtur dhe menaxhuar paratë dhe pronën e saj.

Themelet e feminizmit perëndimor

Themelet e feminizmit perëndimor janë ngritur mbi traditën judaike-kristiane dhe mbi filozofinë greke. Në Bibël, Eva është krijuar prej gjëzës së Adamit, ajo është dytësore. Në mitologjinë greke, Athinaja, Perëndesha e Mençurisë, lindi prej kokës së Zeusit, babait të gjitha zotave, ajo është dytësore. Në të dyja këto histori të rëndësishme gruaja është krijuar nga burri. Të dyja ato përmbajnë mitin se gruaja është dytësore ndaj burrit.

Klementi i Aleksandrisë, në shek. e II-të, shkruante: “Asgjë nuk është shnderuese për burrin, sepse burri është i pajisur me arsye; po te gruaja edhe meditimi për natyrën e saj është i turpshëm.”

Tertuliani thoshte: “Ti je porta e djallit. Sa lehtë e shkatërron ti burrin, shëmbëlltyrën e Zotit.”

Hegeli bëri procesin “dialektik” tezhë/antitezë/sintezë. Një identitet i caktuar është domosdoshmërisht i krijuar përballë një të kundërte ose një “tjetri”. Feministet mendojnë se identiteti mashkullor (duke përfshirë arsyen, racionalizmin,

qëndrueshmërinë, agresivitetin) është krijuar përballë një “tjetre” femërore (natyrë, emocion, pavendosmëri) dhe kjo ka sjellë një dallim të pandershëm të sekseve.

Në tragjedinë e tij ‘Eumenidet’, Eskili vë këto fjalë në gojën e hyjtit Apollon: “Nëna e fëmijës që njerëzit e quajnë të saj, s’është vërtet një jetëkrijuese, po tash e farës të jetës. Vetëm mbjellësi i farës është krijuesi.” Pra mashkulli është ai që i jep “formë” fëmijës së palindur.

Edhe Platoni mbron mendimin se burrat i japin formën botës. Ideja e Platonit për shpirtin racional që sundon trupin, përmban në vetvete idenë e sundimit mashkullor mbi femrën.

Filo-ja, një hebre i Aleksandrisë, shfrytëzoi filozofinë greke për të interpretuar shkrimet hebraike. Në trajtimin që Filo-ja i bëri tregimit të Zanafillës, Eva bëhet “burimi i rënies”, kurse burri simbolizohet si “mendje”. Pra, gruaja është shkaku i rënies të burrit.

Shumë feministe thonë se historia e filozofisë perëndimore përmban një paragjykim të lindur kundër grave. Për këtë arsye, vetë mënyrat me të cilat na kanë mësuar të mendojmë janë organizisht “mashkullore” dhe gratë janë përjashtuar nga lëmi i arsyes.

Feminizmi për të drejta të barabarta kërkon të ndryshojë pozitën e grave në shoqëri nëpërmjet ndryshimit të ligjeve. Duke ndryshuar ligjet (për shembull duke u dhënë të drejtën e votës, të drejtën e pronësisë pas martesës, të divorcit) pozita e grave në shoqëri do të ndryshonte krejtësisht.

Filozofia e të qenit grua

Feminizmi radikal mendon se kuptimi i të qenit grua është modeluar dhe shtrembëruar nga burrat. Radikalet mendojnë se ndryshimi i ligjeve do të ndryshojë mendimet e rrënjësura të burrat. “Radikalet” janë në kërkim të

një kuptimi krejtësisht të ri të asaj çka do të thotë jesh grua dhe një mënyrë të re të jetës së grave në botën tonë. Të gjitha feministet janë të një mendimi se ka një ndryshim të rëndësishëm midis “seksit” dhe “gjinisë”. “Seksi” është fakti biologjik i të qenit grua, “gjinia” është filozofia e të qenit grua. Feministet shpallin se, fatkeqësisht, filozofia e të qenit grua është krijuar nga burrat. Të jesh “femër” do të thotë të kesh një ndërtim të caktuar anatomik, të jesh “grua” do të thotë të jesh subjekt i disa pikëpamjeve të caktuara. Feministet ankohen se vetë fjala grua [woman] përfshihet në termin burrë [man], që përfshin edhe burrat edhe gratë. Pra se gruaja quhet inferiore ndaj burrit.

Feministet theksojnë se shoqëria jonë është “patriarkale”. Shoqëria jonë është e modeluar dhe e sunduar nga burrat. Pra, gratë janë vendosur në një sferë “më të ngushtë” dhe janë të frenuara prej strukturave mashkullore. Të marrim dy shembuj të zakonshëm: kur martohet një grua, mendohet se ajo duhet të marrë mbiemrin e burrit dhe të mbajë



një unazë që tregon se ajo i takon atij. Feministet radikale e shohin burrin si shfrytëzues dhe gruan si të shfrytëzuar. Në veprën e tij “Seksi i Dytë” Simon dë Bovuari argumentonte se burrat i shohin gratë si “të tjera”. Gratë duhej ta kapërcenin këtë identitet dhe nga “objekt” ato duhej të bëheshin “subjekt”. Beti Frideni në librin e saj “Mistika femërore” (1963) dhe “Organizata Kombëtare për Gratë” e krijuar më 1966, kërkonin çlirimimin e grave nga vartësia shkatërruese e kulturës patriarkale.

Socializmi utopik i Robert Ouenit ndikoi në lëvizjen feministe dhe bëri që të pasojnë edhe ide të tjera për një pavarësi më të madhe të grave: marrëdhënie jashtëmartesore, divorci dhe kontrolli i lindjeve.

Fushata për të drejtat e grave

Fushata për të drejtat e grave nisi në shek. e XVIII-të, gjatë Iluminizmit. Iluminizmi ose Shekulli i Arsyes ishte një periudhë në të cilën mendimtarët besonin se “njeriu është masa e gjithçkaje”. Pas “Deklaratës së të Drejtave të Njeriut” në Francë, Olimp dë Goge botoi më 1789 “Deklaratën e të Drejtave të Grave”. Filozofia iluministe e të drejtave të barabarta u shpreh në mënyrë të qartë në librin e Meri Uollstounkraftit “Një kërkesë për të drejtat e grave”, botuar më 1792, që ishte një nga manifestet më të hershme feministe në Britani.

Deklaratë tjetër e fortë në mbështetje të feminizmit erdhi prej Xhon Stjuart Millit në esenë e tij “Shtypja e grave”, botuar në 1869.

Emili Dejvisi luftoi për të drejtën e grave për arsimin e lartë dhe themeloi në Kembrixh, më 1869, Kolegjin Girton.

Elizabet Garet Andersoni u bë gruaja e parë mjekë më 1869. Milisent Foseti u bë luftëtarja e parë për të drejtën e votës për gratë dhe dorëzoi në parlament peticionin e parë më 1867.

Kolegji i Mbretëreshës në Londër, e para shkollë e lartë për gra, u hap më 1847, dhe më 1849, u pasua nga kolegji i Bedfordit. Ndonëse universiteteve që nga viti 1875 u lejohej të diplomonin gra, Oksfordi priti vitin 1920 për ta bërë këtë, ndërsa Kembrixhi 1947-ën.

Vetëm në vitin 1918 grave iu dha drejta e votës në Britani. Midis viteve 1918 dhe 1920, këtë të drejtë e fituan gratë në Britani, Gjermani, Austri, Hollandë, SHBA dhe BRSS.

Me gjithë miratimin e ligjeve për barazinë e seksive më 1919, për divorcin më 1971, të pagesës së barabartë më 1970 dhe atij kundër diskriminimit për shkak të seksit më 1975, feministet ankohen se gratë nuk kanë akoma një vend të barabartë me burrat në shoqëri.

Pikëpamjet islame për lëvizjen feministe

Le t’i shqyrtojmë të gjitha këto pikëpamje të lëvizjes feministe nga këndvështrimi islam:

Disa tipare të kauzës feministe shkaktojnë zhgënjimin dhe madje kundërshtimin e grave muslimane mbasi mendimet apo reformat e kësaj lëvizjeje janë në kundërshtim të plotë me traditat e kulturës dhe të trashëgimisë fetare islame. Duke qenë se historia dhe trashëgimia e popujve muslimanë ka qenë radikalisht e ndryshme prej asaj të Evropës Perëndimore dhe Amerikës, feminizmi i cili do t’u apelonte grave muslimane dhe shoqërisë në përgjithësi, duhet të jetë përkatësisht i ndryshëm. Këto të

drejta ligjore, të cilat gratë perëndimore i kërkuar në reformimin e Ligjit të Përgjithshëm Anglez, kanë qenë tashmë të pohuara për gratë muslimane në shekullin e 7-të. Me fjalë të tjera, që lëvizja feministe të ketë sukses në një ambient islam, ajo duhet të jetë një formë vendase (indigjene) e feminizmit, më mirë sesa një formë e konceptuar dhe e kultivuar në një ambient të huaj, me probleme të ndryshme, me zgjidhje dhe synime të ndryshme.

Ndërsa në Perëndim rrjedha kryesore e lëvizjes së grave e ka shikuar fenë si një prej armiqtë kryesorë të progresit dhe të mirëqenies së saj, gratë muslimane i vlerësojnë mësimet e Islamit si përkrahësin dhe mbrojtësin e tyre më të mirë. Porositë që gjenden në Kur’an dhe në shembullin e pejgamberit Muhammed s.a.v.s., vlerësohen si ideal drejtë së cilit gratë bashkëkohore dëshirojnë të kthehen.

Kur’ani nuk i denigron gratë

Kur’ani nuk i përmban historitë që gjenden në Testamentin e Vjetër, të cilat e denigrojnë gruan. Nuk ekziston asnjë e thënë tërthorazi se gruaja e parë, e krijuar prej Zotit, ishte një krijesë më pak e vlefshme se burri i parë, apo se ajo ishte një lloj shtojce e formuar nga një prej brinjëve të tij. Në vend të kësaj, ne lexojmë se mashkulli dhe femra janë krijuar ‘min nefsine uehidetin’ (“prej një shpirti apo uni të vetëm”), për ta plotësuar njëri-tjetrin (4:1; 7:189). Ndërsa Tora apo Testamenti i Vjetër e trajton Avën si tunduese të kopshtit të Edenit, e cila e ndihmoi Satanin në joshjen e Ademit për të mos iu bindur Zotit, Kur’ani e trajton çiftin me barazi të plotë. Në fenë islame nuk ekziston koncepti i fajësisë së mëkatit fillestar mbi gratë (7:20-25; 20:121). Larg prej idesë se djalli e tundoj Evën në rolin e saj si gruaja e parë, Kur’ani e vendos fajësinë për mosbindje në Kopshtin e Edenit si mbi Adamin ashtu edhe mbi gruan e tij. Që të dy janë njëllor fajtorë, të dy u ndëshkuan njëllor prej Zotit duke u dëbuar prej Kopshtit; dhe që të dy u falën njëllor kur ata u penduan. Gjithashtu, gruaja është nëna e të gjithë burrave dhe roli i saj nuk përmban konotacione përbuzëse.

Gjithashtu, historia e krijimit në Kur’an sipas së cilës Zoti krijoi njeriun



e parë dhe e çiftëzoi këtë njeri, nuk e ka përcaktuar (atë) si mashkull dhe në lidhje me këtë t'i jepte atij ndoshta rëndësi të më përparshme. Në të vërtetë, për arsye të kërkesave gramatikore (nafs është një fjalë e gjinisë femërore në arabisht, siç është fjala wahidah që do të thotë "një njeri"), personi i parë i krijuar është konsideruar si i gjinisë femërore. Në kundërshtim me këtë fakt, përkthimet anglisht të ndikuara prej historisë së Testamentit të Vjetër, bëjnë transferimin tek mashkullorja kur përkthejnë fragmentin përkatës prej Kur'anit (4:1).

Pozita e gruas në Islamin e hershëm

Pozita e gruas në Islamin e hershëm ka qenë me të vërtetë një pozitë shembullore, pozitë që duhet të studiohet dhe të njihet prej çdo gruaje, si edhe prej çdo liberacionisti në shekullin e 21-të.

Gratë luanin një rol të rëndësishëm në shekujt e hershëm të Islamit, madje duke arrirë pushtet në çështjet shoqërore. Kur'ani insistoi mbi barazinë e gjinive dhe vrulli i hershëm islam për arsimim solli shumë dobi për gratë në shekujt e hershëm. Gratë u bënë poetë, shkrimtare dhe udhëheqëse në fusha të ndryshme. Sukajaneh (vdiq 735 e.s.), bija e Husejn ibn 'Aliut, ishte drejtuese e modës, bukurisë dhe letërsisë, sallonet dhe mbrëmjet argëtuese intelektuale të së cilës ishin të njohura në tërë Botën Muslimane të asaj kohe. Rabi'ah el 'Adaujjah, në shekullin e dytë të Islamit, ishte një nga poeteshat më të famshme sufiste.

Është njoftuar në Kur'an dhe na bëhet

me dije prej historisë se gratë jo vetëm shprehnin mendimet e tyre lirisht në prezencën e Pejgamberit, por gjithashtu argumentonin dhe merrnin pjesë në diskutime serioze me vetë Pejgamberin dhe udhëheqës të tjerë muslimanë të kohës (58:1). Gratë muslimane dihet madje të mos kenë qenë në një mendje me halifë të caktuar, të cilët më vonë kanë pranuar argumentet e bazuara të këtyre grave. Një shembull i veçantë ndodhi gjatë halifatit të 'Umer ibn el Hattab-it.

Islami i ngriti gratë prej pozitës së "një plaçke" në martesë në atë të partnereve të barabarta. Në çështjen e divorcit, ajo ndryshoi prej një sositëse plotësisht të pafuqishme, në një që mund të ndërmerrte procedurën gjyqësore të divorcit dhe të kërkonte të drejtat e saj të prikës dhe trashëgimisë. Prej një pozite të një mosqenieje ligjore, ajo u bë një personalitet ligjor në kuptimin e plotë të fjalës, e aftë për të mbajtur pronën dhe asaj iu dha e drejta për të pasur pjesë të drejtë të pasurisë trashëguese të familjes dhe burrit të saj. Nga ana sociale, me arsimimin e kërkuar barazisht të saj si edhe të çdo mashkulli, ajo u ngrit prej Islamit në pozitën e ndikimit dhe shërbimit social dhe kulturor.

Gruaja është personalitet ligjor i mëvetësishëm

Çdo individ musliman, qoftë mashkull apo femër, mban një identitet të veçantë prej djepit deri në varr. Ky personalitet ligjor i mëvetësishëm i para-



cakton çdo gruaje të drejtën për të kontraktuar, për të drejtuar biznesin, për të fituar dhe zotëruar pasurinë në mënyrë të pavarur. Martesa nuk ka pasoja mbi statusin e saj ligjor, pronën e saj, fitimet e saj, apo madje mbi vetë emrin e saj. Ndryshe nga situata në Perëndim, ku deri në shekullin e fundit ishte e pamundur për një grua të martuar që ta mbante pasurinë për veten e vet, për të kontraktuar me persona të tjerë, apo për të shfrytëzuar pasurinë e saj pa miratimin e burrit të saj, Kur'ani shpalli të drejtën e çdo gruaje për të blerë dhe për të shitur, për të kontraktuar dhe për të fituar si dhe për të mbajtur dhe menaxhuar paratë dhe pronën e saj.

Gruaja mund t'i diktonte kushtet e marrëveshjes martesore në kontratë si edhe kushtet e divorcit. Ajo u bë një qenie ligjore e cila mund ta zotëronte dhe ta drejtonte vetë pasurinë. Pasuria e saj mbetej e vet asaj, madje edhe kur ajo martohej. Asaj i është dhënë e drejta nga Kur'ani për të siguruar jetesën dhe për të pasur të ardhura si një individ i pavarur (4:32). Asaj, veçanërisht, i paracaktohet në Kur'an sa gjysma e hises së mashkullit (4:11), por kur ne kuptojmë se, në ndryshim nga shoqëria perëndimore, burri i saj, babai i saj, vëllai i saj apo pjesëtarë të tjerë meshkuj të farefisit të afërm, mbahen ligjërisht përgjegjës për mbajtjen e saj, ne mund të kuptojmë domosdoshmërinë – si edhe drejtësinë – e një kushti të tillë.



Mbrojtja e sistemit të zgjeruar familjar

Në statusin dhe rolin e gruas në shoqërinë islame ndikojnë një numër traditash sociale, psikologjike dhe ekonomike. Një prej këtyre traditave është mbrojtja e sistemit të zgjeruar familjar në vend të sistemit familjar bërthamë. Përkrahjet dhe përgjegjësitë reciproke, që veprojnë në këto grupe tepër të gjëra të një gjaku, nuk konsiderohen vetëm të dëshirueshme, por ato ligjërisht shkaktojnë obligime mbi anëtarët e shoqërisë, sipas ligjit islam.

Ndërsa pjesa më e madhe e feministëve perëndimore do ta nënçmonin pjesëmarrjen e familjes në martesën e një çifti si një influencë negative, për shkak të kufizimit të dukshëm të lirisë dhe përgjegjësisë së tyre individuale, ne si muslimanë duhet të argumentojmë se pjesëmarrja e tillë është dobiprurëse edhe për individët, edhe për grupet brenda shoqërisë. Kjo jo



vetëm i siguron martesat, që bazohen mbi parime më të shëndosha sesa ato të bazuara në magjepsjen fizike dhe tërheqjen seksuale, por siguron edhe masa të tjera ruajtjeje për vazhdimësinë e suksesshme bashkëshortore. Anëtarët e familjes, sigurojnë shoqërueshmëri të shumëllojshme si edhe burime të gatshme të këshillës dhe mirëdashjes për të sapomartuarit, derisa ata të përshtatin mënyrën e të sjellit ndaj njëri-tjetrit. Për këtë arsye, grindjet nuk janë kurrë shkatërruese ndaj lidhjes martesore, derisa anëtarë të tjerë të rritur të familjes, veprojnë si ndërmjetës dhe sigurojnë burime alternative të shoqërimit dhe këshillojnë mosmarrëveshjet pasuese. Problemet e papajtueshmërisë midis brezave (të prindërve dhe të fëmijëve), gjithashtu lehtësohen dhe në familjen e zgjeruar fëmijët e prindërve që janë në marrëdhënie pune nuk e ndiejnë nevojën e të qenit të pambrojtur, të papërkujdesur, apo të dashurisë dhe të shoqërizimit të pamjaftueshëm, sepse shtëpia e familjes së zgjeruar nuk është kurrë e zbrazët. Në fakt, pa këtë lloj institucioni familjar, është e pamundur të imagjinosh ndonjë zgjidhje të arsye-

shme për problemet me të cilat përballen tani shoqëria perëndimore. Derisa një numër gjithnjë e më i madh grash po hyjnë në fuqinë punëtore, familja e ngushtë është e paaftë për të mbështetur nevojat e anëtarëve të saj.

Familja e zgjeruar lehtëson vështirësitë e gruas

Vështirësitë në një familje të vetme prindërore janë sigurisht të zmadhuara njëqindfish. Sforcimi që një sistem i tillë familjar vendos mbi gruan e punësuar është shkatërrim për individin,

gjithashtu për martesën dhe lidhjet familjare. Mashkulli ndien jo vetëm vështirësi fizike, pasi ai orvatet për të marrë përsipër disa prej obligimeve të gruas, të cilat ajo nuk është e aftë për t'i përmbushur në rolin e saj të ri të shumëfishtë si grua e punësuar – bashkëshorte – nënë; në situata të tilla satisfaksioni i tij intelektual dhe emocional gjithashtu pakësohet. Gruaja e tij nuk e ka energjinë rezervë mendore apo emocionale për të dëgjuar problemet dhe ankesat e tij. Ajo nuk ka kohë për të ndarë për planet e tij, në kohën kur ajo duhet të përballojë pozicionin e saj të dyfishtë ndaj problemeve që krijohen si jashtë, ashtu dhe brenda shtëpisë. Shpesh acarimet mbi nënën, babain dhe fëmijët bëhen aq të padurueshme sa që familja shkatërrohet nga divorci dhe problemet shumëfishohen me polarizimin në rritje midis individëve. Vështirësi të tilla mund të lehtësohen me anën e një sistemi të zgjeruar familjar. Gruaja, në këtë rast, do të gëzojë një "çlirim" të vërtetë për t'ia kushtuar përpjekjet e saj më kryesore mbikëqyrjes së përgjegjësisë së saj familjare; apo – nëse gra të tjera në familje janë të lira dhe dëshir-

rojnë ta përmbushin këtë rol – për të vazhduar karrierën e saj të zgjedhur me vullnet të lirë.

Familja e zgjeruar i mundëson gruas të ndjekë karrierën e saj

Organizimi i zgjeruar familjar iu mundëson grave të vazhdojnë karrierën pa dëmtimin e ndonjë anëtari të familjes, apo të ndonjë sektori të shoqërisë. Familja e zgjeruar është një institucion që siguron dobi të mrekullueshme, si për burrin ashtu edhe për gruan dhe shërben për të përmirësuar marrëdhëniet mashkull-femër. Ajo u mundëson grave të ndjekin karrierën

pa dëmtuar vetveten, bashkëshortin, fëmijët apo të moshuarit, pasi ekzistojnë gjithmonë të rritur të tjerë në shtëpi, për të ndihmuar punën e gruas apo nënës. Gratë që ndjekin karrierën, në një familje të zgjeruar islame, nuk pësojnë asnjë ngarkesë të stërmundimit fizik dhe emocional, e as nuk ndihen fajtores për neglizhimin e përgjegjësive

amënore, bashkëshortore apo familjare. Familja e zgjeruar përfshin një rreth të gjerë përgjegjësish të ndërsjella, por ajo, gjithashtu, përfshin një rreth të gjerë avantazhesh dhe përfitimesh. Përpara se ne të kundërshtojmë përgjegjësitë në rritje (që kërkon familja e zgjeruar) si të papranueshme, përpara se ne të hedhim poshtë çfarëdo shkeljeje të lirisë sonë individuale si të patolerueshme, le të kuptojmë se, sot, ne jemi duke paguar një çmim të jashtëzakonshëm për këtë liri, një barrë shkatërrimtare shoqërore për ikjen tonë nga përgjegjësia. Nëse lëvizja feministe në botën muslimane vendos që të përkrahë modelet familjare perëndimore, kjo natyrisht duhet dhe do të kundërshtohet fuqimisht prej grupeve të grave muslimane dhe prej shoqërisë islame në tërësi.

Përkrahja tradicionale e organizimit të zgjeruar familjar bie në kundërshtim me prirjet e kohës së fundit dhe të ideologjisë feministe. Islami dhe gratë muslimane në tërësi përkrahin plotësimin e synimeve dhe interesave individuale që i përshtaten mirëqenies së grupit më të gjerë dhe anëtarëve të tij. Në vend të marrjes së synimeve të

individit si supreme, Islami ngulit tek pasuesit, ndjenjën e vendit, të tij apo të saj, brenda familjes dhe të përgjegjësisë së tyre ndaj këtij grupi. Kjo nuk perceptohet apo përjetohet prej muslimanëve si shtypje e individit. Si rrjedhim, lëvizja feministe nuk do të mbështetet prej grave muslimane si një qëllim që synohet pa përfillur marrëdhëniet e femrës ndaj anëtarëve të tjerë të familjes së saj.

Burri dhe gruaja kanë status dhe vlerë të barabartë

Islami pohon se të dy llojet e roleve meritohen barazisht të ndiqen dhe të respektohen dhe se kur shoqërohen me drejtësinë e kërkuar prej fesë, një ndarje e punës sipas gjinive është përgjithësisht e dobishme ndaj të gjithë anëtarëve të shoqërisë. Në Kur'an, nuk është bërë kurrfarë dallimi midis gjinive. "Nuk ka dyshim se për muslimanët dhe muslimanet, besimtarët e besimtare, adhuruesit e adhurueset, të sinqertit e të sinqertat, durimtarët e durimtare, të përvojaturit e të përvojaturat, sadakdhënësit e sadakdhënëset, agjëruesit e agjërueset, ruajtësit e nderit e ruajtëset e nderit, shumë përmendësit e All-llahut e shumë përmendëset e All-llahut, All-llahu ka përgatitur falje (mekatesh) dhe shpërblim të madh." (33:35). "Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne Do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë) e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre."

(16:97).
 "Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër. Ju jeni njëri nga tjetri..." (3:195)

Kur'ani i qorton ata, që besojnë se gratë janë inferiore ndaj bur-

rave (16:57-59) dhe, në mënyrë të përsëritur, shprehet për nevojën e trajtimit të burrave dhe të grave me paanësi (2:228, 231; 4:19, dhe kështu me radhë).

Po të mos i kishte gjykuar All-llahu i Lartësuar të dy seksit si të një statusi dhe të një vlere të barabartë, deklarata të tilla të shprehura qartë të barazisë së tyre në obligimet dhe shpërblimet fetare nuk do të ishin bërë në Kur'an.

Është e qartë se Kur'ani jo vetëm rekomandon por është madje insistent në barazinë e burrave dhe grave, si një karakteristikë themelore e një shoqërie kur'anore. Pretendimi i kritikëve jomuslimanë se Islami i denigron gratë mohohet në mënyrë emfatike nga Kur'ani. Mohime të ngjashme janë edhe argumentet e të ashtuquajturve muslimanë se gratë janë fetarisht, intelektualisht dhe etikisht inferiore kundrejt burrave, sikurse përmendej më herët në literaturat çifute dhe kristiane.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e një gruaje janë të barabarta ndaj atyre të një burri, por ato nuk janë domosdo identike me të tyret. Barazia dhe identiteti janë dy gjëra të ndryshme. Si rrjedhim burrat dhe gratë duhet të jenë më mirë plotësues të njëri-tjetrit në një organizim multi-funksional, se sa të konkurrojnë me njëri-tjetrin në një shoqëri uni-funksionale.

Burrat janë përgjegjës për mbajtjen e familjes

Barazia e kërkuar prej traditave islame duhet të shihet në kontekstin e saj më të gjerë, në mënyrë që ajo të kuptohet siç duhet. Duke qenë se muslimanët e konsiderojnë diferencimin e roleve të gjinive si të natyrshëm dhe të dëshirueshëm në shumicën e rasteve, përgjegjësitë ekonomike të anëtarëve meshkuj dhe femra ndryshojnë për të siguruar një ekuilibrim të ndryshimeve fizike midis burrave dhe grave dhe për përgjegjësitë më të mëdha që gratë mbajnë në veprimtarinë riprodhuese dhe të rritjes së fëmijëve, aq të domosdoshme për mbarëvajtjen e shoqërisë. Që të mbrosh, si rrjedhim, se burrat e familjes janë përgjegjës për sigurimin nga ana ekonomike të grave, apo se gratë nuk janë përgjegjëse në mënyrë të barabartë, kjo nuk është dislokim apo mohim i drejtësisë gjinore. Kjo është një detyrë për t'u përmbushur prej burrave, si kompensim për përgjegjësi të tjera të cilat përfshijnë aftësitë e veçanta të grave. Gjithashtu, përqindja e ndryshme e trashëgimisë për meshkujt dhe femrat, e cila aq shpesh citohet si një shembull i diskriminimit kundrejt grave, nuk duhet parë si një urdhër i veçantë. Ai s'është veçse një pjesë e sistemit të gjithanshëm, në të cilin gratë nuk mbajnë përgjegjësi ligjore për të mbajtur anëtarët e tjerë të familjes, por në të cilin, burrat detyrohen prej ligjit, si edhe prej zakonit, për të mbajtur (me ushqim, veshje, etj.) të gjitha të afërmet e tyre femra.

Institucioni i poligamisë

Gjithashtu edhe poligamia, që perceptohet nga feministet si diskriminim dhe përbuzje ndaj gjinisë së tyre, duhet parë në një këndvështrim më të gjerë. Përdorimi dhe perceptimi i këtij institucio-



ni është larg stereotipit hollivudian. Poligamia, pa dyshim, nuk imponohet prej Islamit dhe as është një praktikë universale. Në vend të kësaj, ajo konsiderohet si përjashtim ndaj normës së monogamisë dhe ushtrimi i saj kontrollohet fuqimisht prej presioneve sociale. Muslimanët e vlerësojnë poligaminë si një institucion që duhet të vihet në veprim vetëm nën rrethana të jashtëzakonshme. Si i tillë, ai përgjithësisht nuk konsiderohet prej grave muslimane si një kërcënim. Orvatjet e lëvizjes feministe për t'u fokusuar mbi çrrënjosjen e këtij institucioni, me qëllim që të përmirësohet statusi i grave, si rrjedhim, do të hasnin në simpati apo përkrahje të pakët. Duhet të kujtojmë se çdo grua, e cila dëshiron që martesë e saj të mbetet monogamike, mund ta sigurojë këtë kusht sipas Ligjit Islamik.

Diferencimi i roleve dhe përgjegjësi

Individualizmi i shfrenuar i përjetuar në jetën bashkëkohore, i cili i trajton synimet e individit të veçuara prej faktorëve të tjerë apo si krejtësisht supreme, shkon kundër një angazhimi të thellë islam, drejt varësisë së ndërsjellë sociale. Feminizmi, siç paraqitet në shoqërinë perëndimore, ka mohuar përgjithësisht çfarëdo diferencimi të roleve dhe përgjegjësi të mashkullit dhe të femrës në shoqëri dhe ka kërkuar një lëvizje drejt një shoqërie uniseksuale, me qëllim që të arrihen të drejta të barabarta për gratë. Me "shoqëri uniseksuale" nënkuptohet një shoqëri në të cilën parapëlqehet dhe respektohet një formë e vetme e roleve dhe e punëve nga të dyja gjinitë. Në rastin e lëvizjes feministe perëndimore, synimet e parapëlqyera kanë qenë ato të përmbushura tradicionalisht prej anëtarëve meshkuj të shoqërisë. Roleve të mbështetjes financiare për sigurimin e jetesës, të suksesit në karrierë dhe të marrjes së vendimit, iu është dhënë një respekt dhe kujdes jashtëzakonisht i madh, ndërsa ato që kanë të bëjnë me çështjet shtëpiake, me përkujdesjen e fëmijëve, me rifreskimin estetik dhe psikologjik, me marrëdhëniet e ndërsjella sociale, janë zhvleftësuar apo madje përçmuar.

Shoqëria seks-duale siguron funksionimin e shëndetshëm të shoqërisë

Nënvlerësimi i cilësive dhe roleve, që tradicionalisht e kanë shoqëruar gjininë femërore, ka gjeneruar një shoqëri uniseksuale, në të cilën vetëm roli i mashkullit respektohet dhe synohet. Megjithatë ka si qëllim të sjellë përmasa më të mëdha të barazisë për gratë, ideja se burrat dhe gratë janë jo vetëm të barabartë, por ekuivalentë dhe identikë, i ka shtyrë aktualisht gratë drejt imitimit të burrave dhe, madje, drejt përbuzjes së feminitetit të tyre. Kështu, është duke u prodhuar një tip i ri i shovinizmit mashkullor. Presionet sociale të jashtëzakonshme rezultuan në zhveshjen e grave prej rolit të tyre, prej përgjegjësi që më parë ishin kryer prej tyre dhe ato de-



tyrohen të jetojnë një jetë pa personalitet dhe individualitet. Derisa lidhjet martesore bëhen gjithnjë e më tepër të brishta në shoqërinë perëndimore, gratë priren të jenë viktimat kryesore të këtij ndryshimi. Ato janë më pak të afta se sa burrat për të rikrijuar martesë apo lidhje të tjera dhe ato janë më të dëmtuara psikologjikisht prej këtyre humbjeve.

Përkundrazi, shoqëria e bazuar në Kur'an është një shoqëri seks-duale, në të cilën të dy gjinitë ngarkohen me përgjegjësi të tyre të veçanta. Kjo siguron funksionimin e shëndetshëm të shoqërisë për të mirën e të gjithë anëtarëve të saj. Ideologjia e unifikimit të seksit ngjall një marrëdhënie konkurruese midis sekseve që është shkatërrimtare për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Shoqëria seks-duale, përkundrazi, është një zgjidhje më e natyrshme, duke inkurajuar më mirë bashkëpunimin se sa konkurrencën midis sekseve.

Rrezikshmëria e unifikimit të dy gjinive

Ideja e jodiferencimit apo identitetit seksual arriti të spikasë vetëm kohët e fundit dhe, në këtë rast, në radhë të parë, në shoqërinë perëndimore. Madje, dëshmitë mjekësore për ndryshimin mendor apo emocional midis sekseve ndalohen të botohen në hulumtimet perëndimore, sepse kërcënojnë prirjet mbizotëruese të mendimit. Sesa gjatë do të vazhdojë kjo lëvizje sociale shkatërrimtare, përpara se ajo të hidhet poshtë si e falimentuar, ende nuk dihet. Por pa dyshim, ne, si muslimanë, duhet të jemi të vetëdijshëm për pasojat e mangëta dhe të rrezikshme të saj dhe duhet ta bëjmë shoqërinë dhe rininë tonë të vetëdijshme për fatkeqësinë e shkaktuar prej saj.

Protagonistët e shoqërisë uniseksuale e kanë shpallur të pavlefshëm organizimin njerëzor seks-dual si të rrezikshëm për mirëqenien e grave. Një situatë e tillë mund të kish lindur nëse seksi-dual do të nënkuptohej se njëri seks është më superior ndaj tjetrit. Por, në shoqërinë e vërtetë kur'anore, drejt së cilës ne aspirojmë të shkojmë, kjo nuk është e mundur. Ashtu, sikurse e pamë më parë, Kur'ani mbështet në mënyrë mjaft elokvente statusin e barabartë të grave dhe burrave dhe, në të njëjtën kohë, ai pranon, përgjithësisht, ndryshimet e tyre përkatëse të natyrës dhe funksionit. Kështu, ndërsa pohon barazinë fetare, etike, intelektuale dhe ligjore të meshkujve dhe të femrave, Kur'ani kurrë nuk i konsideron dy sekset, si identikë apo ekuivalentë.

Ndërsa shoqëria islame e shikon amësinë si rolin më prestigjioz të grave, liberacionistët e kanë nënvlerësuar dhe nënçmuar rolin e amvisërisë, së lindjes dhe së rritjes të fëmijëve. Një prej mësimëve tona më të rëndësishme për gjeneratat që do të vijnë është të kuptuarit se organizimi i punëve shtëpiake është një punë që kërkon po aq shumë inteligjencë, këmbëngulje dhe aftësi, sa çfarëdo pune tjetër jashtë shtëpisë.

Varësia e ndërsjellë e burrit dhe gruas

Përkundër prirjes bashkëkohore për të theksuar të drejtat e individit në dëm të shoqërisë, në Kur'an ne gjejmë në

mënyrë të përsëritur theksimin e varësisë së ndërsjellë të burrit dhe gruas dhe, gjithashtu, të të gjithë anëtarëve të shoqërisë. Burri dhe gruaja, për shembull, përshkruhen si mbulojë (libes) të njëri-tjetrit (2:187) dhe si bashkëshortë që jetojnë dhe banojnë në qetësi (33:21; shih gjithashtu 7:189). Burri dhe gruaja janë dërguar për të plotësuar njëri-tjetritin (9:71). Secilit, i kërkohet të përmbushë përgjegjësitë e caktuara që i janë ngarkuar për të mirën e të dyve dhe të mbarë shoqërisë.

Me qëllim të sigurimit të kësaj varësie të ndërsjellë, e cila është e nevojshme për mirëqenien fizike dhe psikologjike si të burrit ashtu edhe të gruas, Kur'ani me anën e kësaj fut tek muslimanët ndjenjën e detyrës dhe përgjegjësisë ndaj shoqërisë. Kjo nuk duhet konsideruar apo përjetuar si ndrydhje e individit. Përkundrazi, muslimanët inkurajohen vazhdimisht në këtë varësi të ndërsjellë, për të përjetuar të mirat që ajo sjell. Dabitë ekonomike, sociale dhe fiziologjike të marrëdhënieve dhe përkujdesjeve të tilla të afërta, brenda grupeve sociale, sigurojnë shpërblime të bollshme për individin, pasi fisnikërojnë aspiratat individuale të tij apo të saj. Anonimiteti dhe pamjaftueshmëria e ndërvarësisë sociale ndërmjet anëtarëve të shoqërisë bashkëkohore perëndimore ka shkaktuar probleme shumë serioze. Vetmia, kujdesi i pamjaftueshëm për të moshuarit, përfitim i zbrazëtirës, përçindja e lartë e vetëvrasjeve dhe krimi adoleshent, të gjitha këto mund ta kenë burimin tek dobësimi gjithnjë e më tepër i përkeqësuar i varësisë së ndërsjellë sociale dhe mohimi i nevojës njerëzore për kujdes të ndërsjellë.

Individualizmi i shfrenuar ka krijuar një lloj të ri skllavërie

Shumë njerëz e konsiderojnë si të dëmshëm çfarëdo cenimi të individualizmit dhe të pavarësisë. Ata nuk arrijnë ta kuptojnë se është pikërisht kjo shtrirje, që ata janë të varur nga të tjerët dhe të tjerët janë të varur nga ata, nga ku varet mirëqenia e tyre psikologjike dhe rregullimi i tyre në shoqëri – në fakt normaliteti i tyre mendor. Është e nevojshme një fushatë për të bindur njerëzit se madje vlera të tilla si liria individuale, bëhen objekt shpërdorimi dhe mbitheksimi.



Duke i njohur padrejtësitë të cilat kanë pësuar anëtarët femra të shoqërisë në shumë vende dhe kohëra, ne do të sugjerim se ilaçi nuk qëndron në individualizmin e pafrenueshëm, i cili bën që gruaja të braktisë përgjegjësitë e saj ndaj burrit, prindërve dhe madje ndaj fëmijëve, në orvatjen e saj për të qenë e “lirë”. Në vend të kësaj, kjo e ashtuquajtur liri është duke krijuar një lloj të ri të skllavërisë për shumë gra. Atyre u kërkohet të përmbushin shumë më tepër sesa pjesën e tyre të përgjegjësisë shoqërore. Ato janë duke u sforcuar për të ndërthurur rolin e amvisës dhe nënës me atë të punës apo karrierës, që rrezikon dënimin e shoqërisë së tyre. Një pjesë e madhe e popullsisë së gjinisë femërore është duke përmbushur rolin e mashkullit dhe rolin e femrës në të njëjtën kohë. Në të shumtë e rasteve, këto gra kanë dështuar pa ia dalë mbanë në të dyja. Si pasojë e luftës së tyre, anëtarët meshkuj të shoqërisë janë, gjithashtu, duke u shtyrë drejt një roli të dyfishtë korrelativ - për të qenë mirëmbajtës dhe fitues së rrogës, në të njëjtën kohë që ata përkujdesen për fëmijët, gatujnë ushqim, lajnë dhe hekurrosin rroba. Një përzjerje e tillë e përgjegjësisë, qoftë për femrat apo për meshkujt, priret për të përfunduar në një dështim dhe tragjedi.

Roli vendimmarrës i burrit në familje

Në kundërshtim me synimet e Lëvizjes së Çlirimit të Grave, Kur'ani fton për një shoqëri që paracakton udhëheqjen themelore dhe rolin ven-

dimmarrës në familje të burrit. Familja ka nevojë për dikë që të bartë barrën e përgjegjësisë themelore. Kur'ani, e ka paracaktuar këtë rol për anëtarin mashkull më të madh të familjes. Ky është ngarkimi patriarkal i fuqisë dhe përgjegjësisë, i cili nënkuptohet prej shprehjeve të tilla, si: “ue lil rixhali ‘alejhinne daraxhatun” (2:228), dhe “el-rixhalu kauuemune ‘ala al-nisa’i...” (4:34). Në kundërshtim me paraqitjen e bërë nga kundërshtarët e Kur'anit, këto fragmente nuk nënkuptojnë nënshtrimin e grave ndaj burrave sipas një diktature të bazuar në gjini. Një interpretim i tillë tregon një mospërfillje flagrante të kërkesave të përsëritura të Kur'anit për barazinë e sekseve dhe të urdhrit të tij për të treguar respekt dhe mirësjellje ndaj grave. Fragmentet në fjalë tregojnë një mënyrë për shmangien e mosmarrëveshjeve të brendshme dhe pavendosmërisë për të mirën e të gjithë anëtarëve të familjes. Ato mbështesin një shoqëri patriarkale.

Tërheqim vëmendjen në përdorimin e fjalës “kauuamun” në shpallje, “el-rixhalu kauuemune ‘ala al-nisa’i...” (4:34). Pa dyshim, folja “kauuema” prej së cilës rrjedh emri foljor “kauuemun” nuk nënkupton mbizotërim despotik. Përkundrazi, termi i referohet atij që i qëndron në krah tjetrit (prej kama, “me qëndru”) në një mënyrë mbrojtëse dhe mirëdashëse. Nëse do të bëhej fjalë për një rol autokratik apo dominues atëherë ekzistojnë shumë prejardhje foljore të tjera të cilat do të kishin qenë më të zbatueshme, si për shembull, “musejtirun” dhe “muhejminun”. Shembuj të

tjerë të përdorimit kur'anor të termit "kauuemun" e përforcojnë më mirë këtë mbështetje, se sa domethënien autoritare apo tiranike të termit (shiko 4:127-135: 5:9). Atribuimi i një kuptimi tjetër për fragmentin në fjalë është, si rrjedhim, ideologjikisht jo konsekuent si edhe gjuhësisht i pambështetur.

Përse Kur'ani përcifikoi më mirë udhëheqje mashkullore, siç është familja patriarkale, se sa një organizim matriarkal? Kur'ani i përgjigjet kësaj pyetje në mënyrën e poshtëpërmendur: "Burrat janë përgjegjës për gratë, ngase All-llahu ka graduar disa mbi disa të tjerë dhe, ngase, ata kanë shpenzuar nga pasuria e tyre (për mbajtjen e grave)... (4:34). Kontributet dhe përgjegjësitë fizike dhe ekonomike janë, si rrjedhim, arsyet kur'anore për propozimin më mirë të një shoqërie patriarkale, se sa të një shoqërie matriarkale.

Alternativat për të ardhmen

Nuk ka dyshim se është koha për ne të gjithë që të kërkojmë me tërë forcën alternativat për të ardhmen. Kjo vlen si për ato shoqëri që tashmë janë zhytur thellësisht në problemet që rezultojnë prej "dezintegrimit" apo "progresit" të familjes, ashtu edhe për ato shoqëri të zhvilluara, të cilat qëndrojnë në udhëkryqe dhe ende janë duke vendosur mbi drejtimin e tyre të ardhshëm.

A do të thotë kjo se traditat islame paracaktojnë domosdoshmërisht ruajtjen e status quo-së në shoqëritë islame që ekzistojnë sot? Përgjigja është e qartë: "Jo". Shumë muslimanë të mençur – burra dhe gra – do të pajtoheshin se shoqëritë e tyre nuk i përmbushin idealet dhe traditat që gjenden në Kur'an dhe përforcohen prej shembullit dhe udhëzimeve të Pejgamberit Muhammed s.a.v.s.

Për sa u përket grave muslimane, buri mi i çfarëdo vështirësie të përjetuar sot, nuk është Islami dhe traditat e tij, por disa ndër-futje të huaja ideologjike në shoqëritë tona, i n j o r a n - c a d h e



shtrembërimi i Islamit të vërtetë. Çfarëdo lëvizje feministe, e cila dëshiron të ketë sukses në një ambient islam, duhet të jetë një lëvizje e cila nuk duhet të veprojë në mënyrë shoviniste, vetëm për interesin e grave. Traditat islame diktojnë se progresi i grave arrihet në mënyrë të njëpasnjëshme me përpjekje të një shkalle të gjerë, për të mirën e të gjithë anëtarëve të shoqërisë. E mira e grupit apo tërësisë është gjithmonë më vendimtare sesa e mira e ndonjë pjese të shoqërisë. Islami dhe traditat islame, si rrjedhim, shihen sot prej shumë muslimanëve si burimi kryesor i kohezivitetit për kultivimin e një identiteti dhe stabiliteti për t'u bërë ballë influencave të huaja të ndërfutura si edhe i bashkëveprimit të nevojshëm për të zgjidhur problemet e tyre të shumta bashkëkohore. Të mos tërheqësh vëmendjen për këtë fakt, apo të mos e vlerësosh plotësisht rëndësinë e tij për muslimanin – qoftë mashkull apo femër – kjo do ta çonte çfarëdo lëvizje mbrojtëse të përmirësimit të pozitës së grave në vendet islame drejt dështimit të sigurt. Vetëm nëpërmjet vendosjes së identitetit dhe stabilitetit mund të arrihet vetërespekti dhe të shfaqet një klimë më e shëndetshme për të dyja palët, si për burrat muslimanë ashtu edhe për gratë muslimane.

Me fjalë të tjera, Kur'ani na mëson se gratë dhe burrat janë të gjithë krijesa të All-llahut, duke ekzistuar në një nivel vlere dhe dobie të barabartë, megjithëse, rëndësia e njëllotje e tyre nuk vërtetohet pretendimin për barazvlefshmëri, apo identitet të përkryer të tyre.

Si rrjedhim, nëse gratë muslimane përjetojnë diskriminim në ndonjë vend apo kohë, ato nuk duhet ta vendosin fajin mbi Islamin, por mbi natyrën joislame të shoqërive të tyre dhe të pamjaftueshmërisë së muslimanëve për të përmbushur direktivat e tij.

Orientalistët e zellshëm për modernizim duhet t'i japin fund përpjekjeve për të vendosur fajin mbi Islamin, një faj që meriton të bie mbi injorancën e besimit të vet atyre dhe mbi rënien e tyre politike dhe sociale, të cilën popujt e tyre e lejuan në të kaluarën.

Formimi i shoqërive të vërteta kur'anore

Ne duhet t'i edukojmë muslimanët tanë – dhe veçanërisht

të rinjtë, pasi ata janë udhëheqësit e së nesërme – me nderim ndaj rëndësisë dhe jetëgjatësisë së traditave kur'anore në lidhje me gruan, familjen dhe shoqërinë. Edhe përkundër dështimit të modeleve të alternativës sociale bashkëkohore perëndimore, disa muslimanë duket sikur lakmojnë ende damkën perëndimore të barazisë seksuale, idetë e tij të unisexualizimit, mënyrat e tij të sjelljes, mbivlerësimit e individualizimit apo lirisë personale ndaj përgjegjësisë dhe sistemin e ngushtë familjar. Ne duhet t'i kuptojmë rreziqet që shoqërojnë ide dhe praktika të tilla sociale. Nëse kuptimet e këtyre ideve dhe praktikave nuk vihen në dukje dhe nuk luftohen, ne rrënohemi drejt një të ardhme fatkeq, pasi eksperimente të tilla sociale, në fund të fundit, janë të destinuara të dështojnë.

Para së gjithash, ne duhet të ngremë shoqëri të vërteta kur'anore anëmbanë Botës Muslimane. Shoqëritë pseudoislame dhe mënyrat apo institucionet pseudo-islame janë në të vërtetë anti-islame; ato janë një model që nuk duhet të respektohet dhe që i është bashkëngjitur etiketimi i "Islamit". Në mendjen e shumë muslimanëve, si edhe të jomuslimanëve, kjo bën që përgjegjësia e të metave të institucioneve t'i transferohen gabimisht religjionit të vetë Islamit.

Gruaja muslimane, nëse ajo është e vendosur ndaj parimeve të fesë së saj, ka leksione për t'i mësuar perëndimorit për barazinë dhe pasardhësit e saj në Lindje duhet të mësojnë sërishmi rolin e kërkuar të tyre prej fesë së tyre.

Është koha që Islami dhe muslimanët të paraqesin zgjidhjet e tyre të problemeve të shoqërisë bashkëkohore, jo vetëm për audiencën muslimane, por, gjithashtu, edhe për audiencën jomuslimane. Kjo mund dhe duhet bërë përmes shembullit të gjallë të shoqërive të vërteta kur'anore në të cilat problemet e burrave dhe grave janë të zgjidhura. Kjo, gjithashtu, bëhet nëpërmjet shkrimeve informative dhe diskutimeve nga studiuesit tanë. ■

LITERATURA :

- Kur'ani
- A Beginner's Guide to Ideas, Linda Smith and William Raep, Lion Publishing plc, Oxford, England, 1991.
- Women, Muslim Society and Islam, Lois Lamya el Faruki, Amerikan Trust Publications, Indianapolis, 1988.